



# RAPORTI VJETOR

2022

TRANSPARENCË, BARAZI, EFIÇENCË



**KPP**

Komisioni i Prokurimit Publik

**Komisioni i Prokurimit Publik**

*E nderuar znj. Kryetare,*

*Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,*

*Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”,  
është nder të dorëzosh para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,  
raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit të Komisionit të  
Prokurimit Publik për vitin 2022.*

*I juaji sinqerisht,*

JONAI D MYZYRI

*Kryetar*

Komisioni i Prokurimit Publik

Raportimi vjetor para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si edhe grupeve të interesit, është një moment i rëndësishëm për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik. Më shumë se një detyrim ligjor, është mbi të gjitha një mundësi për të analizuar në detaje punën e bërë gjatë një viti, çfarë është bërë mirë dhe çfarë ka vend për përmirësim, së pari për vetë institucionin, por edhe për sistemin e prokurimit në përgjithësi.

Viti 2022 ishte një vit sfidues për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik në disa drejtime.

Së pari, viti që lamë pas ishte një vit i rëndësishëm për të matur impaktin dhe progresin e reformës më të rëndësishme të kaluar nga institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, atë të digjitalizimit të shërbimeve. Kjo reformë nisi në mesin e pandemisë, në korrik të vitit 2020 dhe përfundoi në tetor të vitit 2021. Ndaj viti 2022, ishte një vit vendimtar për të matur indikatorët e saj. Vetëm gjatë një viti, mbi 39 % e operatorëve ekonomikë, zgjodhën vullnetarisht të dorëzojnë ankesa vetëm në rrugë elektronike pranë autoritetit/enteve kontraktore dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Kështu, përmes digjitalizimit të shërbimeve, arritëm t'u kursejmë 52,390 km rrugë operatorëve ekonomikë për të paraqitur ankesa dhe mbi 50,000 \$ kosto për paraqitjen e ankesave në rrugë shkresore. Përmes dorëzimit elektronik të akteve, arritëm të shmangim printimin e mbi 14,662 fletëve dhe të rrisim aksesin e operatorëve ekonomikë në sistemin e rishikimit. Falë digjitalizimit të shërbimeve, mbi 26 operatorë ekonomikë ankimes të rinj kanë paraqitur ankesa, duke patur në total 300 operatorë ekonomikë ankimes për 201 nga 400 autoritete, që kanë publikuar procedura prokurimi mbi kufirin e blerjeve të vogla.

Digjitalizimi i shërbimeve në tërësi, ka ndryshuar jo vetëm aksesin e operatorëve ekonomikë në drejtim të sistemit të rishikimit, por edhe sjelljen e grupeve të interesit, përfshirë edhe të vetë Komisionit të Prokurimit Publik. Digjitalizimi i shërbimeve ka rritur shpejtësinë e vendimmarrjes, ku vetëm 10.1% e ankesave janë trajtuar jashtë afatit të parashikuar ligjor dhe ka shkurtuar kohën e shqyrtimit të ankesave nga 17-të në 12-të ditë. Gjatë vitit 2022 është vënë re, se autoritetet kontraktore kanë shmangur përsëritjen e të njëjtave gabime/problematikave.

Viti i kaluar ishte sfidues në drejtim të ofrimit të shërbimeve online edhe për shkak të sulmit të paparashikuar dhe të paprecedentë kibernetik që goditi Shqipërinë. Kjo ngjarje e paprecedentë, e vuri Komisionin e Prokurimit Publik përballë një sfide jashtëzakonisht të vështirë, atë të sigurimit të vijueshmërinë së shërbimit të shqyrtimit të ankesave. Të ndërgjegjshëm për rolin e rëndësishëm në sistemin e prokurimit publik dhe përgjegjësi të dhëna nga ligji, falë organizimit të mirë, puna në asnjë moment nuk u ndal. Gjatë gjithë kohës, kur shërbimet elektronike ishin të paaksesueshme, shërbimi online i informimit të publikut, u transferua në median e shkruar dhe elektronike, në këndin e Njoftimeve Publike të vendosur pranë ambienteve të institucionit, si edhe në sisteme të hapura digjitale të paaksesueshme. Ndaj, shpre-

him mirënjohjen ndaj çdo medieje të shkruar edhe elektronike, që mundësoi vijimin e publikimit të veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, si një shembull të bashkëpunimit të frytshëm mes institucioneve publike dhe medias. Për ditët që shërbimi i dorëzimit të ankesave u mundësua në rrugë elektronike, puna nuk u ndërpre, por u regjistruan 77 ankesa dhe u morën 89 vendime. Me rikthimin e shërbimeve online, u arrit të vërtetohej, se falë sistemeve të sigurta, të ndërtuara në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, nuk pati asnjë dëmtim apo shpërndarje të paautorizuar të të dhënave të Sistemit të Ankesave Elektronike dhe se të dhënat janë të sigurta.

Në rrugëtimin e ndryshimit të ofrimit të shërbimit, kemi vijuar të jemi pranë me asistencë teknike për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, duke miratuar dhe dërguar në adresë të dedikuar, të gjitha manualët e nevojshme, për secilin përdorues të sistemit të ankesave, por gjithashtu edhe duke ofruar asistencë me mbi 2720 minuta komunikim, mbi 340 e-maile zyrtare dhe komunikim me anë të një sistemi mesazhesh falas të vënë në dispozicion në faqen tonë zyrtare.

Falë mbështetjes së Kuvendit, u përfundua edhe faza e dytë e digjitalizimit të shërbimit, duke mundësuar ndërtimin e infrastrukturës për regjistrimin audio të secancave dëgjimore të Komisionit, më shumë transparencë në publikimin e rasteve në proces gjyqësor dhe ndërvëprimin me sisteme të treta dhe një sistem të avancuar të menaxhimit të brendshëm.

Së dyti, viti i kaluar, ishte viti i parë i zhvillimit të të gjitha procedurave të prokurimit publik me ligjin e ri, një ligj i cili jo vetëm është përafëruar me katër direktiva, por gjithashtu ka sjellë ndryshime të qenësishme materiale dhe procedurale. Kësisoj, përgjegjësia e Komisionit të Prokurimit Publik ka qenë edhe më lartë në trajtimin e çështjeve të reja, si edhe konsolidimin e praktikës vendimmarrëse.

Nga 6494 procedura të publikuara për t'u zhvilluar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, për 532 procedura unike, janë paraqitur 794 ankesa, nga të cilat 782 ankesa janë paraqitur për procedurat e prokurimit publik, 8 (tetë) ankesa për procedurat e ankandit publik, 4 (katër) ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ankesat janë paraqitur nga 300 operatorë ekonomikë unikë për 201 autoritete kontraktore. Gjatë vitit 2022, 39 % e ankesave janë paraqitur për dokumentet e tenderit dhe 61 % e tyre për fazën e vlerësimit të ofertave. Krahasuar me vitin 2020 dhe vitin 2021, vihet re një ndërgjegjësim i operatorëve ekonomikë për rritjen e ankesave dhe njëherazi kontrollit dhe shmangies së problematikave që në fazën e hershme të procedurave të prokurimit, atë të dokumenteve të tenderit. Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur me 815 vendime, nga të cilat 614 vendime themeli, 64 vendime deklarative përfundimtare, 100 vendime të ndërmjetme dhe 37 vendime për tërheqjen nga ankesa, me një kohë mesatare të trajtimit të ankesave prej 12-të ditësh, me treguesit më të mirë në dhjetëvjeçarin e funksionimit të tij. Në total janë pranuar 305 ankesa dhe nuk janë pranuar 307 ankesa.

Pas vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, pas ushtrimit të mjeteve të rishikimit, ankimit administrativ nga operatorët ekonomikë, me anë të dorëzimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP-ja pas shqyrtimit të ankesave, nga vendimmarrja e kësaj të fundit, i ka kursyer buxhetit të shtetit, vlerën prej rreth 115,967,650,00 lekësh pa TVSH, llogaritur si diferencë e ofertës së kualifikuar nga vendimmarrja e autoriteteve kontraktore dhe e operatorëve ekonomikë të ankuar, ankesa e të cilëve është pranuar nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Gjatë vitit 2022, ka vijuar bashkëpunimi me Agjencinë e Prokurimit Publik në drejtim të dërgimit për hetim të thelluar të çështjeve, në të cilat nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik janë konstatuar shkelje administrative. Janë dërguar për hetim 10 çështje pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, njëra prej të cilave i është referuar për hetim Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Gjithashtu, gjatë vitit 2022, është vendosur masa administrative gjobë për dy titullarë të autoriteteve kontraktore, për mosbashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik. Edhe në vitin që lamë pas, ka vijuar puna e institucionit në drejtim të monitorimit të zbatimit të vendimeve nga ana e autoriteteve kontraktore, ku falë punës së bërë, vihet re rritja e shpejtësisë në kohë, e zbatimit të vendimeve të Komisionit nga ana e autoriteteve kontraktore.

Qëndrueshmëria e vendimmarrjes së Komisionit është konfirmuar edhe nga Gjykata administrative, si në drejtim të numrit më të ulët të padive me vetëm 5.5% të vendimeve të Komisionit të ankimuar në Gjykatë në krahasim me 7.8% në vitin 2021, por edhe në raport me vendimmarrjen e Gjykatës në lidhje me këto vendime.

Me synim shmangien e përsëritjes së problematikave të konstatuara, si edhe në zbatim të detyrave të lëna në rezolutën e Kuvendit, ka vijuar bashkëpunimi me të gjitha grupet e interesit, përmes organizimit në bashkëpunim me SIGMA-OECD, të dy uorkshopeve të rëndësishme, një me autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë dhe një me sistemin gjyqësor në bashkëpunim edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor. Komisioni ka vijuar të shprehet edhe me vendime interpretuese, duke publikuar njëherazi në faqen zyrtare dhe buletinet periodike, për të gjithë operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, njoftime mbi praktikën vendimmarrëse në çështje specifike, me rëndësi për sistemin, si edhe me publikimin e buletineve mujore informuese për të gjitha grupet e interesit.

Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve, ka qenë kryefjala e vitit 2022 për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, si me institucionet publike, ku ka vijuar trajnimi me Universitetin e Tiranës dhe ka nisur puna për hartimin e një manuali për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, por gjithashtu edhe me partnerët ndërkombëtarë. Në nivel ndërkombëtar, Komisioni, gjatë vitit që lamë pas, lidhi marrëveshjen e posaçme me Autoritetin Kombëtar Anti - Korrupsion të Republikës së Italisë (ANAC), me synim ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve.

Gjithashtu, modestisht, falë mbështetjes së Kuvendit, është themeluar edhe biblioteka e parë me literaturë të huaj, falas, dedikuar për të gjithë praktikantët e prokurimit dhe kërkuesit shkencorë, pranë mjediseve të Komisionit.

Forcimi i kapaciteteve të zyrtarëve të prokurimit në nivel kombëtar, mbetet sfida kryesore edhe për vitin 2022, pasi çdo reformë institucionale apo politike publike nuk mund të zbatohet e veçuar, pa një trupë zyrtarësh prokurimi të kualifikuar.

Së treti, viti që lamë pas ishte tepër i rëndësishëm për njohjen dhe vlerësimin ndërkombëtar të reformave të Komisionit të Prokurimit Publik. Në shtator të vitit të kaluar, në ditën ndërkombëtare të demokracisë, në Maqedoninë e Veriut, u mbajt "Ministeriali i Ballkanit Perëndimor mbi Reformat në Administratën Publike". Në këtë takim u ndanë edhe disa çmime për performancën e institucioneve publike, për disa nga vendet e rajonit, përfshirë dhe Shqipërinë. Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ishte institucioni i vetëm nga Republika e Shqipërisë, që u vlerësua me çmimin, "Besueshmëria në Administratën Publike", ndërkohë që sistemi i ankesave elektronike, u përzgjedh ndër 15-të projektet më të mira në nivel botëror në Samitin Govtech, të zhvilluar në Hagë. Vlerësim për punën e Komisionit, është bërë edhe nga Komisioni European, ndërkohë organizata joqeveritare me fokus transparencën në prokurime, me bazë në Uashington, Open Contracting Partnership, i ka dedikuar një artikull të posaçëm historisë së progresit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Së fundmi, por jo me më pak rëndësi, ka qenë në nderin e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë, si shtet themelues dhe drejtues i të parit rrjet të organeve shqyrtuese të prokurimit të Europës Juglindore, me anëtarësinë e organeve shqyrtuese të prokurimit të Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Sllovenisë, Rumanisë dhe me një status të posaçëm të Republikës së Turqisë. Më shumë se një ëndërr e kahershme e shumë shteteve, në Tiranë u vendos një gur themeli shumë i rëndësishëm i një misioni edhe më të madh se hapësira e një ëndrre: Të bashkuar, me një gjuhë të vetme komunikimi dhe të angazhuar plotësisht në luftën kundër korrupsionit.

Ka shumë mësimë që mund të nxirren nga vendimmarrja e organeve shqyrtuese të prokurimit, mësimë të cilat mund të shërbejnë për të përmirësuar sistemin e prokurimit në tërësi, duke nisur nga problematikat ligjore, në problematikat në zbatimin e ligjit, si edhe risqet e ndryshme për përsëritje të gabimeve procedurale.

Sfidat, por edhe arritjet e vitit që lamë pas, na bëjnë sa krenarë, aq edhe të përlulur në vijimin e kryerjes së detyrave, duke u dhënë garanci të gjitha grupeve të interesit, se do të vijojmë në lartësinë e kërkuar nga ligji dhe të besuar nga Kuvendi, për të mbrojtur interesat e ligjshëm, si një organ që qëndron mbi palët dhe me emërues të përbashkët, pasionin për të punuar me paanshmëri, ligjshmëri, shpejtësi dhe efikasitet.



# PËRMBAJTJA

<b>FJALA E KRYETARIT</b> .....	<b>1</b>
Hyrje .....	4
<b>I  Rreth Komisionit të Prokurimit Publik</b> .....	<b>5</b>
Roli dhe statusi i komisionit të prokurimit publik .....	5
Mbi detyrimin ligjor të raportimit vjetor të veprimtarisë .....	6
<b>II  Organizimi dhe Funksonimi</b> .....	<b>7</b>
Rregulla të organizimit dhe parimet themelore të funksionimit .....	7
Struktura dhe organika 2022 .....	10
Politika të menaxhimit të burimeve njerëzore .....	12
Trajnime 2022 .....	13
Timeline .....	15
<b>III  Pikat Kryesore</b> .....	<b>17</b>
Ankesat dhe lloji i tyre .....	17
Vendimmarrja e Komisionit .....	20
Efektet financiare të vendimmarrjes në ankesat për fazën e vlerësimit – kursimit në buxhetin e shtetit .....	20
<b>IV  Performanca Financiare</b> .....	<b>24</b>
Realizimi i Buxhetit të Komisionit të Prokurimit publik për vitin 2022 .....	24
Parashtrime mbi mjaftueshmërinë e fondeve .....	25
Të ardhurat jashtëbuxhetore për vitin 2022 .....	27
<b>V  Indikatorët Krahasimorë mbi Vlerësimin e Veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për 2020-2021-2022</b> .....	<b>32</b>
Analizë e vendimmarrjeve të Gjykatës .....	33

<b>VI  Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik në Shqyrtimin Administrativ të Ankesave</b> .....	<b>36</b>
Sistemi i rishikimit për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/ppp, ankandeve publike, prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe lejeve minerare .....	36
Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik në procedurën e rishikimit administrativ .....	48
Metodologjia e nxjerrjes dhe përpunimit të të dhënave .....	53
Të dhëna të përgjithshme statistikore mbi llojet e ankesave të paraqitura në Komisionin e Prokurimit Publik .....	53
Monitorimi i zbatimit të vendimeve dhe masat ndëshkuese .....	64
<b>VII  Digjitalizimi i Shërbimeve</b> .....	<b>82</b>
Digjitalizimi i shërbimeve dhe aksesimi nga grupet e interesit .....	82
<b>VIII  Bashkëpunimi Ndërinstitucional dhe Aktivitetet</b> .....	<b>90</b>
Aktivitete .....	94
Urat e komunikimit me grupet e interesit .....	102
<b>IX  Mbi Zbatimin e Rezolutes së Kuvendit</b> .....	<b>104</b>
<b>X  Akte Rregullatore</b> .....	<b>108</b>
<b>XI  Biblioteka e Parë me Literaturë të Huaj Dedikuar Prokurimit Publik</b> .....	<b>109</b>
<b>XII  Sfida dhe Arritje</b> .....	<b>113</b>
Sulmi kibernetik dhe sfida institucionale për vijueshmërinë e shërbimit .....	113
Vlerësimet ndërkombëtare .....	115
<b>XIII  Objektiva për të Ardhmen</b> .....	<b>125</b>
Aneksi .....	128

## HYRJE

Paraqitja e raportit vjetor, në respekt të nenit 32 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është thjesht një detyrim ligjor për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, por edhe një mënyrë për të qenë më pranë grupeve të interesit. Në këtë raport është analizuar në detaje puna e vitit 2022, duke evidentuar problematikat, si dhe sfidat e sistemit të prokurimit publik për të ardhmen.

Në këtë raport është pasqyruar veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik në shqyrtimin administrativ të ankesave, duke pasqyruar numrin total të ankimeve dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi, numrin total të ankimeve të refuzuara dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; numrin total të ankimeve të pranuar dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi, numrin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik të ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit, kushtet për pranimin e ankimeve dhe arsyet më të zakonshme për paraqitjen e ankimeve, performanca buxhetore dhe financiare, struktura dhe organika e vitit 2022, politika të menaxhimit të burimeve njerëzore, marrëdhëniet institucionale me partnerët vendas dhe të huaj, digjitalizimi dhe impakti i reformës, vlerësimet e organizmave ndërkombëtare për Komisionin e Prokurimit Publik, informacion për problematikat e identifikuar në funksionimin e sistemit të prokurimit publik dhe propozimet për përmirësimin e tyre, gjithashtu janë trajtuar arritjet si dhe sfidat për të ardhmen.

# RRETH KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

## Roli dhe Statusi i Komisionit të Prokurimit Publik

Funksioni ligjor dhe statusi i Komisionit të Prokurimit Publik përcaktohet në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Prej 31 Marsit të vitit 2021, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk ka ndryshime apo shtesa të këtij ligji, të cilat mund të kenë sjellë edhe ndryshime në funksionin dhe statusin e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik. Në këtë kontekst funksioni dhe statusi i këtij institucioni nuk ka ndryshime dhe përshkruhen sa më poshtë vijon.

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesionet/partneritetin publik privat, ankandet publike dhe procedurat konkurruese të dhënies së lejeve minerare, organ i krijuar me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”, përkatësisht me ligjin nr. 10 170, datë 22.10.2009.

Komisioni ka statusin e një institucioni të pavarur, i cili financohet nga buxheti i shtetit, status i cili u sanksionua me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 47/2017, datë 13.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), në përmbushje të marrëveshjeve me partnerët ndërkombëtarë, në veçanti me Bashkimin Evropian dhe Bankën Botërore, si dhe të objektivave të Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020. Referuar përcaktimeve të ligjit të prokurimit publik, Komisioni i Prokurimit Publik, ka detyrimin ligjor, t’i raportojë Kuvendit nëpërmjet një raportimi vjetor, i cili kryhet në fund të tremujorit të vitit pasardhës dhe prezantohet nga Kryetari i Komisionit. Gjithashtu, me kërkesë të Kuvendit, Komisioni i Prokurimit Publik mund të raportojë edhe për perioda më të shkurtra kohore apo për çështje të caktuara.

Ligji i ri i prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ka sjellë përfundim me katër direktiva, Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin publik; Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga entet që veprojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare; Direktivën e Këshillit

89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar"; Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, "Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike", e ndryshuar".

Raportimi vjetor i Komisionit të Prokurimit Publik, është një ndër format dhe mënyrat kryesore, nëpërmjet të cilit, pasqyrohet dhe evidentohet veprimtaria e këtij institucioni të pavarur, sigurohet llogaridhënia para Kuvendit të Shqipërisë dhe niveli i nevojshëm i përgjegjshmërisë. Ky raport është njëkohësisht një ndër aspektet e punës dhe një ndër format me të cilën sigurohet transparencë dhe bërja publike e veprimtarisë së tij, në kuadër të respektimit të parimit të transparencës, interesit publik, sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të operatorëve ekonomikë dhe zbatimit të legjislacionit përkatës nga ana e autoriteteve kontraktore.

## Mbi detyrimin ligjor të raportimit vjetor të veprimtarisë

Raporti vjetor, përfshirë edhe raportimin për vitin 2022, në respekt të nenit 32 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Raportimi mbi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, detyrimisht duhet të përfshijë krahas performancës buxhetore dhe financiare, politikat/administrimin e burimeve njerëzore, marrëdhëniet institucionale me partnerët vendas dhe të huaj, edhe paraqitjen në mënyrë të detajuar lidhur me të dhënat mbi; a) numrin total të ankimeve dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; b) numrin total të ankimeve të refuzuara dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; c) numrin total të ankimeve të pranuar dhe vlerën e tyre për secilin autoritet ose ent kontraktor, llojin e procedurës së prokurimit, si dhe fazën e procesit për të cilin është paraqitur ankimi; ç) numrin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik të ankimeve në Gjykatën Administrative të Apelit; d) kushtet për pranimin e ankimeve dhe arsyet më të zakonshme për paraqitjen e ankimeve; dh) informacion për problematikat e identifikuara në funksionimin e sistemit të prokurimit publik dhe propozimet për përmirësimin e tyre.

# ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI

## Rregulla të organizimit dhe parimet themelore të funksionimit

Komisioni i Prokurimit Publik, edhe për sa i përket mënyrës së organizimit dhe funksionimit, mbështetet në përcaktimet e ligjit të prokurimit publik, i cili në nenin 30 pika 5 të tij parashikon se: "Rregullat e hollësishme të organizimit dhe të funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik, miratohen nga vetë Komisioni me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij". Aktualisht, këto rregulla mbi organizimin dhe funksionimin e komisionit, janë detajuar në "Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", e cila është miratuar me vendimin e Komisionit me nr. 766/2021, datë 13.10.2021. Kjo rregullore ka mundësuar qasjen me ndryshimet dhe risitë e ligjit të ri të prokurimit publik, si dhe kornizimin në mënyrë më të plotë, të organizimit të funksionimit të organit kolegjal të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të institucionit të Komisionit, duke përfshirë që nga statusi i Komisionerit, kompetencat e Kryetarit dhe Nënkyetarit, detyrat e anëtarit, administrata e institucionit, parimet e shqyrtimit kolegjal, hedhja e shortit, veprimtaria paraprake e komisionit, përcaktimi i rendit të ditës së mbledhjes, deri të marrja e vendimit nga Komisioni.

Një pjesë e posaçme në këtë rregullore, tërësisht risi, janë edhe krerët mbi proceset e shqyrtimit të ankesave duke filluar nga:

- 1) Kreu që rregullon procesin e shqyrtimit të ankesave lidhur me procedurat e prokurimit publik;
- 2) Kreu për shqyrtimin e ankesave të Koncesioneve/PPP;
- 3) Kreu për shqyrtimin e ankesave për procedurat e përsheptuara të rindërtimit;
- 4) Kreu për shqyrtimin e ankesave të lejeve minerare;
- 5) Kreu për shqyrtimin e ankesave për procedurat në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Gjithashtu një sërë risish janë parashtruar si më poshtë vijon:

- Parashikimi mbi të drejtën e Komisionit të Prokurimit Publik, që të publikojë thirrjen për specialistë dhe ekspertë të pavarur;
- Parashikimi i operatorëve ekonomikë të huaj të cilët nuk e njohin gjuhën shqipe, për të marrë pjesë në seanca dëgjimore duke u asistuar nga një përkthyes, i cili si rregull sigurohet nga lista e ekspertëve të Komisionit, të cilët janë të licencuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me kërkesë të palës.
- Parashikimi mbi zhvillimin e mbledhjeve të hapura/seancave dëgjimore, kur Komisioni e gjykon të nevojshme, që për zgjidhjen e çështjes, nevojitet prania e palëve për të dëgjuar mbi provat dhe pretendimet e tyre;
- Parashikimi i detyrimit të autoritetit kontraktor, për zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, brenda 5 ditëve nga marrja e tij;
- Parashikimi i sanksioneve në rast të refuzimit të autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik;
- Parashikimi i së drejtës së operatorëve ekonomikë ankimes, që në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, mund të paraqesin pranë KPP-së qëndrimin e tyre me shkrim, lidhur me vendimmarrjen e komisionit të shqyrtimit të ankesës së autoritetit kontraktor, nga e nesërmja e vënies në dijeni mbi këtë vendimarrje;

Komisioni i Prokurimit Publik, me veprimtarinë e tij, në cilësinë e një organi administrativ që shqyrton ankesat, luan gjithashtu një rol të rëndësishëm për rritjen e besimit të palëve nëpërmjet vendimeve të paanshme, duke garantuar mbrojtje ligjore për të gjithë pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit publik, procedurat e koncesioneve/partneritetit publik privat, ankandeve publike, si dhe procedurat konkurruese të dhënies së lejeve minerare.

Kjo praktikë, e bazuar edhe në praktikat më të mira për procedurat e rishikimit administrativ, ka ndikimin e saj pozitiv, në zhvillimin sa më të drejtë dhe efikas të procedurave të prokurimit nga autoritetet kontraktore, duke synuar parandalimin e çdo veprimi të kundërligjshëm që cenon interesat publike në radhë të parë, interesat e operatorëve ekonomikë, cenon parimin e transparencës, barazisë, si dhe të konkurrencës, e për më tepër përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike.



## Mbi Mënyrën e Ofrimit të Shërbimeve të Digjitalizuara

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka miratuar me Vendimin nr. 329, datë 06.04.2022, "Për miratimin e manualit të autoriteteve kontraktore për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe shqyrtimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike", manualin drejtuar Autoriteteve Kontraktore mbi përdorimin dhe shqyrtimin e ankesave nëpërmjet Sistemit të Ankesave.

Me anë të shkresës me nr. 766 prot., datë 13.04.2022, ky manual u është dërguar 1350 Autoriteteve Kontraktore nëpërmjet shërbimit postar.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik ka miratuar me Vendimin nr. 328, datë 06.04.2022, "Për miratimin e manualit të operatorëve ekonomikë për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe dorëzimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike", manualin drejtuar Operatorëve Ekonomikë mbi përdorimin dhe dorëzimin e ankesave nëpërmjet Sistemit të Ankesave.

Me anë të shkresës me nr. 767 prot., datë 13.04.2022, ky manual u është dërguar 115 Operatorëve Ekonomikë nëpërmjet postës elektronike.



## Organizimi Institucional Administrativ

Organizimi institucional administrativ është i rregulluar me rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, miratuar me urdhrin e Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 03, datë 11.01.2022 "Për miratimin e rregullosës së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik";

Kjo rregullore përcakton rregullat normuese të organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me strukturën organizative, kompetencat dhe përgjegjësitë e funksionarëve dhe nëpunësve të Komisionit Prokurimit Publik, marrëdhëniet ndërmjet strukturave, administrimin e dokumentacionit, pajisjeve, orarit zyrtar, rregullave të etikës, administrimit të dokumenteve, administrimit të dosjeve të personelit.



## Struktura dhe organika 2022

Struktura dhe organika, numri i punonjësve, si dhe buxheti i Komisionit të Prokurimit Publik, miratohen nga Kuvendi, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj" (i ndryshuar) dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

Struktura, organika dhe numri i punonjësve aktual të Komisionit të Prokurimit Publik, edhe për vitin 2022 vijnë mbi bazën e vendimmarrjes së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 65, datë 29.10.2020, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik", vendim i cili sipas pikës 5 të tij, hyri në fuqi më 29 tetor 2020. Me strukturën e miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 65/2020, datë 29.10.2020, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionit të Prokurimit Publik", numri total i punonjësve, vijon të jetë i njëjtë në një numër total prej 36 punonjësish. Për sa i përket administratës së institucionit të Prokurimit Publik, inspektorët tashmë janë të organizuar në varësinë e Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe të organit kolegjial të Komisionit të Prokurimit Publik. Pra, inspektorët kanë varësi të dyfishtë, nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik. Numri i inspektorëve me organikën e re, është 15 (pesëmbëdhjetë) inspektorë me profile juristë, ekonomistë dhe inxhinierë, profile të cilat janë të nevojshme, duke konsideruar kompleksitetin e çështjeve të cilat merr në shqyrtim komisioni.

Gjithashtu, funksionon edhe Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës, e cila përbëhet nga dy sektorë, përkatësisht Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Vendimeve dhe Shërbimit Ligjor, i organizuar me 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 2 (dy) Specialistë (juristë) dhe Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore, i organizuar me 1 (një) Përgjegjës Sektori, 6 (gjashtë) Specialistë dhe 2 (dy) Punonjës Administrativë.

Bazuar në aktet nënligjore të sipërcituara, organika dhe struktura e Komisionit të Prokurimit Publik vijon në tabelën nr.1.

Në lidhje me këtë strukturë të miratuar nga Kuvendi edhe gjatë vitit 2022, fokusi i institucionit ka qenë në rritjen e kapaciteteve të stafit. Prej 1 janarit deri në 31 dhjetor 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka shpallur gjithsej 24 procedura (përfshirë procedurat e përsëritura) rekrutimi, të cilat janë zhvilluar në përputhje të plotë me ligjin e shërbimit civil në fuqi.

Pozicioni	Kategoria	Nr. Punonjësish
Kryetar		1
Sekretar		1
Nënkryetar		1
Anëtar		3
Këshilltar	II-b	1
Sekretar i Përgjithshëm	I-b	1
Drejtor	II-b	1
Inspektor	III-a	15
<b>Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Vendimeve dhe Shërbimit Ligjor</b>		
Përgjegjës Sektori	III-a	1
Specialist Jurist	III-b	2
<b>Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore</b>		
Përgjegjës Sektori	III-a	1
Specialist (IT)	III-b	2
Specialist (Financë/Buxhet)	III-b	1
Specialist (Arkivë/Protokoll)	IV-a	1
Redaktor Letrar	III-b	1
Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë	III-b	1
Sanitar		1
Shofer		1

**Tabela 1:** Organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës në Komisionin e Prokurimit Publik

Konkretisht, deri në 31 dhjetor 2022 është përmbyllur procesi dhe janë rekrutuar 4 pozicione me status nëpunësi si vijon: 3 (tre) Inspektorë me profil juristë, 1 (një) Specialist Financë/Buxhet.

Gjithashtu, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1151, datë 24.12.2020, janë ndjekur procedurat administrative dhe janë lidhur kontratat e punës për tre (3) punonjës mbështetës, specifikisht (2) dy operatorë dhe (1) një punonjës protokoll.

Konkretisht, në Komisionin e Prokurimit Publik janë gjithsej 20 (njëzet) nëpunës civil, pjesa më e madhe e të cilëve kanë kryer trajnimin e detyruar pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe janë konfirmuar si të tillë. Gjatë vitit 2022, kanë kaluar me sukses periudhën e provës 2 (dy) punonjës, duke u konfirmuar nëpunës civil. Një prej nëpunësve të rekrutuar gjatë vitit 2022, është aktualisht në periudhë prove dhe është në pritje të kryejë rregullisht trajnimin (uebinarët) nën mbikëqyrjen e ASPA-së dhe në përputhje të plotë me legjislacionin e nëpunësit civil në fuqi.

## Politika të menaxhimit të burimeve njerëzore

Komisioni i Prokurimit Publik edhe gjatë vitit 2022, ka synuar të ndjekë një politikë të burimeve njerëzore, që ka në fokus rritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmin, mishërimin e vlerave, parimeve, duke pasur si objektivi, që si anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik edhe stafi administrativ, të jenë të pajisur me aftësi dhe dije të përditësuara dhe të dëshmojnë angazhim maksimal ndaj zbatimit të parimeve etike, për të kryer veprimtarinë e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe me efikasitet maksimale.

Aktualisht nga 31 (përfshirë dy punonjës administrativë dhe tre punonjës mbështetës) punonjës të Komisionit të Prokurimit Publik, 22 prej tyre janë femra dhe 9 prej tyre meshkuj. Moshë mesatare e punonjëseve femra është 40 vjeç, ndërsa për punonjësit meshkuj është 32 vjeç. Punonjës me arsim të lartë janë gjithsej 31, nga të cilët 22 femra dhe 9 meshkuj. Punonjës me arsim të mesëm janë gjithsej 2, nga të cilët 1 femër dhe 1 mashkull.

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka bërë një menaxhim të mirë të burimeve njerëzore, duke mundësuar trajtimin e një numri të lartë ankesash të paraqitura nga operatorë të ndryshëm ekonomikë, të cilat për vitin 2022, janë në një numër pak më të lartë krahasuar me vitin 2021. Në Komisionin e Prokurimit Publik gjatë vitit 2022, kanë qenë gjithsej 20 (njëzet) nëpunës civil, pjesa më e madhe e të cilëve kanë kryer trajnimin e detyruar pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPAs), në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" dhe janë konfirmuar si të tillë. Gjatë vitit 2022, kanë kaluar me sukses periudhën e provës 2 (dy) punonjës, duke u konfirmuar nëpunës civil. Një prej nëpunësve të rekrutuar gjatë vitit 2022, është aktualisht në periudhë prove dhe është në pritje të kryejë rregullisht trajnimin nën mbikëqyrjen e ASPA-së dhe në përputhje të plotë me legjislacionin e nëpunësit civil në fuqi.

Komisioni i Prokurimit Publik, ka në fokus rritjen e kapaciteteve dhe në këtë kontekst në bashkëpunim të ngushtë me ASPA-n, siguron rregullisht pjesëmarrjen në trajnimet e zhvilluara nga kjo e fundit, duke vënë në dispozicion të stafit kalendarët e trajnimeve, si dhe duke nxitur pjesëmarrjen në trajnimet sipas fushave që janë me interes, sipas profilit dhe detyrave funksionale të gjithsecilit. Në funksion të përditësimit dhe pasurimit të dijeve, si dhe shkëmbimit të eksperiencave profesionale, stafi i Komisionit të Prokurimit Publik ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh dhe aktiviteteve të shkëmbimit profesional, të cilat për shkak të vijimit të kufizimeve për shkak të pandemisë Covid-19, janë zhvilluar në formë uebinarësh, apo uorkshopesh online.

## Trajnime 2022

Trajnime individuale, zhvilluar nga ASPA dhe Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë.

Janar

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Administrata Shqiptare drejt hapësirës Administrative Evropiane (HAE)"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Anëtarësimi në BE"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Përdorimi i statistikës për të pasqyruar drejtë ose për të shtrembëruar realitetin"

Shkurt

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Vlerat evropiane dhe aplikimi i tyre në administratën publike"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Zotërimi i formulave dhe funksioneve në Excel"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Risitë e plotësimit të deklaratës para fillimit të detyrës, Pjesa I"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Risitë e plotësimit të deklaratës periodike vjetore në sistemin elektronik në funksion, Pjesa II"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit të institucioneve të varësisë dhe plani i veprimit"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Si funksionon sistemi i ankesave elektronike?"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Raste nga praktika dhe problematikat e konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik mbi zbatimin e kriterit të ofertës ekonomike më të favorshme"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA në formë uebinari me temë "Dialogu konkurrues dhe partneriteti për inovacion në kuadër të prokurimit publik"

Mars

Kurs për "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit", organizuar në kuadër të formimit profesional për Kontabilist të Miratuar, me certifikim nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë


Kurs për "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar", organizuar në kuadër të formimit profesional për Kontabilist të Miratuar, certifikuar me sukses nga Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqipërisë

Uebinari i zhvilluar nga ASPA me temë "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të dokumenteve strategjike"

Trajnimi i zhvilluar nga ASPA me temë "Përpunimi, vlerësimi, analizimi i të dhënave"

vazhdon në Prill





## Timeline

### Veprimtaria Gjatë Vitit 2022

01

**32 Ankesa të depozituara  
77 Vendime të marra nga KPP**

**6 janar 2022:** Hartimi dhe dorëzimi i materialit për kontributin e dytë për hartimin e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2022;  
**11 janar 2022:** Miratimi i rregullores së brendshme me urdhrin e Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 03, datë 11.01.2022 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik".

02

**62 Ankesa të depozituara  
55 Vendime të marra nga KPP**

**15 shkurt 2022:** Raportim në kuadër të takimit të dymbëdhjetë të Komitetit të Stabilizim-Asoocimit, Bashkimi Evropian - Shqipëri.

03

**56 Ankesa të depozituara  
67 Vendime të marra nga KPP**

04

**77 Ankesa të depozituara  
77 Vendime të marra nga KPP**

**8 Prill 2021:** Raportim në kuadër të Raportit Vjetor të Monitorimit të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike për vitin 2021;  
**6 Prill 2022:** Miratimi i manualit "Për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe shqyrtimit të ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike", për autoritetet kontraktore, me vendimin nr. 329, datë 06.04.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik;  
**6 Prill 2022:** Miratimi i manualit "Për përdorimin dhe dorëzimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike (SAE), për operatorët ekonomikë", me vendimin nr. 328, datë 06.04.2022";  
**19 Prill 2022:** Përgatitja dhe dërgimi i prezantimit në kuadër të raportimit mbi Kreun V.

05

**65 Ankesa të depozituara  
7 Vendime të marra nga KPP**

**5 maj 2022:** Raportim në Komisionin European mbi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik (për vitin 2021, si edhe katërmujorin e parë të vitit 2022, në kuadër të takimit të 13-të të Nënkomitetit të Stabilizim Asoocimit BE - Shqipëri, "Tregu i brendshëm dhe konkurrenca duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit";  
**11 maj 2022:** Raportim në Kuvendin e Shqipërisë – Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, lidhur me veprimtarinë vjetore të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik;  
**27 maj 2022:** Zhvillimi i konferencës së dytë me temë "Sfidat e Sistemit të Prokurimit Publik në Republikën e Shqipërisë", me synim trajtimin dhe adresimin e problematikave në fushën e prokurimit publik.

06

**85 Ankesa të depozituara  
74 Vendime të marra nga KPP**

**7 qershor 2022:** Raportimi në takimin e radhës të Komitetit Drejtues për Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik (SKPP) 2020 – 2023, në të cilin u diskutua lidhur me Draft - raportin e Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të prokurimit Publik 2020 – 2023, për vitin 2021.

07

**72 Ankesa të depozituara  
84 Vendime të marra nga KPP**

**7 korrik 2022:** Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë për punën vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2021, për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga Kuvendi, si dhe drejtimit kryesorë të punës për vitin 2022;  
**18 korrik 2022:** Ndërmarrja e menjëhershme e të gjitha masave për mosndërprerjen e punës dhe vijimin e veprimtarisë në situatën e paprecedentë të rënies së shërbimeve publike online dhe faqeve të tjera qeveritare, si pasojë e sulmit kibernetik të sinkronizuar. Me urdhrin nr. 388, datë 18.07.2022, sigurohet vijimi i punës dhe informohen operatorët ekonomikë për mënyrën e procedimit lidhur me paraqitjen e ankesës njohjen me ankesat e depozituara etj.



08

**83 Ankesa të depozituara  
75 Vendime të marra nga KPP**

Zhvillimi i seancave dëgjimore, me përfaqësuesit e autorizuar të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit e autorizuar të operatorit ekonomik, për dy çështje të cilat lidhen me kundërshtimin e vlerësimit të ofertës dhe një çështje e cila lidhet me fazën e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", si dhe neneve 23, 24 dhe 26, të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021, "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik".

09

**62 Ankesa të depozituara  
76 Vendime të marra nga KPP**

**26 shtator 2022:** Referimi i një çështjeje për hetim administrativ pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, në zbatim të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin Publik", me vendimin KPP 928/2022, datë 26.09.2022;  
**15 shtator 2022:** pjesëmarrja e përfaqësuesve të Komisionit të Prokurimit Publik, në seancën shpjeguese për Kapitullin 5 - Prokurimi Publik, zhvilluar në Bruksel;  
Miratimi i urdhrin nr. 464, datë 26.09.2022, "Për përdorimin eficient me synim kursimin e energjisë elektrike në Komisionin e Prokurimit Publik, në mbështetje të Planit të masave për Energjinë Elektrike.

10

**60 Ankesa të depozituara  
68 Vendime të marra nga KPP**

**6 tetor 2022:** Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qasje bashkëpunimin në disa drejtime kryesore, si realizimin e uorkshopeve, konferencave, trajnimeve të përbashkëta; realizimin e analizave dhe studimeve periodike; veprimtari të tjera bashkëpunimi në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje, synimi kontribuimi në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve respektive, si dhe adresimin e problematikave;  
**13 tetor 2022:** Nënshkruhet në Romë marrëveshja e bashkëpunimit, midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Nacional të Antikorrupsionit Italian (ANAC), me kohëzgjatje trivjeçare, e fokusuar në shkëmbimin e njohurive/eksperiencave, dokumentacionit dhe informacionit të të dyja institucioneve, me qëllim përmirësimin e efikasitetit në fushën e prokurimit publik;

**18 tetor 2022:** Dërgimi i materialit mbi tregues të rëndësishëm të veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, në kuadër të hartimit të strategjisë së re të Menaxhimit të Financave Publike;  
**28 tetor 2022:** Themelohet Rrjeti i Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Europës Juglindore, me pjesëmarrjen e organeve shqyrtuese të prokurimit, të Shqipërisë, Kosovës, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Rumanisë, Sllovenisë dhe Malit të Zi. Ndërkohë organi shqyrtues i prokurimit i Republikës së Turqisë, gëzon një status të posaçëm.

11

**95 Ankesa të depozituara  
79 Vendime të marra nga KPP**

**3 nëntor 2022:** Miratimi i rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës së institucionit", me urdhrin e Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 531, datë 03.11.2022;  
**16 nëntor 2022:** Zhvillimi i uorkshopit me temë: "Risqet e Integritetit në Prokurimet Publike", nga Komisioni i Prokurimit Publik, në bashkëpunim me Sigma-OECD, me qëllim qasjen në formimin e një kuptimi të përbashkët të rreziqeve të procedurave të prokurimit publik;  
**10 nëntor 2022:** Shpallja e konkurimit për plotësimin e listës vjetore të ekspertëve, specialistëve të pavarur dhe laboratorëve të akredituar, në zbatim të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 13 të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766 datë 13.10.2021 "Për Miratimin e Rregullave Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik";  
**18 nëntor 2022:** Raportimi në Komisionin Evropian, në vijim të takimit dypalësh për Kapitullin 5, "Prokurimet Publike", i një pasqyre shumë të detajuar të veprimtarisë dhe indikatorëve të punës së Komisionit të Prokurimit Publik.

12

**45 Ankesa të depozituara  
82 Vendime të marra nga KPP**

**5 dhjetor 2022:** Hartimi i komenteve dhe sugjerimeve lidhur me Draft - Raportin e Monitorimit të gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, mbi problematikat dhe aktivitetet e përfunduar etj;  
**12 dhjetor 2022:** Miratimi i "Lista e ekspertëve, specialistëve të pavarur dhe laboratorëve të akredituar për vitin 2023", me vendimin nr. 1237/2022, datë 12.12.2022 bazuar në ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik";  
**22 dhjetor 2022:** Zhvillimi i takimit online i Komitetit Drejtues të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik dhe miratimi i raportit të gjashtëmujorit të parë, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020 - 2023 për vitin 2022.


# PIKAT KRYESORE

## Ankesat dhe lloji i tyre


Nga **6,494** procedura unike të publikuara në Sistemin e Prokurime Elektronike (SPE) gjatë vitit 2022, për prokurime publike me vlerë totale prej **170,200,854,721** lekë, numri i ankesave unike të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik është **532** të cilat arrijnë vlerën prej **20,412,194,409** lekë.

Në total pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë paraqitur ankesa unike për **12%** të buxhetit të prokuruar në rang kombëtar ose **8.19%** e procedurave unike të prokurimit të publikuara në SPE në vitin 2022.

Në krahasim me vitin 2021, vihet re një ulje e numrit të ankesave në raport me numrin e procedurave të publikuara në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga 15.1% në 8.19%. Ulja e numrit të ankesave lidhet gjithashtu edhe me forcimin e qëndrueshmërisë në vendimmarrje të Komisionit të Prokurimit Publik, rritjen e numrit të vendimeve interpretuese të këtij të fundit, si dhe rritjen e komunikimit me grupet e interesit. Kështu, rezulton, se falë punës së bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik, operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore po shmangin përsëritjen e problematikave të njëjta dy herë. Megjithatë, gjatë vitit 2022, vihet re një rritje e vlerës totale të buxhetit të prokurimit të ankuar në 12 % në 2022 nga 9.2% në vitin 2021, duke rritur kështu edhe kontrollin përmes institutit të ankimit në procedurat e prokurimit me vlera të larta.





**Grafiku 1:** Nr. i ankesave në raport me nr. e procedurave të publikuara në SPE




**Grafiku 2:** Vlera totale e buxhetit të prokurimit të ankuar

Për vitin 2022, janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik 794 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) ankesa në total, nga të cilat: 782 (shtatëqind e tetëdhjetë e dy) janë ankesa në lidhje me procedura të prokurimit publik, 8 (tetë) ankesa për procedura ankandi, dhe 4 (katër) ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.



Nga 794 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) ankesa, 308 prej tyre ose rreth 39 %, janë ankesa të paraqitura për kundërshtime mbi dokumentet e tenderit dhe 486 ankesa ose rreth 61 % e tyre, janë ankesa të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave.

Nga numri total i ankesave të paraqitura gjatë vitit 2022, prej 794 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) ankesash në total, si dhe 70 (shtatëdhjetë) ankesash të mbartura nga viti 2021, janë pranuar 343 (treqind e dyzetë e tre) ankesa, nuk janë pranuar 335 (treqind e tridhjetë e pesë), nuk janë marrë në shqyrtim 3 (tre) ankesa; është mbyllur çështja për 89 (tetëdhjetë e nëntë), si dhe ka përfunduar procedimi administrativ për 39 (tridhjetë e nëntë) prej tyre. Detajet mbi vlerën për secilin autoritet kontraktor, si dhe objektin e kontratës, si punë, mall, shërbim, etj., i gjeni të detajuara në aneksin nr. 1, pjesë përbërëse e këtij raporti.



Digjitalizimi dhe rritja e besimit në institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, ka sjellë një rritje të ndjeshme dhe impakt në numrin e operatorëve ekonomikë që përdorin sistemin e rishikimit administrativ. Në ndryshim nga viti 2021, në të cilin kanë paraqitur ankesa 289 operatorë ekonomikë, në vitin 2022 kanë paraqitur ankesa 300 operatorë ekonomikë.

Gjithashtu, konstatohet, se operatorë ekonomikë të rinj në sistemin e ankimit administrativ janë 26, dy prej të cilëve janë Biznese të Mesme të Vogla.

6,494 procedura unike në SPE, fondi limit 170,200,854,721 lekë

532 ankesa unike në KPP, vlera 20,412,194,409 lekë 12% të buxhetit të prokuruar në rang kombëtar

794 ankesa

782 procedura të prokurimit publik

8 ankesa për procedura ankandi

4 ankesa, fusha e mbrojtjes dhe sigurisë

39% (308) ankesa të paraqitura për kundërshtime mbi dokumentet e tenderit

61% (486) ankesa të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave

70 ankesash të mbartura nga viti 2021,

343 ankesa të pranuar

335 ankesa nuk janë pranuar

3 ankesa nuk janë marrë në shqyrtim

89 ankesa për të cilat është mbyllur çështja

39 ankesa për të cilat ka përfunduar procedimi administrativ

## Vendimmarrja e Komisionit

Nga 715 (shtatëqind e pesëmbëdhjetë) vendime të marra nga Komisioni i Prokurimit Publik gjatë vitit 2022, janë kundërshtuar me kërkesëpadi në Gjykatë, 39 prej tyre. Nga totali i padive të paraqitura, deri tani për 2 prej tyre është vendosur pranimi i kërkesëpadisë së paraqitur nga operatori ekonomik, për 3 është vendosur pranimi i pjesshëm dhe për 10 raste është rrëzuar padia, duke mbajtur të njëjtin qëndrim me vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, ndërkohë 24 çështje janë në proces. Në krahasim me vitin 2021, ka një ulje të numrit vendimeve të ankimuar pranë Gjykatës Administrative, nga 7.8 % të vendimeve të ankimuar në vitin 2021, në 5.5 % të vendimeve të ankimuar në vitin 2022.

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka rritur shpejtësinë e shqyrtimit të ankesave, si në drejtim të numrit total të ankesave të trajtuara jashtë afatit, gjithashtu edhe në numrin e ditëve të trajtimit të një anese pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kështu që, nëse për vitin 2021 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit ishte në vlerën 10.8 %, në vitin 2022 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit është ulur në vlerën 10.1 %, edhe me rritjen e lehtë të numrit të ankesave, dhe koha e vendimmarrjes për vitin 2022 është 12 ditë, nga 17 ditë që ishte për vitin 2021.

## Efektet financiare të vendimmarrjes në ankesat për fazën e vlerësimit – kursimit në buxhetin e shtetit

Gjatë vitit 2022, nga totali i ankesave të shqyrtuara (ankesa të vitit 2022, si edhe ankesa të vitit 2021 për të cilat Komisioni është shprehur me vendim në vitin 2022), për 492 prej tyre të cilat lidhen me fazën e vlerësimit, me fond limit 17,997,871,842 lekë pa TVSH, rezulton se:

- ▶ Pas vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik pas ushtrimit të mjeteve të rishikimit, ankimit administrativ nga operatorët ekonomikë, me anë të dorëzimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP-ja pas shqyrtimit të ankesave, nga vendimmarrja e kësaj të fundit, i ka kursyer buxhetit të shtetit, vlerën prej rreth 115,967,650,00 lekë pa TVSH, llogaritur si diferencë e ofertës së kualifikuar nga vendimmarrja e autoriteteve kontraktore dhe e operatorëve ekonomikë të ankuar, ankesa e të cilëve është pranuar nga Komisioni i Prokurimit Publik.
- ▶ Në lidhje me vendimmarrjen në fazën e vlerësimit të ofertave, rezulton se 33 % e ankesave të shqyrtuara në këtë fazë janë pranuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, në krahasim me 55 % të ankesave të pranuar në fazën e dokumenteve të tenderit.



715 vendime

39 kërkesëpadi të paraqitura në gjykatë

10 kërkesëpadi rrëzuar

2 kërkesëpadi pranuar

3 pranimi i pjesshëm

24 çështje në proces



Rritje e shpejtësisë së shqyrtimit të ankesave krahasuar me 2021

▶ 12 ditë koha e vendimmarrjes

▶ 10.1% përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit



Pas vendimmarrjes, 115,967,650,00 lekë pa TVSH i është kursyer buxhetit të shtetit





## 1. Sulmi kibernetik dhe sfida institucionale për vijueshmërinë e shërbimit

Viti 2022, ishte një vit sfidues për ofrimin e shërbimeve digjitale për Shqipërinë, por edhe për Komisionin e Prokurimit Publik. Si pasojë e sulmit të paprecedentë kibernetik që goditi Shqipërinë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, u detyrua që të mbyllë në mënyrë të menjëhershme dhe përkohësisht aksesin e shërbimeve publike online, faqeve të tjera qeveritare, sistemeve dhe platformave online.

Në këtë situatë emergjente dhe të paprecedentë të krijuar si rezultat i mosaksesimit përkohësisht në shërbimet publike online, si edhe në uebsite dhe sistemin elektronik të menaxhimit të ankesave të KPP-së përmes portalit qeveritar E-Albania, siguroi në kohë reale marrjen e masave të menjëhershme

**për garantimin e vijimit të qëndrueshëm të punës, ofrimin të shërbimit publik ndaj operatorëve ekonomikë, autoriteteve kontraktore dhe subjekteve të interesuara, të veprimtarisë normale të Komisionit të Prokurimit Publik sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe njoftimit të OE-ve, AK-ve dhe çdo subjekti të interesuar.**

Për ditët që shërbimi i dorëzimit të ankesave në rrugë elektronike u ndërpre dhe gjithashtu faqja zyrtare e institucionit ishte e paaksesueshme, u regjistruan 77 ankesa dhe u morën 89 vendime.




## 2. Vlerësimet ndërkombëtare

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik u vlerësua nga disa organizma ndërkombëtare, për sa i përket veprimtarisë së tij. Konkretisht:

### ◇ Komisioni European në Raportin për Shqipërinë, datë 12.10.2022, për Komisionin e Prokurimit Publik ka cituar:

*"Në tetor 2021, KPP-ja lançoi një sistem të ri të menaxhimit të ankesave elektronike, E-Ankesa, për paraqitjen dhe menaxhimin elektronik të çështjeve, si dhe nënshkrimin elektronik të dokumenteve dhe akteve. Sistemi i ri ofron statistika në kohë reale, buletine mujore dhe informacion për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë personat me dëmtime në shikim, përmes një motori të veçantë aksesi."*

### ◇ Në datë 15.09.2022, Komisioni i Prokurimit Publik fiton çmimin ndërkombëtar: "Besueshmëria në administratën publike"



### ◇ Gjatë vitit 2022 në Samitin Govtech të mbajtur në Hagë, në datë 1 nëntor 2022, Komisioni i Prokurimit Publik me Sistemin E-Ankesa, u vlerësua ndër 15-të projektet më të mira në nivel botëror

Samiti i Govtech është ngjarja kryesore në botë për inovacionin e sektorit publik.

### ◇ Open Contracting Partnership – Vlerësim mbi reformën digjitale të KPP-së

Open Contracting Partnership, një organizatë jofitimprurëse me seli në SHBA, ka publikuar në faqen e saj zyrtare, një artikull dedikuar reformës digjitale të KPP-së, Sistemit të parë Elektronik të Ankesave në Shqipëri, e cila solli një sërë risish në fushën e prokurimeve publike në Shqipëri.

### ◇ Marrëveshje bashkëpunimi KPP – ANAC

Në tetor të vitit 2022, Komisionit i Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kombëtar i Antikorrupsionit (ANAC), i Republikës së Italisë, nënshkruan në Romë, marrëveshjen e bashkëpunimit, për të forcuar marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe për të nisur bashkëpunimin dypalësh.

### ◇ Konferenca "Sfidat e Sistemit të Prokurimit Publik në Republikën e Shqipërisë"

Më datë 27 maj 2022, u organizua në bashkëpunim me SIGMA-OECD, konferenca e dytë me temë "Sfidat e Sistemit të Prokurimit Publik në Republikën e Shqipërisë"

### ◇ Uorkshopi me temë "Risqet e Integritetit në Prokurimet Publike"

Në datë 16 nëntor 2022, në bashkëpunim me SIGMA-OECD, Komisioni i Prokurimit Publik organizoi uorkshopin me temë: "Risqet e Integritetit në Prokurimet Publike"

# IV PERFORMANCA FINANCIARE

## Realizimi i Buxhetit të Komisionit të Prokurimit publik për vitin 2022

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", i ndryshuar, si edhe ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", procesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2022, si dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, për periudhën janar-dhjetor 2022, paraqitet si vijon:

Shpenzimet e përgjithshme, bazuar në buxhetin e vitit 2022 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600 - 601, 602 - 606, 231), në fund të vitit, kanë arritur në vlerën 83.718,23 mijë lekë, nga 91.258,00 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e miratuar për vitin 2022, duke u realizuar në masën 91.73% të planit vjetor ose me një mosrealizim prej afërsisht 7.539,77 mijë lekë ose 8.26%.

Titulli	Emërtimi	Buxheti i vitit 2022 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2022	
			në mijë lekë	në %
90	Komisioni i Prokurimit Publik	91,258.00	83.718,23	91.73%
01110	Shërbimi i Prokurimit Publik			

**Tabela 2:** Prosesi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2022, si dhe situata buxhetore me treguesit e realizimit të buxhetit të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, për periudhën janar-dhjetor 2022

- ▶ Artikulli 600, "Paga", i cili është artikulli i parë, rezulton, se është shfrytëzuar në vlerën 41.045,42 mijë lekë, nga 43.800,00 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e vitit 2022, pra realizuar afërsisht 93.71%.

Pra, kemi një përdorim të fondit të pagave në masën afërsisht **93.71%**, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh në masën **6.29%**

- ▶ Artikulli 601, "Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore", rezulton me një realizim në vlerën 6,006.26 mijë lekë, nga 7,360.00 mijë lekë të parashikuara në buxhetin e vitit 2022, pra realizuar afërsisht 81.6 %, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh prej 18.4%.

- ▶ Artikulli 602, përkatësisht "Shpenzime për mallra e shërbime", rezulton me një realizim vjetor në vlerën 12.429,18 mijë lekë nga 15.448,00 mijë lekë të planifikuar për vitin 2022, ose rreth 80.45 % të buxhetit, duke rezultuar me një mosrealizim prej afërsisht 3.018,82 mijë lekë, ose 19.54%.

- ▶ Artikulli 606, përkatësisht "Transferta për buxhete familjare dhe individë", rezulton me një realizim vjetor në vlerën 511,65 mijë lekë nga 650,00 mijë lekë të parashikuara si fond i veçantë në buxhetin e vitit 2022, ose afërsisht me 78.71 % të planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh prej 21.29%.

Shpenzimet kapitale deri në fund të vitit, janë realizuar në masën 23.725,72 mijë nga 24.000,00 mijë lekë ose rreth **98.86%** e planit vjetor, duke rezultuar me një mosrealizim fondesh prej afërsisht 274.28 mijë lekë ose **1.15%**.

## Parashtrime mbi mjaftueshmërinë e fondeve

Bazuar në treguesit e Tabelës 2 si më poshtë, mund të konstatojmë, se situata ekonomike gjatë vitit 2022, për Komisionin e Prokurimit Publik, ka qenë mëse e qëndrueshme dhe në nivele deri diku optimale. Duke marrë parasysh edhe rrethanat specifike, si situata e paprecedente e shkaktuar nga sulmi kibernetik, situatë e cila ishte tepër sfiduese për Komisionin e Prokurimit Publik, vihet re, se ka një mosrealizim të fondeve totale në masën 7.539,77 lekë ose 8.26%. Këto ndryshime u shoqëruan deri diku me vonesa eventuale në ezaurimin total të fondeve dhe zhvillimin e procedurave të ndryshme të prokurimit, të parashikuara dhe të planifikuara për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të institucionit. Megjithatë, pothuajse, të gjithë zërat e buxhetit janë realizuar brenda masës së planifikuar në Projektbuxhetin Afatmesëm 2021-2023. Gjate muajit dhjetor 2022 është kërkuar alokim fondi shtesë në artikullin 606, në zbatim të VKM-së nr.898, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të Njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme dhe Institucioneve të Arsimit të lartë Publik për zbutjen e impaktit të krizës". Masa më e madhe e mosrealizimit konstatohet te shpenzimet korrente për paga dhe rrjedhimisht për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, për shkak të mosplotësimit të vakancave në strukturë. Arsyet e mosrealizimit të fondeve buxhetore të planifikuara për shpenzimet



e personelit, lidhen me mosplotësimin e vendeve vakante të miratuara në strukturë, me Vendimin nr. 65, datë 29.10.2020 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionit të Prokurimit Publik”, për shkak të përfundimit pa fitues të procedurave të rekrutimit të shpallura nga KPP-ja gjatë vitit 2022, kohëzgjatjes së procedurave të rekrutimit, si dhe për shkak të largimeve rishtazi me dorëheqje të disa prej punonjësve të institucionit, situatë e cila ka ndikuar në krijimin dhe rritjen e paplanifikuar të pozicioneve vakante të punës. Pavarësisht këtij fakti, institucioni ka kryer shpenzimet operative dhe projektet investuese më të rëndësishme të planifikuara në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2022 dhe të domosdoshme për mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij, duke i përdorur dhe shfrytëzuar me efikasitet fondet dhe duke bërë që edhe puna të vijojë me efektshmëri, me qëllim plotësimin e të gjitha nevojave të punonjësve për krijimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm pune.

Pra, duke bërë një përmbledhje mbi mjaftueshmërinë e përdorimit të fondeve për vitin 2022, nga Komisioni i Prokurimit Publik, për të gjithë zërat e buxhetit, situata paraqitet si më poshtë vijon:

Artikulli	Emërtimi	Buxheti i vitit 2022 (në mijë lekë)	Realizimi për vitin 2022	
			në mijë lekë	në %
600	Paga	43.800,00	41.045,42	93.71%
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	7.360,00	6.006,26	81.60%
602	Mallra e shërbime të tjera	15.448,00	12.429,18	80.45%
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	650,00	511,65	78.71%
600-606	TOTAL Shpenzime korrente	67.258	59.992,51	89.19%
231	Shpenzime kapitale	24.000,00	23.725,72	98.86%
231	TOTAL Shpenzime kapitale	24.000,00	23.725,72	98.86%
TOTAL BUXHET		91,258.00	83.718,23	91.73%

**Tabela 3:** Përdorimi i fondeve për vitin 2022 nga Komisioni i Prokurimit Publik

## Të ardhurat jashtëbuxhetore për vitin 2022

### Tregues mbi të ardhurat jashtëbuxhetore

Ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik bëhen kundrejt pagesës, para-shikuar në nenin 111, pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Rregullat dhe tarifat e pagesës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave si vijon:

- ▶ Vendimi nr. 261, datë 17.03.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifës dhe rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifat për ankesat në procedurat e prokurimit publik;
- ▶ Vendimi nr. 401, datë 13.05.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë prokurimi të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifat për ankesat në procedurat e koncesionit/partneritetit publik privat;
- ▶ Vendimi nr. 56, datë 19.01.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimi ndaj procedurave të ankandit publik apo vendimeve për përjashtim nga to, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifat për ankesat në procedurat e ankandit publik;
- ▶ Vendimi nr. 301, datë 20.4.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 320, datë 21.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e Lejeve Minerare në Zonat Konkurruese”, akt nënligjor i cili rregullon procedurat dhe tarifat për ankesat në procedurat konkurruese të lejeve minerare.

Në zbatim të parashikimeve të akteve ligjore të lartpërmendura, në rastet kur në fund të procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, ankimimi i një operatori ekonomik është pranuar, vlera e tarifës financiare së paguar i kthehet ankimuesit, ndërsa në rastet kur në fund të procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës, ankimimi i një operatori ekonomik nuk pranohet, vlera e tarifës financiare (e ardhura e arkëtuar nga tarifa e ankimimit si garanci për procedura prokurimi) derdhet 100 % në Buxhetin e Shtetit.



Përmbledhëse e procedurave sipas objektit të ankesave				
	Çështje me pagesë		Shuma e pagesës	
	Numri	%	Shuma në lekë	%
Procedurë prokurimi publik	781	98.48%	134,691,220	98.48%
Procedurë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë	4	0.5%	1,034,835	0.5%
Procedurë ankandi	8	1.002%	6,585,569	1.002%
TOTAL	793	100.00%	142,311,624	100.00%

**Tabela 4:** Përmbledhëse e procedurave sipas objektit të ankesave

Shpenzimet korrente totale (600 - 606) në fund të vitit 2022, janë realizuar në masën 7.35% më shumë, krahasuar me shpenzimet korrente të vitit 2021.

- ▶ Artikulli 600, "Paga", i cili është artikulli i parë, në vitin 2022, rezulton, se është shfrytëzuar efektivisht në masën 8.15% më shumë, krahasuar me vitin 2021.
- ▶ Artikulli 601, përkatësisht "Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore", gjatë vitit 2022, rezulton me një realizim në masën 22.67% më shumë, krahasuar me vitin 2021.
- ▶ Artikulli 602, përkatësisht "Shpenzime për mallra e shërbime", gjatë vitit 2022, rezulton me një realizim në masën 3.86% më pak, krahasuar me vitin 2021.
- ▶ Artikulli 606, përkatësisht "Transferta për buxhete familjare dhe individë", gjatë vitit 2022, rezulton me një realizim në masën 11.53% më pak, krahasuar me vitin 2021.

Shpenzimet kapitale totale (231) në fund të vitit 2022, rezultojnë me një realizim në masën 2.98% më shumë, krahasuar me vitin 2021.

Në terma totale buxhetore, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të vitit 2022 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600 - 601, 602 - 606, 231), krahasuar me shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të vitit 2021 (përfshirë të gjithë zërat e buxhetit 600 - 601, 602 - 606, 231), janë realizuar në masën 9.69 % më shumë.

Artikulli	Emërtimi	Realizimi për vitin 2022		Realizimi për vitin 2021	
		Në mijë lekë	Në %	Në mijë lekë	Në %
600	Paga	43.800,00	93.71%	38,927.90	85.56%
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	7.360,00	81.60%	5,658.20	58.93%
602	Mallra e shërbime të tjera	15.448,00	80.45%	10,749.90	84.31%
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	650,00	78.71%	2,080.30	90.24%
600-606	TOTAL Shpenzime korrente	67.258	89.19%	57,416.30	81.84%
231	Shpenzime kapitale	24.000,00	98.86%	958.8	95.88%
231	TOTAL Shpenzime kapitale	24.000,00	98.86%	958.8	95.88%
	TOTAL BUXHET	91,258.00	91.73%	58,375.10	82.04%

**Tabela 5:** Krahasim, realizimi i buxhetit 2022 kundrejt buxhetit të vitit 2021

Artikulli	Emërtimi	Realizim buxheti për vitin 2022		Realizim buxheti për vitin 2021		Tregues pozitiv i realizimit të buxhetit viti 2022 kundrejt viti 2021	
		në %	në %	në %	në %	në %	në %
600	Paga	93.71%	85.56%	8.15%			
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	81.60%	58.93%	22.67%			
602	Mallra e shërbime të tjera	80.45%	84.31%	-3.86%			
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	78.71%	90.24%	-11.53%			
600 - 606	TOTAL Shpenzime korrente	89.19%	81.84%	7.35%			
231	Shpenzime kapitale	98.86%	95.88%	2.98%			
231	TOTAL Shpenzime kapitale	98.86%	95.88%	2.98%			
	TOTAL BUXHET	91.73%	82.04%	9.69%			

**Tabela 6:** Krahasim, realizimi i buxhetit 2022 kundrejt buxhetit të vitit 2021

## E drejta për informim

E drejta për informim përbën një ndër të drejtat themelore të qytetarëve, që garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë është rregulluar nga ligji nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar. Ky ligj iu mundëson qytetarëve të marrin informacionin e nevojshëm ndaj çdo autoriteti publik.

Në kuadër të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", Komisioni i Prokurimit Publik mban dhe publikon, Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacioni i dhënë në bazë të kërkesave.

Gjatë vitit 2022, janë paraqitur 11 kërkesa për informim, të cilave Komisioni i Prokurimit Publik, iu ka dhënë përgjigje brenda afatit të përcaktuar në ligj. Koordinatorin për të drejtën e informimit, mban një komunikim të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të transparencës. Lidhur me informacionet që u janë dhënë subjekteve që kanë kërkuar informacion, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2022, nuk ka pasur asnjë ankesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Në aspektin krahasimor, referuar 2 viteve paraardhëse 2020 dhe 2021, numri i kërkesave për informim mbetet në të njëjtat nivele. Kjo për arsye, se Komisioni i Prokurimit Publik, pasqyron në kohë reale veprimtarinë e tij administrative, nëpërmjet publikimit të të dhënave bazuar në parimet open data. Në këtë mënyrë, Komisioni i Prokurimit Publik, i mundëson publikut dhe subjekteve të interesuara, të aksesojnë lehtësisht të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me ankesat apo vendimmarrjet e Komisionit të Prokurimit Publik në faqen e tij zyrtare.

# INDIKATORËT KRAHASIMORË MBI VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR 2020-2021-2022

## 1. Koha e shqyrtimit të ankesës

Krahas elementeve shumë të rëndësishme, si zbatimi korrekt i ligjit në procesin e shqyrtimit të ankesave, qëndrueshmëria në vendimmarrje, një element shumë i rëndësishëm është edhe koha e shqyrtimit të ankesave, për të mundësuar sigurimin e të së drejtës. Vlen për t'u theksuar, se Komisioni i Prokurimit Publik, ka vijuar me trendin e përshpejtitimit të kohës për shqyrtimin e ankesave për vitin 2022, duke ulur treguesin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit. Konkretisht për vitin 2022, përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit, është ulur në vlerën 10.1 %, nga 10.8 në vitin 2021 dhe 22.1 % që ishte në vitin 2020, ndërsa koha e vendimmarrjes për vitin 2022 është 12 ditë krahasuar me kohën e vendimmarrjes për vitin 2021, e cila ishte 17 ditë, nga 20 ditë që ishte për vitin 2020, duke rritur shpejtësinë në vendimmarrje me 5 ditë gjatë vitit 2022.

	Ankesa të shqyrtuara jashtë afatit	Ankesa të shqyrtuara brenda afatit	Numri gjithsej i ankesave	Përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit
2020	164	577	741	22.1%
2021	84	692	776	10.8%
2022	82	727	809	10.1%

Tabela 7: Koha e shqyrtimit të ankesës

Ashtu sikurse është cituar edhe më lart nga tabela në nivel treguesish performance, vihet re, që edhe gjatë vitit 2022 ka vijuar trendi në uljen e përqindjes së ankesave të shqyrtuara jashtë afatit, ku për periudhën janar - dhjetor 2022, vlera e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit është 10.1 %, ndërsa për vitin 2021 ishte 10.8 dhe për vitin 2020 kjo vlerë ishte 22.1 %.



## 2. Vendime të Komisionit të Prokurimit Publik të ankimuara në gjykatë

Në nivel krahasimor, numri i padive të ngritura në gjykatë gjatë vitit 2022 është më i ulët se numri i padive të ngritura gjatë vitit 2021 dhe vitit 2020, ndërkohë që numri i vendimeve të KPP-së, është më i lartë gjatë vitit 2022. Përqindja e padive të ngritura në gjykatë për vitin 2022 është 5.5% krahasuar me vendimet e ankimuara për vitin 2021, e cila ishte 7.8%, dhe 2020, 9.8%. Pra sërish për vitin 2022 numri i vendimeve të ankimuara në gjykatë është ulur me gati 2.3 % krahasuar me vitin 2021.

	2020	2021	2022
Totali i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik	601	676	715
Ankimuar në gjykatë	59	53	39
Krahasimi i numrit të padive të viteve 2020-2021-2022 në përqindje	9.8%	7.8%	5.5%

Tabela 8: Vendime të KPP të ankimuara në gjykatë




## Analizë e vendimmarrjeve të Gjykatës

Gjatë vitit 2022, nga 715 vendime të Komisionit të Prokurimit Publik, janë ankimuar në Gjykatë 39 vendime. Në Gjykatën e Apelit Administrativ janë ankimuar 38 vendime të KPP-së dhe një vendim është ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Arsyet më tipike të ankimit në gjykatë lidhen me veprimet procedurale. Referuar ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 162/2020 "Ligji për Prokurimin Publik", si dhe Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", rastet më tipike për të cilat operatorët ekonomik i janë drejtuar gjykatës janë:

- Kërkesë padi mbi afatin e paraqitjes së ankesës;
- Kërkesë padi mbi kthimin e tarifës; si dhe
- Kërkesë padi mbi afatin brenda të cilit Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të shpall fituesin;

Në përfundim të procesit gjyqësor në shkallë të parë dhe në apel, gjykata ka vendosur pranimin e plotë për 2 padi dhe pranim të pjesshëm për 3 padi, ka vendosur rrëzimin e 10 kërkesëpadive, ndërsa 24 kërkesëpadi të tjera, janë ende në proces shqyrtimi gjyqësor, në shkallë të parë dhe në apel.



Grafiku 3: Vendime të ankimuar në gjykatë



## 3. Monitorimi i zbatimit të vendimeve 2021 dhe 2022

Nga monitorimi i kryer për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka shqyrtuar në total 809 ankesa, prej të cilave, për 343 ankesa, pas shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik, ka vendosur, që autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet e specifikuara në vendim, ndërsa në vitin 2021 rezultonte, se Komisioni i Prokurimit Publik kishte shqyrtuar në total 776 ankesa, prej të cilave, për 327 ankesa, pas shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik, kishte vendosur, që autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet e specifikuara në vendim.

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik, pas tejkalimit të afatit ligjor të përcaktuar, për zbatimin e vendimeve nga ana e autoritetit kontraktor, ka dërguar **43 (dyzetë e tre)** kërkesa drejtuar autoriteteve kontraktore për zbatim vendimi, ndërsa gjatë vitit 2021 numri i kërkesave dërguar autoriteteve kontraktore arrinte në **60 (gjashtëdhjetë)**.

Shpejtësia mesatare e zbatimit të vendimit nga ana e autoritetit kontraktor është 7 ditë nga data e dërgimit të kërkesës për zbatim vendimi.

Viti	Pranuar/pranuar pjesërisht	Kërkesa për zbatim të dëguara	Përqindja e kërkesave të dëguara	Mesatarja e ditëve nga dërgimi i kërkesës për zbatim vendimi në datën e ardhjes së zbatimit të vendimeve
2021	327	60	18%	6
2022	343	43	12.5%	7

Tabela 9: Monitorimi i zbatimit të vendimeve 2021 dhe 2022

# VEPRIMTARIA E KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË ANKESAVE

## Sistemi i rishikimit për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/ppp, ankandeve publike, prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë dhe lejeve minerare

Sistemi i rishikimit për procedurat e prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga dy shkallë kryesore, rishikimi administrativ dhe rishikimi gjyqësor

Konkretisht:

1. Rishikimi administrativ
  - Autoriteti Kontraktor/Enti Kontraktor
  - Komisioni i Prokurimit Publik
2. Rishikimi gjyqësor – Sistemi Gjyqësor Shqiptar
  - Gjykata Administrative e Apelit - juridiksion fillestar
  - Gjykata e Lartë

Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim dhe mbështetje të tij.

Kuadri ligjor ka parashikuar se çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në ligj është parashikuar procedura e ankimit, afatet dhe mënyra e paraqitjes së ankesave.

Referuar legjislacionit dhe rregullave për prokurimin publik, në Republikën e Shqipërisë ligjvënësi ka parashikuar procedurën e rishikimit administrativ në dy shkallë ankimi, pranë autoritetit kontraktor/ entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ligji garanton në këtë mënyrë ushtrimin e veçantë të rishikimit administrativ nga secili institucion ku fillimisht i jepet e drejta për të rishikuar vendimin e dhënë autoritetit/entit kontraktor që ka zhvilluar procedurën e prokurimit dhe më pas Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjithashtu, ligji parashikon instrument të posaçëm të mbrojtjes së të drejtave të operatorëve ekonomikë të interesuar që mund të preken nga vendimmarrja e organeve shqyrtuese (autoriteti dhe KPP-ja) në rast të paraqitjes së ankesave nga operatorët ekonomikë.

Neni 113 i ligjit parashikon, se në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit, njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kuadri ligjor në fuqi u jep mundësinë operatorëve ekonomikë, që të njihen mbi ankesat e paraqitura para Komisionit të Prokurimit Publik. Në faqen zyrtare të KPP-së publikohet ankesa e plotë në rast të ankesave mbi dokumentet e tenderit, arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, ose pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë, duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

Ankesa pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik bëhet sipas formularit përkatës të publikuar në dokumentet e tenderit miratuar me Vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ankesat mund të dorëzohen në mënyrë shkresore me anë të shërbimit postar ose dorëzimit në selinë e institucionit ose me anë të shërbimit elektronik (Sistemi i Ankesave Elektronike). SAE mundëson dorëzimin njëkohësisht të ankesës në të dyja institucionet, pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, vlen të theksojmë, se që nga data 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar sistemin e Regjistrat Elektronik të Ankesave, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 "Për Prokurimin Publik", ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Ankesave.

SAE ndërvepron me sisteme të tjera, si ai i Prokurimeve Elektronike, Qendrën Kombëtare të Biznesit etj.

Referuar formularit të ankesës, operatorit ekonomik i jepet mundësia që të sqarojë shkeljet e pretenduara duke e shoqëruar atë me dokumentacionin përkatës.

Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Në fuqi është ende Vendimi nr. 261, datë 17.03.2010, i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", aplikohet tarifa prej 0.5% e vlerës së fondit limit.

Pagesa e tarifës, është një kusht i domosdoshëm formal për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Pas shqyrtimit të ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, në rast pranimi plotësisht apo pjesërisht, KPP-ja vendos kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues brenda 5 ditëve, ndërsa në rastet e refuzimit të ankesës, tarifa financiare derdhet në buxhetin e shtetit.

Pas shqyrtimit administrativ, operatorët ekonomikë kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit dhe më pas në Gjykatën e Lartë.

Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurën, lidhjen e kontratës ose ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

Në nenin 110 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", përcaktohen afatet e paraqitjes së ankesës sipas llojeve të procedurave të prokurimit publik:

- Ankesë për dokumentet e tenderit: 7 Dite (nën kufirin e lartë monetar) dhe 10 ditë (mbi kufirin e lartë monetar) nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.
- Ankesë për vendimin e autoritetit kontraktor për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit (për procedurat mbi kufirin e lartë monetar), dhe 7 ditë (nën kufirin e lartë monetar).
- Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim dhe 7 ditë (nën kufirin e lartë monetar).
- Në rastin e procedurave për rihapjen e konkurrimit për lidhjen e një kontrate, në bazë të një marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, me procedurë prokurimi mbi kufirin e lartë monetar, afati për paraqitjen e ankesave është 10 ditë nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës dhe 7 ditë (nën kufirin e lartë monetar).

Procedurat e veçanta:

- Në rastin e procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake e të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit. Përfundim: Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimin të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumenteve të tenderit.
- Në rastin e konstatimit të një kontrate publike të lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në këtë ligj dhe/ose në rastin, kur nuk është publikuar njoftimi i fituesit ose njoftimi i kontratës së nënshkruar, afati për paraqitjen e një ankesë lidhur me këtë kontratë është 60 ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.



Gjithashtu, ligji parashikon të drejtën e ankimit edhe për procedurat me vlerë të vogël.

Për procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin ose entin kontraktor brenda 2 ditëve nga shpallja e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) vetëm pranë autoritetit kontraktor dhe jo pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Me marrjen dijani të ankesës së paraqitur, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vijimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin e plotë të ankesës. Brenda 2 ditëve nga marrja e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet me vendim për pranimin ose refuzimin e saj.

Ndaj vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

Ligji dhe aktet nënligjore parashikojnë edhe legjitimitimin locus standi dhe ratione temporis të operatorëve ekonomikë në kuadër të një procedure rishikimi. Referuar nenit 94, të Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, përcaktohet, se çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas Ligjit të Prokurimit Publik dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Afatet kohore të paraqitjes së ankesave janë parashikuar në nenin 110, të ligjit si më sipër sqaruar për secilën procedurë.

Referuar ligjit të prokurimit publik, autoritetet kontraktore nuk mund të lidhin kontratë publike para përfundimit të periudhës së pritjes parashikuar në nenin 96 të tij. Gjithashtu, ligji parashikon pezullimin e procedurës në rast të paraqitjes së një ankesë nga operatorët ekonomikë në nenin 112, të ligjit për prokurimin publik.

Referuar nenit 96, autoriteti ose enti kontraktor nuk mund të nënshkruajë kontratën me fituesin e procedurës së prokurimit, pa kaluar një periudhë e caktuar nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit, konkretisht të paktën 10 ditë kalendrike, në

rastin e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; të paktën 7 ditë kalendrike në rastin e procedurave të prokurimit nën kufirin e lartë monetar; të paktën 2 ditë kalendrike në rastin e prokurimeve me vlerë të vogël.

Periudha e pritjes, e parashikuar më sipër, nuk zbatohet në disa raste si: në rastin e procedurave me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës; në rastin e procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues; në rastin e kontratave të lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër apo të një blerjeje në sistemin dinamik.

Në lidhje me pezullimin e procedurës së prokurimit për shkak të paraqitjes së një ankesë, në përputhje me nenin 112, të Ligjit të Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor me marrjen e ankesës, pasi konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni, pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.

### **Rishikimi për koncesionet dhe partneritetin publik dhe privat sipas Ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar**

Kuadri ligjor ka parashikuar, se çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë konkurruese dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor të koncesionit/partneritetit publik privat, për të cilin pretendon se është marrë në kundërshtim me këtë ligj, ka të drejtë të ankimojë në Komisionin e Prokurimit Publik.

Në këtë ligj është parashikuar procedura e ankimit, afatet dhe mënyra e paraqitjes së ankesave.

Referuar legjisllacionit për koncesionet dhe partneritetin publik privat, në Republikën e Shqipërisë ligjvënësi ka parashikuar procedurën e rishikimit administrativ vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me shkrim ose elektronike, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon, se mbështesin ankimin e tij.

Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ankimuesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës, apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

Në nenin 43, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar, përcaktohen afatet e paraqitjes së ankesës për procedurat konkurruese:

- Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës konkurruese, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve nga dita e nesërme, kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhej të ishte vënë në dijeni.

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 56, datë 19.1.2011, "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi ndaj procedurave të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", tarifa e pagesës është 10 % e vlerës së sigurimit të ofertës, në rastet kur është parashikuar një sigurim oferte ose 0.2 % e vlerës së parashikuar të kontratës koncesionare, që ankimohej.

Rregulla të posaçme për trajtimin e ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik janë parashikuar edhe në nenet 47-55, të Vendimit nr. 766, datë 13.10.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik".

### **Rishikimi për procedurat në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë**

Sistemi i rishikimit në Republikën e Shqipërisë përfshin edhe ankimin për procedurat në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë të parashikuara në nenin 12, të ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", si dhe në ligjin Nr. 36/2020, "Për Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë" dhe Vendimin Nr. 1170, date 24.12.2020, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë".

Kuadri ligjor edhe në procedurat në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në nenin 53 të tij parashikon, se "Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas këtij ligji dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor, për të cilin pretendon, se është marrë në kundërshtim me këtë ligj, ka të drejtë të ankohet pranë Komisionit të Prokurimit Publik.". Gjithashtu, ligji parashikon legjitimitimin locus standi për të vënë në lëvizje komisionin, edhe për ato kandidatë si palë e interesuar, edhe në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka arsyetuar refuzimin e ofertës së tyre, përpara shpalljes/dërgimit/publikimit të njoftimit të fituesit.

Ashtu si edhe në ligjin për prokurimin publik, edhe në procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, janë parashikuar procedura e ankimit, afatet dhe mënyra e paraqitjes së ankesave.

Komisioni i Prokurimit Publik, është institucioni përgjegjës për shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për procedurat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe ligjit për prokurimin publik, për aq sa ai është i aplikueshëm.

Referuar formularit të ankesës, operatorit ekonomik i jepet mundësia që të sqarojë shkeljet e pretenduara, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin përkatës.

Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010, "Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik", aplikohet tarifa prej 0.5%, e vlerës së fondit limit.

Pagesa e tarifës, është një kusht i domosdoshëm formal për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Pas shqyrtimit të ankesës, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, në rast pranimi plotësisht apo pjesërisht, KPP-ja vendos kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues brenda 5 ditëve, ndërsa në rastet e refuzimit të ankesës, tarifa financiare derdhet në buxhetin e shtetit.

Pas shqyrtimit administrativ, operatorët ekonomikë kanë të drejtën e ankimit në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurën, lidhjen e kontratës ose ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

Në nenin 53, të ligjit nr. 36/2020, "Për Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë", përcaktohen afatet e paraqitjes së ankesës sipas llojeve të procedurave të prokurimit publik:

- Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.
- Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.
- Gjithashtu, në ligj është parashikuar (në nenin 57) të tij, edhe shpallja e pavlefshme e kontratave nga organi rishikues.

Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me shkrim, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe baza ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon se mbështesin ankimin e tij.

Gjatë procedurës së rishikimit administrativ, KPP-ja mban në konsideratë detyrimet ligjore për trajtimin e informacionit të klasifikuar.

Ligji për Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë parashikon gjithashtu periudhën e pritjes në nenin 54 të tij. Me qëllimin për t'u siguruar palëve të interesuara kohën e nevojshme për ankim, autoriteti kontraktor nuk mund të nënshkruajë kontratën me fituesin e procedurës së prokurimit pa kaluar një periudhë prej të paktën, 15 ditësh kalendarike, nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit. Në rastin e kryerjes së procedurës së prokurimit me mjete elektronike, ky afat shkurtohet me 5 ditë.

Periudha e pritjes, e parashikuar në pikën më sipër, nuk zbatohet në rastin e:

- Procedurave me negociim, pa shpallje paraprake, të njoftimit të kontratës.
- Procedurave me një ofertues të vetëm, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues.
- Kontratave të bazuara në një marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, me të gjitha kriteret e përcaktuara.

Referuar nenit 53, pika 7, të ligjit për Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, parashikohen edhe veprimet paraprake për pezullimin e procedurës së prokurimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Kështu, me marrjen e ankesës me shkrim të ankuesit, Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementeve formale të ankimit, brenda 5 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës. Brenda 5 ditëve, nga vendimi për plotësimin e elementeve formale, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkon informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor. Ky i fundit ka detyrimin t'i përgjigjet kërkesës së Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve, nga marrja e saj.

Ndërkohë në nenin 55, të ligjit nr. 36/2020, "Për Prokurimet në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë", Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës, duhet të sigurohet që autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, në rast se nuk vendos pezullimin e procedurës, mund të lejojë autoritetin kontraktor me anë të një urdhri të ndërmjetëm, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit, nëse ka të dhëna, se ankimesi nuk do të ketë sukses me ankesën, kur pezullimi dëmton tërësisht interesin publik, autoritetin kontraktor ose ofertuesin. Në çdo rast, Komisioni i Prokurimit Publik vë në dijeni për vendimet e saj autoritetin kontraktor.



## Rishikimi i procedurave të ankandit publik

Referuar legjislacionit për ankandet, në Republikën e Shqipërisë, ligjvënësi ka parashikuar procedurën e rishikimit administrativ pranë autoritetit shitës dhe në rast se autoriteti shitës nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj ose e refuzon atë, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me shkrim ose elektronike, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon se mbështesin ankimin e tij.

Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ankuesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

Në nenin 42, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008 "Për ankandin publik", i ndryshuar, përcaktohet procedura e ankimit:

- Çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të ankandit, kur gjykon se një vendim i autoritetit shitës është marrë në kundërshtim me këtë ligj apo me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Ankesa i paraqitet me shkrim autoritetit shitës brenda 7 ditëve nga data kur ankuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.
- Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti shitës pezullon vazhdimin e procedurës së ankandit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.
- Autoriteti shitës shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

- Nëse autoriteti shitës nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, ose në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti shitës, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti shitës. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit shitës....

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 401, datë 13.05.2015, "Për Përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi ndaj procedurave të ankandit publik apo vendimeve për përjashtim nga to pranë Komisionit të Prokurimit Publik", tarifa e pagesës është 0.5%, e vlerës fillestare të ankandit publik që ankimohet.

Rregulla të posaçme për trajtimin e ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik janë parashikuar edhe në nenet 64-70, të Vendimit nr. 766, datë 13.10.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik".

## Rishikimi i procedurave konkurruese të lejeve minerare

Referuar legjislacionit për lejet minerare, në Republikën e Shqipërisë, ligjvënësi ka parashikuar procedurën e rishikimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me shkrim ose elektronike, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon, se mbështesin ankimin e tij.

Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ankuesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatën përkatëse që shqyrton mosmarrëveshjet administrative.

Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

Në pikën \*dh) të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 21.04.2011, "Për miratimin e procedurave e kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese", i ndryshuar, përcaktohet procedura e ankimit:

*\*dh) Të gjithë ofertuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së subjektit fitues, pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). KPP-ja ndjek procedurat administrative të shqyrtimit dhe procedurat e hetimit administrativ, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.*

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 21.04.2011, "Për miratimin e procedurave të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese", i ndryshuar, për shqyrtimin e ankesës nga KPP-ja, subjekti duhet të paguajë 10% të vlerës së sigurimit të ofertës. Në rast se nuk është kërkuar sigurim oferte, subjekti duhet të paguajë 0.2% të vlerës së parashikuar të kontratës për marrjen e lejes minerare që ankimohet".

Rregulla të posaçme për trajtimin e ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik janë parashikuar edhe në nenet 71 – 79, të Vendimit nr. 766, datë 13.10.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Prokurimit Publik".

## **Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik në procedurën e rishikimit administrativ**

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili shqyrton ankesat në lidhje me procedurat e prokurimit publik, kompetencat e të cilit përcaktohen në ligjin për Prokurimin Publik, si dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik përcaktohen dhe në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021, "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik".

## **Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik në rishikimin e vendimeve sipas ligjit të prokurimit publik**

Referuar nenit 118 të LPP-së, Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit, nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

Gjithashtu, kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik, në kuadër të shqyrtimit të një anekese, përcaktohen nga ligjvënësi në dy momente procedurale: Përpara lidhjes së kontratës dhe pas lidhjes së saj. Konkretisht:

### **1. Përpara lidhjes së kontratës**, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

- të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve formale të domosdoshme për shqyrtimin e saj;
- të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;
- të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;
- të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes;
- të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një anekese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.

### **2. Pas lidhjes së kontratës**, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor, është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;
- të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj;
- të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, mund të mos shpallë një kontratë absolutisht të pavlefshme edhe nëse ajo është lidhur jo sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 119, të ligjit të Prokurimit Publik, në rastet kur pas shqyrtimit të të gjitha aspekteve përkatëse, çmon se shpallja e pavlefshme e kësaj kontrate mund të cenojë çështjet thelbësore të interesit të përgjithshëm.

Në këto raste, Komisioni i Prokurimit Publik, ka të drejtë të aplikojë zbatimin e masave të tjera administrative, si:

- dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor për shkeljet e konstatuara;
- urdhërimin e autoritetit kontraktor për shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar.

Gjithashtu, kompetencat e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, janë përcaktuar dhe në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", të miratuar në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, "Për Prokurimin Publik" dhe rregullave të prokurimit publik.

### **Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik në rishikimin e vendimeve në procedurat e mbrojtjes dhe sigurisë**

Në ligj (neni 53 pika 3, 4, 5), janë parashikuar edhe kompetencat e organit shqyrtues të prokurimit në trajtimin e ankesave në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Përpara lidhjes së kontratës, KPP-ja, ka të drejtë:

- të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose lloje të tjera të specifikimeve, që bien ndesh me këtë ligj;
- të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigojë shkeljet dhe më pas, të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;
- të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

Pas lidhjes së kontratës, KPP-ja ka të drejtë:

- të nxjerrë një interpretim në lidhje me rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së këtij ligji.

Gjithashtu, ligji i jep të drejtë organit shqyrtues kur gjykon, se një punonjës i autoritetit kontraktor ka kryer një shkelje të qëllimshme, që prek parimet dhe qëllimin e këtij ligji, ku përveç masave korrigjuese mund të bëjë kallëzim penal në organet përkatëse.

### **Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik në rishikimin e vendimeve në procedurat e koncesioneve dhe partneritetit publik privat**

Në ligj (neni 43), janë parashikuar edhe kompetencat e organit shqyrtues në trajtimin e ankesave për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

Dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë procedurat administrative të shqyrtimit dhe procedurat e hetimit administrativ, zbatohen në përputhje me rrethanat për dhënien e të gjitha kontratave të koncesionit dhe të partneritetit publik privat, të parashikuara me këtë ligj.

Gjithashtu (neni 44) parashikon, se refuzimi i nëpunësit civil, i funksionarit ose autoritetit kontraktues për të dhënë informacion apo për të paraqitur dokumentacionin që ka lidhje me procedurën nën hetim administrativ, përbën shkak që Komisioni i Prokurimit Publik, Ministria e Financave ose Agjencia e Prokurimit Publik, të kërkojnë marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

### **Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik në rishikimin e vendimeve në procedurat për Ankandin Publik**

Në ligj (neni 43), janë parashikuar edhe kompetencat e organit shqyrtues në trajtimin e ankesave për koncesionet dhe partneritetin publik privat.

- Me marrjen e ankesës me shkrim, Komisioni i Prokurimit Publik duhet të sigurohet që autoriteti shitës e ka pezulluar procedurën e ankandit. Pas një shqyrtimi paraprak të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim nëse do të lëshojë ose jo një urdhër të ndërmjetëm, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, dhe vë në dijeni për këtë autoritetin shitës.
- Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë, pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin shitës, me anë të



një urdhri të ndërmjetëm, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e ankandit, nëse:

- a) ka të dhëna se ankimuesi nuk do të ketë sukses me ankesën;
- b) pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin shitës ose ofertuesit.

3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit shitës ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit shitës, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;
- c) të udhëzojë autoritetin shitës të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e lidhjes së kontratës;
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.

4. Pas lidhjes së kontratës, kur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se një vendim apo veprim i autoritetit shitës është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim në lidhje me rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;
- b) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin që ka pësuar humbje ose dëme, si rezultat i shkeljes së këtij ligji;
- c) të marrë masa ndaj personave përgjegjës, sipas parashikimeve në këtë ligj.

5. Kur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se një punonjës i autoritetit shitës ka kryer një shkelje të qëllimshme, që prek parimet dhe qëllimin e këtij ligji, përveç masave korrigjuese të parashikuara në pikat 1 deri në 4 të këtij neni, mund të bëjë kallëzim penal në organet përkatëse.

### Kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik në rishikimin e vendimeve në procedurat për Ankandin Publik

Në VKM-në (pika 7.19, germa dh) janë parashikuar edhe kompetencat e organit shqyrtues në trajtimin e ankesave për lejet minerare.

Të gjithë ofertuesit kanë të drejtë të paraqesin ankesë, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e shpalljes së subjektit fitues, pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). KPP-ja ndjek procedurat administrative të shqyrtimit dhe procedurat e hetimit administrativ, në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.

## Metodologjia e nxjerrjes dhe përpunimit të të dhënave

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), në nxjerrjen e të dhënave statistikore, është bazuar në burimet e gjeneruara nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike (SAE), Analizës Vjetore 2022 të publikuar nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP), si dhe në informacionin që APP-ja ka vënë në dispozicion nëpërmjet postës zyrtare elektronike të KPP-ës.

Të dhënat statistikore të këtij raporti janë në përputhje me 5 (pesë) parimet e përcaktuara në "Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane" për proceset statistikore. Parimet janë si më poshtë:

- Relevanca - plotësojnë nevojat e përdoruesve;
- Saktësia dhe besueshmëria - të dhënat reflektojnë realitetin;
- Afatet kohore dhe përpikëria - statistikave publikohen në kohë dhe me përpikëri;
- Koherenca dhe krahasueshmëria - të dhënat kanë konsistencë të brendshme dhe përmbajnë krahasim në periudha të ndryshme;
- Qasja dhe qartësia - të dhënat publikohen në format të përshtatshëm, janë të paanshme.

Nga sa më sipër, në vijueshmëri gjeni të dhënat statistikore të ankesave në Komisionin e Prokurimit Publik për vitin 2022.

## Të dhëna të përgjithshme statistikore mbi llojet e ankesave të paraqitura në Komisionin e Prokurimit Publik

Gjatë periudhës 1 janar 2022 - 31 dhjetor 2022, janë regjistruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik 794 ankesa në total, prej të cilave 782 ankesa janë paraqitur për procedurat e prokurimit publik, 8 (tetë) ankesa për procedurat e ankandit publik, 4 (katër) ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Numri total i ankesave për procedura unike të publikuara gjatë vitit 2022 është 532, nga 6494 procedura të publikuara për t'u zhvilluar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

Nr.	Procedura të publikuara nga APP për vitin 2022 <sup>1</sup>	Procedura të publikuara në vitin 2022 dhe të ankimuar në vitin 2022 në Komisionin e Prokurimit Publik
1	6494	532

Tabela 10: Të dhëna të përgjithshme statistikore

<sup>1</sup> Shih: Tabelën 4, faqa 16 e Analizës Vjetore 2022 e Agjencisë së Prokurimit Publik.

### Kategorizimi i ankimeve sipas numrit total dhe vlerës së tyre për secilin autoritet kontraktor, llojit të procedurës së prokurimit, si dhe fazës së procesit për të cilin është paraqitur ankimi

Gjatë vitit 2022, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë paraqitur ankesa lidhur me vendimmarrjen për procedurat e prokurimit publik, ankande publike, ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë për 201 autoritete kontraktore nga 411 të tilla, që kanë krijuar procedura prokurimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Komisioni i Prokurimit Publik, ka marrë vendime në lidhje me ankesat unike të paraqitura për vitin 2022, për procedura unike të publikuara në vitin 2021, për të cilat është paraqitur ankesa në vitin 2022, si dhe për procedura unike të publikuara në vitin 2022, të cilat në total, referuar fondit limit të prokuruar, arrijnë një vlerë prej 22,517,182,268 lekë, ndërsa totali i fondit limit, për ankesat unike për procedurat unike të publikuara në vitin 2022 është 20,412,194,409 lekë, nga totali prej 170,200,854,721 lekësh të publikuara për prokurim, pra 12 % e fondit limit total të publikuar për prokurim, janë paraqitur ankesa në procedurat përkatëse.

Nga 6,494 procedura të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronike gjatë vitit 2022, për prokurime publike me vlerë totale prej 170,200,854,721 lekë,<sup>2</sup> për 532 prej këtyre procedurave me vlerë prej 20,412,194,409 lekë, janë paraqitur ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Gjatë vitit 2022, është vënë re një rritje e lehtë e numrit të ankimeve administrative të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në një total prej 794 ankesash, krahasuar kjo me vitin paraardhës 2021, gjatë të cilit, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë dorëzuar 768 ankesa.

Gjatë vitit 2022, muaji nëntor është muaji me numrin më të lartë të ankesave, me 95 ankesa, dhe ai me numrin më të ulët të ankesave është muaji janar, me 32 ankesa.

Nr.	Ankesa të depozituara në KPP	2020	2021	2022
1	Procedurë Prokurimi Publik	732	762	782
2	Koncesion	1	0	0
3	Ankand	3	3	8
4	Leje Minerare	5	1	0
5	Ankesa në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë	-	2	4
Total		741	768	794

Tabela 11: Ankesat sipas llojit për vitet 2020, 2021, 2022

### Të dhëna statistikore për numrin total të ankesave sipas fazës për të cilën është paraqitur ankimi

Nga 794 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër) ankesa të paraqitura në total, 308 prej tyre ose rreth 39 %, janë ankesa të paraqitura për dokumentet e tenderit dhe 486 ankesa ose rreth 61 % e tyre, janë ankesa të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave. Më poshtë po paraqesim dy tabela me dhjetë autoritetete kontraktore, që kanë numrin më të lartë të ankimeve për secilën fazë.

Nr.	Ankesa të depozituara në KPP	2020	2021	2022
1	Dokumente tenderi	216	298	308
2	Vlerësim	525	470	486
Total		741	768	794

Tabela 12: Ankesat e depozituara në Komisionin e Prokurimit Publik në tri vitet e fundit dhe faza procedurale për të cilën janë paraqitur ankesat

Gjatë vitit 2022, numri total i autoriteteve kontraktore për të cilat është paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik është 201 (dyqind e një) nga 411<sup>3</sup> autoritete kontraktore që kanë krijuar procedura prokurimi me vlerë mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël, ose për 50 % të autoriteteve kontraktore që kanë zhvilluar procedura prokurimi janë paraqitur ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Ndërkohë që numri i operatorëve ekonomikë ankimues është 300 (treqind). Detajet mbi fondin limit për secilin autoritet kontraktor, si dhe objektin e kontratës, si punë, mall, shërbim etj., i gjeni të detajuara në aneksin nr.1, pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nr.	Autoriteti kontraktor	Fazën për të cilën është paraqitur		Pranim		Mospranim		Të mbyllë çështjen/ pranim nga AK		Tërheqje nga ankesa	
		DST	Vlerësim	DST	Vlerësim	DST	Vlerësim	DST	Vlerësim	DST	Vlerësim
1	Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ish Agjencia e Blerjeve të Përqendruara)	27	38	18	24	5	6	4	6	-	1
2	SH.A Ujësullës Kanalizime Tiranë	10	18	8	4	1	9	1	1	-	4
3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	12	13	-	1	12	9	-	-	-	2
4	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	2	16	-	7	2	3	-	3	-	-
5	Bashkia Durrës	-	15	-	3	-	7	-	3	-	-
6	Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë	4	9	2	2	1	3	1	4	-	-
7	Sh.A Posta Shqiptare	12	7	8	2	1	1	1	-	-	-
8	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	11	1	10	-	-	1	1	-	-	-
9	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit	7	7	6	3	1	1	-	-	-	-
10	Ministria e Mbrojtjes	2	11	1	-	1	4	-	1	-	4

**Tabela 13:** Autoritetet kontraktore me numrin më të lartë të ankesave të dorëzuara për vitin 2022, fazat për të cilat është paraqitur edhe vendimmarrja e KPP-së

**Shënim:** Në tabelë është pasqyruar vendimmarrja e KPP-së deri në 31 Dhjetor 2022. Ankesat për të cilat KPP-ja është shprehur me vendim pas kësaj date, do të pasqyrohen në raportin e vitit 2023

Nr.	AK	Totali i procedurave të publikuara me fond mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël <sup>4</sup>		Totali i procedurave të ankimuar me fond mbi kufirin monetar për procedura me vlerë të vogël		Lloji i kontratës		
		DST	Vlerësim	DST	Vlerësim	Punë	Mall	Shërbim
1	Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara (ish Agjencia e Blerjeve të Përqendruara)	203	32	16	16	-	16	16
2	SH.A Ujësullës Kanalizime Tiranë	73	20	11	8	1	11	8
3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	296	21	20	-	1	20	-
4	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	10	5	5	-	-	5	-
5	Bashkia Durrës	96	11	4	5	2	4	5
6	Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë	392	3	2	1	-	2	1
7	Sh.A Posta Shqiptare	28	7	6	1	-	6	1
8	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	7	7	7	-	-	7	-
9	Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit	66	8	3	4	1	3	4
10	Ministria e Mbrojtjes	69	9	3	3	3	3	3

**Tabela 14:** Për autoritetet kontraktore me numrin më të lartë të ankesave unike për vitin 2022, dhe të procedurave unike të publikuara në SPE në vitin 2022, me fond limit, mbi kufirin monetar për procedurat me vlerë të vogël

<sup>4</sup> Shih: Tabelën 43, faqa 58 e Analizës Vjetore 2022 e Agjencisë së Prokurimit Publik.



## Numri i ankesave të paraqitura sipas intervalit të fondeve limit pa TVSH

Nga analiza e përgjithshme rezulton, se numri më i lartë i ankesave është paraqitur për procedurat e prokurimit në intervalet e fondeve limite, midis vlerave 1,000,000-5,000,000 lekë, e cila zë 37.59 % të totalit të ankimeve të paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ndërkohë që për procedurat me fond limit mbi 100,000,000 lekë, zënë rreth 9.02 % të numrit të ankesave.

Në analizimin e të dhënave statistikore mbi shqyrtimin e ankesave gjatë vitit 2021, referuar 6 intervaleve të fondeve limite të procedurave të prokurimit/ankandëve/lejeve minerare dhe koncesioneve/PPP, shqyrtuar gjatë vitit 2021, pranë Komisionit të Prokurimit Publik konstatohet se:

- 32.03% e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 1,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së, deri në 5,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së;
- 30.86 % e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 10,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së, deri në 50,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së;
- 19.27 % e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 5,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së, deri në 10,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së;
- 8.98% e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 50,000,001 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së, deri në 100,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së;
- 6.64% e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit mbi 100,000,000 lekë pa përfshirë vlerën e TVSH-së
- 2.21 % e ankesave të administruara gjatë vitit në raportim, lidhen me procedurat me fond limit nga 0 lekë deri në 1,000,000 lekë, pa përfshirë vlerën e TVSH-së;

Në mënyrë të përmbledhur, të dhënat statistikore, duke u mbështetur në fondin limit, garancinë e ofertës, vlerën e investimit ose vlerën e parashikuar të kontratës për çdo rast konkret nga autoritetet kontraktore, paraqiten si më poshtë për 3 vitet e fundit:

## 2020

Intervalet e fondit limit pa TVSH		Procedura prokurimi	
Nga	Deri	Nr. Çështjes	Në %
Pa fond limit		2	0.27
0	800,000	6	0.81
800,001	1,000,000	15	2.02
1,000,001	5,000,000	261	35.22
5,000,001	10,000,000	143	19.30
10,000,001	50,000,000	159	21.46
50,000,001	100,000,000	56	7.56
Mbi 100,000,000		99	13.36
Total		741	100%

## 2021

Intervalet e fondit limit pa TVSH		Procedura prokurimi	
Nga	Deri	Nr. Çështjes	Në %
Pa fond limit		0	0.00
0	1,000,000	17	2.21
1,000,001	5,000,000	246	32.03
5,000,001	10,000,000	148	19.27
10,000,001	50,000,000	237	30.86
50,000,001	100,000,000	69	8.98
Mbi 100,000,000		51	6.64
Total		768	100%

## 2022

Intervalet e fondit limit pa TVSH		Procedura prokurimi	
Nga	Deri	Nr. Çështjes	Në %
Pa fond limit		1	0.19
0	1,000,000	22	4.14
1,000,001	5,000,000	200	37.59
5,000,001	10,000,000	102	19.17
10,000,001	50,000,000	118	22.18
50,000,001	100,000,000	41	7.71
Mbi 100,000,000		48	9.02
Total		532	100%

**Tabelat 15:** Të dhënat statistikore, duke u mbështetur në fondin limit, garancinë e ofertës, vlerën e investimit ose vlerën e parashikuar të kontratës për çdo rast konkret nga autoritetet kontraktore

Fondi limit unik i ankumuar për procedurat unike të publikuara në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në vitin 2022, është 20,412,194,409 lekë pa TVSH.

	DST	Vlerësim
Vlera e fondit limit (procedura unike)	7,316,228,745	12,984,514,294

**Tabela 16:** Fondi limit total i procedurave sipas fazës së paraqitjes së ankesës

Totali i fondit limit jounik të ankumuar, për të cilin është vendosur pranim i ankesës për vitin 2022, është 9,037,931,674 leke pa TVSH, ndërsa totali i fondit limit të ankumuar jounik, për të cilin është vendosur mospranim i ankesës, është 12,371,933,932 lekë pa TVSH.

	Pranim	Mospranim
Vlera e fondit limit (procedura jounike)	9,037,931,674	12,371,933,932

**Tabela 17:** Totali i fondit limit jounik të ankumuar

### Të dhëna statistikore për numrin total të ankesave sipas llojit të kontratës për punë, mall, shërbim

Gjatë vitit 2022, numrin më të madh të ankesave unike, e zënë ato në lidhje me procedurat unike të prokurimit për kontratat për mallra me 486 të tilla, për kontratat për shërbime me 235 ankesa, duke vijuar me ankesat për kontratat për punë publike me 73 ankesa.

Tipi ankesës	Të ankumuar në Komisionin e Prokurimit Publik për vitin 2022	Të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik në vitin 2022 <sup>5</sup>
Punë	58	1,156
Mall	308	3,706
Shërbim	166	1,632

**Tabela 18:** Të dhëna statistikore për numrin total të ankesave sipas llojit të kontratës për punë, mall, shërbim

<sup>5</sup> Shih: Tabelën 47, faqa 60 e Analizës Vjetore 2022 e Agjencisë së Prokurimit Publik.

<https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=83d7547a-e8c9-4458-9321-e6eeef5324e6>

### Ankesa sipas tipit të kontratës

Numri total i ankesave të paraqitura për procedura unike gjatë vitit 2022, sipas tipit të kontratës, shërbim, mall, punë, në krahasim me procedurat e prokurimit të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik gjatë vitit 2022, është sipas tabelës së mëposhtme:

Lloji i Procedurës	Punë Publike		Mallra		Shërbim	
	Numri i procedurave të publikuara në SPE <sup>8</sup>	Numri i procedurave të ankumuar	Numri i procedurave të publikuara në SPE <sup>7</sup>	Numri i procedurave të ankumuar	Numri i procedurave të publikuara në SPE <sup>6</sup>	Numri i procedurave të ankumuar
Procedurë e hapur	502	27	854	72	286	27
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	0	-	0	-	1	-
E hapur mbi kufirin e lartë monetar	39	3	556	64	248	26
E Hapur e Thjeshtuar	541	20	2289	160	899	96
Shërbim Konsulence/ Konkurs Pro-jektimi	0	-	0	-	89	5
E kufizuar	11	4	2	2	3	2
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar	0	-	5	2	15	1
E kufizuar për Rindërtimi	62	4	0	-	79	2
E kufizuar mbi kufirin e lartë monetar për Rindërtimin	1	-	0	-	3	-

**Tabela 19:** Ankesa sipas tipit të kontratës


<sup>6</sup> Shih: Tabelën 5, faqa 18 e Analizës Vjetore 2022 e Agjencisë së Prokurimit Publik.

<https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=83d7547a-e8c9-4458-9321-e6eeef5324e6>

<sup>7</sup> Shih: Footnote 6 | <sup>8</sup> Shih: Footnote 6

**Të dhëna statistikore mbi shpërndarjen e ankesave sipas qarqeve për autoritetet kontraktore**

Tiranë	556
Fier	51
Durrës	44
Vlorë	23
Elbasan	23
Shkodër	20
Berat	19
Korçë	17
Lezhë	16
Gjirokastër	13
Kukës	7
Dibër	5



Për sa i përket vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me pranimin ose refuzimin e ankesave për ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2020, 2021, 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Viti	Pranuar		Mospranim		Mosmarrje në shqyrtim		Tërheqje nga ankesa		Të mbyllë çështjen	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
2020	354	46.5%	361	47.4%	28	3.7%	18	2.4%	-	-
2021	327	42.1%	343	44.2%	31	4%	21	2.7%	56	7%
2022	343	42.4%	335	41.4%	3	0.4%	39	4.8%	89	11%

**Tabela 20:** Paraqitje e vendimmarrjeve të Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me pranimin ose refuzimin e ankesave për ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2020, 2021, 2022

Vendimmarrja e Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me pranimin ose refuzimin e ankesave për ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2022 sipas llojit të tipit të kontratës është si më poshtë:

Tipi i kontratës	Pranim i plotë ose i pjesshëm i ankesave	Mospranim i ankesave	Të mbyllë çështjen/ pranim nga ana e autoritetit kontraktor	Tërheqje nga ankesa
Punë	23	38	5	9
Mall	236	191	55	13
Shërbim	84	106	29	17
Total	343	316	89	39

**Tabela 21:** Vendimmarrja e Komisionit të Prokurimit Publik për ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2022



Vendime deklarative ku autoriteti kontraktor pranon pjesërisht ankesën	Vendime deklarative përfundimtare ku autoriteti kontraktor pranon plotësisht ankesën/at	Vendime themeli	Vendime për tërheqje nga ankesa
100	64	614	37

**Tabela 22:** Të dhëna statistikore mbi vendimmarrjet e Komisionit të Prokurimit Publik

Nr.	Pranim / Mospranim	DST	Vlerësim
1	Pranim	167	138
2	Mospranim	87	220

**Tabela 23:** Raporti i pranimit dhe mospranimit të ankesave nga Komisioni i Prokurimit Publik, sipas fazës procedurale të paraqitjes së tyre

## Monitorimi i zbatimit të vendimeve dhe masat ndëshkuese

Rezulton, se gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik, gjatë vendimmarrjes së tij, ka konstatuar shkelje në procedurat e prokurimit publik nga ana e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë për 10 (dhjetë) çështje, të cilat i janë referuar për hetim administrativ Agjencisë së Prokurimit Publik, njëra prej të cilave i është referuar për hetim administrativ Agjencisë së Prokurimit Publik, Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Nga hetimi i thelluar për 10 (dhjetë) çështjet e referuara, Agjencia e Prokurimit Publik, për 1 (një) prej tyre ka vendosur t'i propozojë titullarit të autoritetit kontraktor marrjen e masës administrative ndaj personit përgjegjës për prokurimet, për 1 (një) ka vendosur t'i propozojë titullarit të AK-së marrjen e masave administrative ndaj personit përgjegjës për prokurim dhe anëtarëve të KVO-së dhe për 1 (një) prej tyre, përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimeve publike për 12-të muaj.

Krahas çështjeve të dërguara për hetim administrativ gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur masë administrative gjorbë ndaj 2 (dy) titullarëve të autoriteteve kontraktore, si rezultat i refuzimit për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik.

Nr.	Vendime të KPP-së të dërguara për hetim administrativ APP-së gjatë 2022	Statusi		
		Në proces	Pushuar	Vendimmarrje
1	KPP 139/2022			Tërheqje vëmendje AK-së, pasi duhet të pasqyrohet arsyen e plotë që ka sjellë anulimin e procedurës
2	KPP 140/2022			Tërheqje vëmendje AK-së, pasi duhet të pasqyrohet arsyen e plotë që ka sjellë anulimin e procedurës
3	KPP 197/2022			
4	KPP 198/2022			
5	KPP 398/2022			Propozuar titullarit të AK-së marrjen e masave administrative ndaj personit përgjegjës për prokurim
6	KPP 527/2022			
7	KPP 714/2022			Propozuar titullarit të AK-së marrjen e masave administrative ndaj personit përgjegjës për prokurim dhe anëtarëve të KVO-së
8	KPP 928/2022			Propozuar titullarit të AK-së marrjen e masave administrative ndaj anëtarëve të KSHA-së
9	KPP 964/2022			
10	KPP 1038/2022			Përjashtuar operatori ekonomik për 12-të muaj

**Tabela 24:** Rezultatet e hetimit administrativ të Agjencisë së Prokurimit Publik për rastet e referuara nga Komisioni i Prokurimit Publik

Nr.	Vendimi KPP	Masë administrative gjobë
1	KPP 360/2022	50,000
2	KPP 1147/2022	50,000

**Tabela 25:** Vendimet administrative, ku Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur marrjen e masës administrative gjobë

### Vendimet interpretuese

Komisioni i Prokurimit Publik edhe gjatë vitit 2022 ka vijuar me publikimin në faqen zyrtare të buletinëve periodike, për të gjithë operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, si dhe të njoftimeve mbi praktikën vendimmarrëse në çështje specifike, me rëndësi për sistemin dhe me synim shmangien e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Në mbështetje të nenit 24, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", ku përcaktohet, se Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur me disa vendime interpretuese si më poshtë vijon:

#### **Vendimi KPP 97/2022, datë 26.01.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi veçanërisht në lidhje me detyrimin e autoritetit kontraktor për të verifikuar plotësimin e elementëve formale të ankesës dhe njoftimin për korrigjimin e të metave në përputhje me pikën 3, të nenit 111, të ligjit 162/2020, "Për prokurimin publik". Privimi i operatorit ekonomik ankimes nga mundësia që i jep ligji për të korrigjuar një prej elementeve formale të domosdoshme, cenon rëndë një prej të drejtave themelore në procedurat e prokurimit publik, që është e drejta e ankimit, e cila çon në anulimin e procedurës.

#### **Vendimi KPP 199/2022, datë 25.02.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me momentin procedural të nisjes së afateve të ankimit, për procedurat e prokurimit me faza. Në përputhje me pikën 3, të nenit 110, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik".

#### **Vendimi KPP 231/2022, datë 09.03.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me detyrimin e operatorit ekonomik për respektimin e elementëve të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, një prej të cilave është dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën, në përputhje me pikën 2, të nenit 111, të ligjit 162/2020, "Për prokurimin publik". Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi i autoritetit kontraktor, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

#### **Vendimi KPP 355/2022, datë 19.04.2022**

Në këtë vendim është trajtuar rasti në të cilin Autoriteti Kontraktor, në rubrikën "Kërkesa", në Sistemin e Prokurimit Elektronik, shton një kriter të ri kualifikimi, i cili nuk është parashikuar në dokumentet e tenderit dhe vlerësimi është kryer mbi këtë kriter.

#### **Vendimi KPP 397/2022, datë 29.04.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht lidhur me detyrimin e autoritetit kontraktor, që përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në nenin 26, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

#### **Vendimi KPP 608/2022, datë 28.06.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje që kanë të bëjnë me rastin e dorëzimit të ofertave anomalisht të ulta, dhe mbi detyrimin e operatorit/ve ekonomikë për dorëzimin e dokumentacionit konkret në lidhje me metodën e ndërtimit të ofertës në përputhje me ligjin për prokurimin publik.

**Vendimi KPP 714/2022, datë 26.07.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve procedurale të autoritetit kontraktor ose enteve kontraktore, në zbatim të nenit 26, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**Vendimi KPP 727/2022, datë 28.07.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në hartimin e specifikimeve teknike, të cilat duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, në zbatim të nenit 36, pika 1, paragrafi 4, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", dhe të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët/ ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

**Vendimi KPP 729/2022, datë 29.07.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me legjitimitimin e operatorit ekonomik për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 114, pika 6, të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik".

**Vendimi KPP 783/2022, datë 12.08.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me momentin procedural të kërimit të dokumenteve, për sa i përket përmbushjes së kriterëve nëpërmjet "Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit", në përputhje me nenin 26, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**Vendimi KPP 813/2022, datë 25.08.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor ose enteve kontraktore që refuzojnë ofertën, pasi oferta është anomalisht e ulët. Autoriteti kontraktor nuk ka respektuar hapat procedurale të parashikuar nga ligji, në përputhje me nenin 93, pika 3, të ligjit 162/2020, "Për prokurimin publik" dhe nenin 82, pika 4 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

**Vendimi 849/2022, datë 02.09.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi veçanërisht në lidhje me veprimet e autoritetit kontraktor për verifikimin e mostrave të administruara. Autoriteti kontraktor nuk ka treguar kujdesin e duhur në lidhje me ruajtjen dhe administrimin e mostrave gjatë procesit të verifikimit/testimit të tyre.

**Vendimi 861/2022, datë 07.09.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik, për shkak të mosdorëzimit të dokumentacionit provues në përputhje me deklaratimet e dhëna në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Operatori ekonomik ka dështuar që në datën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor sipas parashikimeve të nenit 26, të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, të paraqesë informacion pranë autoritetit kontraktor.

**Vendimi 869/2022, datë 09.09.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në dorëzimin e ankesës para afatit nga operatorit ekonomik, referuar nenit 110, pika 2, e ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik".

**Vendimi KPP 923/2022, datë 23.09.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për riskualifikimin në mënyrë të përsëritur të operatorit ekonomik ankimes, në shkelje të parashikimeve ligjore, në kundërshtim me nenin 2, të ligjit 162/2020, "Për prokurimin publik". Nuk është kryer verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik brenda afateve ligjore, por pas publikimit të njoftimit të fituesit.

**Vendimi KPP 1013/2022, datë 18.10.2022**

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me momentin procedural të nisjes së afateve të ankimit, ku operatorit ekonomik ankimes ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik përpara afatit të parashikuar në përputhje me nenin 110, pika 4, e ligjit 162/2020, "Për prokurimin publik".



### Vendimi KPP 1018/2022, datë 20.12.2022

Në këtë vendim janë trajtuar çështje me rëndësi, veçanërisht në lidhje me mënyrën e plotësimit të kriterëve të kualifikimit nëpërmjet "Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit" të parashikuar në nenin 26, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

### Vendimi KPP 1120/2022, datë 16.11.2022

### Vendimi KPP 1197/2022, datë 02.12.2022

Në këto vendime janë trajtuar çështje me rëndësi, në lidhje me legjitimitimin e operatorit ekonomik për paraqitjen e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, referuar nenit 53 të ligjit nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"

## Monitorimi i zbatimit të vendimeve

Në zbatim të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", vendimet e marra nga Komisioni Prokurimit Publik janë administrativisht përfundimtare. Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", në nenin 131 të tij, parashikon shprehimisht: "Refuzimi i autoritetit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik, Agjencinë e Prokurimit Publik, ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë". Është kjo dispozitë, e cila qartëson fuqinë detyruese të vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, si administrativisht përfundimtare.

Zbatimi në kohë i vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, lidhet drejtpërdrejtë me elementet e një procesi të rregullt ligjor për palët në proces, si edhe nga ana tjetër, mbron interesin më të lartë publik, për marrjen në kohë të punë/mallra/shërbime dhe shmangien e përdorimit të procedurave me negociim. Struktura e posaçme e monitorimit dhe e verifikimit të zbatimit të vendimeve të KPP-së, ka vijuar me monitorimin e zbatimit të vendimeve të PP-së edhe gjatë vitit 2022. Falë kësaj strukture, gjatë vitit 2022 vihet re, se **është rritur ndjeshëm zbatimi në kohë i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.**

Nga monitorimi i kryer për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka shqyrtuar në total 809 ankesa, nga të cilat, për 343 ankesa, pas shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik, ka vendosur, që autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet të specifikuar në vendim, ndërsa në vitin 2021 rezultonte, se Komisioni i Prokurimit Publik ka shqyrtuar në total 776 ankesa, nga të cilat, për 327 ankesa, pas shqyrtimit administrativ të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik, ka vendosur, që autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet të specifikuar në vendim.

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik, pas tejkallimit të afatit ligjor të përcaktuar për zbatimin e vendimeve nga ana e autoritetit kontraktor, ka dërguar **43 (dyzetë e tre) kërkesa** drejtuar autoriteteve kontraktore për zbatim vendimi, ndërsa gjatë vitit 2021 numri i kërkesave dërguar autoriteteve kontraktore arrinte në 60 (gjashtëdhjetë).

Instrumenti i monitorimit të zbatimit të vendimeve, përmes një strukture të posaçme dhe të dedikuar ka sjellë në këtë mënyrë rritjen e shpejtësisë së zbatimit të vendimeve nga ana e autoriteteve kontraktore të vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.

Shpejtësia mesatare e zbatimit të vendimit nga ana e autoritetit kontraktor është 7 ditë nga dalja e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Ndërgjegjësimi i autoriteteve kontraktore për zbatimin e vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik në kohë, ka sjellë gjithashtu kontribut në uljen e rasteve të përdorimit të procedurave me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

## Problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesave

### Problematikat e identifikuar në funksionimin e sistemit të ankimit për prokurimin publik

Komisioni i Prokurimit Publik, vitet e fundit është pozicionuar si organ i shqyrtimit administrativ të procedurave të prokurimit, i pavarur nga pushteti ekzekutiv, ashtu siç kërkojnë standardet bashkëkohore të menaxhimit të financave publike.

Kjo dinamikë zhvillimi, e përball Komisionin e Prokurimit Publik, me sfida të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të performancës së tij, të lidhur ngushtë me objektin e tij të aktivitetit, por njëkohësisht, për shkak të hapësirave që Komisioni i Prokurimit Publik ka në identifikimin e fenomeneve problematike në nivel sistemi, krijon dhe mundësinë, që ky institucion të kontribuojë në përmirësimin në tërësi, të sistemit të prokurimit publik.

#### Vlerësime të përgjithshme:

- ▶ Edhe gjatë vitit **2022** rezultojnë një numër i lartë i ankimeve, që paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik me një kompleksitet të lartë.
- ▶ Gjatë vitit **2022**, rezultojnë, se problematika shumëvjeçare e abuzimit të instrumenteve të ankimit administrativ për prokurimet publike nga shoqëritë e ruajtjes dhe sigurisë fizike, gjë që ka shkaktuar një mbingarkesë të theksuar të Komisionit të Prokurimit Publik ndër vite, ka rënë. Në vitin **2022**, janë regjistruar vetëm **9** ankesa ose thënë ndryshe **1.1%** e totalit të ankesave, krahasuar me **3%** në vitin paraardhës, për prokurimet në fushën e ruajtjes dhe sigurisë fizike.

Një ndër arsytet e uljes së numrit të ankesave është edhe ajo e kryerjes së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike për autoritetet/entet kontraktore nga shoqëria shtetërore "Illyrian Guard" SHA në përputhje me Vendimin nr. 177, datë 04.04.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e shoqërisë 'Illyrian Guard SHA'" dhe për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj Shoqërie"

- ▶ Me digjitalizimin e shërbimit të dorëzimit të ankesave dhe argumenteve, si edhe falë fushatave informuese të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, nuk është konstatuar problematika e vitit **2021** e dorëzimit të ankesave, referuar formularëve të ankimit, të cilat nuk janë në fuqi ose që i referohen ligjit të vjetër.
- ▶ Referuar formës së paraqitjes së ankimit, janë konstatuar raste në të cilat, operatorët ekonomikë nuk kanë paraqitur ankimin e tyre sipas formularit përkatës.
- ▶ Gjatë vitit **2022**, shfaqet një rritje e ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore për bashkëpunimin me Komisionin e Prokurimit Publik, në drejtim të dorëzimit të informacioneve të kërkuara edhe zbatimit brenda afateve ligjore të vendimit të Komisionit.

Në drejtim të funksionimit të sistemit të ankimit për prokurimin publik, janë identifikuar problematikat në vijim.

## 10 Problematikat e autoriteteve kontraktore

Në një numër të konsiderueshëm rastesh është konstatuar, se autoritetet kontraktore nuk janë mjaftueshëm të informuara për ndryshimet e ligjit të prokurimit publik, veçanërisht në drejtim të procedurës së ankimit. Dhjetë gabimet/problematikat tipike të autoriteteve kontraktore paraqiten si më poshtë vijon:

1. Hartimi nga ana e autoriteteve kontraktore e kriterëve të veçanta të kualifikimit të paqarta, evazive, të cilat kanë sjellë paqartësi, konfuzion në procesin e vlerësimit të ofertave dhe/ ose pabarazi në trajtimin e të drejtave dhe detyrimeve të operatorëve ekonomikë.
2. Hartimi nga ana e autoriteteve kontraktore i specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 36, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar. Gjatë vendimmarrjes janë konstatuar disa shkelje të nenit 36, të ligjit për prokurimin publik veçanërisht në drejtim të hartimit të specifikimeve teknike, duke mos u mbështetur në një prej metodave të parashikuara në ligj. Gjithashtu, në disa raste janë konstatuar mospërputhje midis specifikimeve

teknike dhe dokumenteve të procedurave të prokurimit, ku në specifikimet tenike janë lejuar alternativat, ndërkohë në dokumentet e procedurës së prokurimit nuk janë pranuar.

**3.** Shkelje procedurale të kryera nga autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit të ofertave; Në disa raste janë konstatuar shkelje në drejtim të argumentimit të arsyeve të skualifikimit, në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe Kodin e Procedurave Administrative. Autoritetet kontraktore kryesisht i referohen vetëm kriterit, i cili pretendohet, se nuk përmbushet, por pa dhënë argumente të detajuara.

Gjithashtu, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik janë konstatuar raste të mosargumentimit të vlerësimit me pikë, në rastet e përdorimit të ofertës ekonomike më të favorshme, si kriter i përcaktimit të ofertës fituese.

**4.** Kryerja e procesit të administrimit, trajtimit dhe verifikimit të mostrave nga ana e autoritetit kontraktor, jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik; Gjithashtu, në vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, janë konstatuar raste të testimit të mostrave nga ana e autoriteteve/enteteve kontraktore në laboratorë jo të akredituar në përputhje me legjislacionin sektorial.

**5.** Gabime në përlogaritjen e fondit limit, veçanërisht në procedurat e prokurimit publik, ku përlogaritja e fondit limit duhej të kryhej referuar çmimeve të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse në përputhje me nenin 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të prokurimit".

**6.** Vijon problematika nga ana e autoriteteve kontraktore e mosnjohjes së mirë të ndryshimeve të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimet publike", nga ana e autoriteteve kontraktore, veçanërisht mbi momentin procedural të fillimit të afateve të ankimit.

**7.** Vijon problematika e autoriteteve kontraktore e moskryerjes së veprimeve procedurale të ngarkuara nga ligji, për komunikimin midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë, për korrigjimin e të metave të ankesës.

**8.** Vijon problematika e autoriteteve kontraktore e moskryerjes së veprimeve procedurale të parashikuara nga neni 114, "Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor", të ligjit nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", nga ana e autoriteteve kontraktore për njoftimin e vendimmarrjes mbi trajtimin e ankesës, jo vetëm operatorëve ekonomikë ankimues, por edhe subjekteve të interesuara.

**9.** Problematikat mbi veprimet procedurale të autoriteteve kontraktore, të kryerjes së verifikimeve të deklarimeve të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

**10.** Problematikë është shfaqur edhe mungesa në disa raste e dhënies së sqarimeve të plota të autoriteteve kontraktore, ndaj kërkesave për sqarim të operatorëve ekonomikë ankimues.

### **10 Problematikat/gabimet procedurale të konstatuara në ankesat e operatorëve ekonomikë**

Në një numër të konsiderueshëm rastesh është konstatuar, se operatorët ekonomikë nuk janë mjaftueshëm të informuar për formën, afatet dhe procedurat e përcaktuara nga ligji, për ankimin administrativ për prokurimin publik. Kjo sjell në shumë raste, mospranimin e ankesave të paraqitura, vetëm për mosplotësim të kriterëve formale. Dhjetë gabimet/problematikat tipike të autoriteteve kontraktore paraqiten si më poshtë vijon:

**1.** Një problematikë e përsëritur edhe nga viti i kaluar është ai i mosrespektimit të afateve të ankimit nga ana e operatorëve ekonomikë, duke mos njohur plotësisht parashikimet e ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Janë konstatuar raste të paraqitjes së ankimit që në momentin që njihen me klasifikimin e ofertave dhe duke mos pritur publikimin e njoftimit të fituesit apo njoftimin e anulimit të procedurës, në rastet kur nuk ka asnjë ofertë të kualifikuar.

**2.** Operatorë ekonomikë kanë paraqitur ankimin e tyre, pa paraqitur formularin e pagesës, kusht ky i domosdoshëm për vlefshmërinë e ankimit.



3. Operatorët ekonomikë, në cilësinë e subjektit të interesuar, të prekur nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos ezauruar shkallën e paraqitjes së argumenteve pranë autoriteteve kontraktore dhe KPP-së, sipas parashikimeve të pikës 1 të nenit 113.

4. Operatorët ekonomikë në dorëzimin e ankesave pranë autoriteteve/enteve kontraktore nuk kanë identifikuar qartësisht objektin e ankesës dhe pretendimet e tyre.

5. Operatorët ekonomikë nuk janë të qartë mbi ndryshimet mes kërkesave për sqarim të dokumenteve të procedurës së prokurimit dhe kërkesave për ndryshim të kriterëve të veçanta të kualifikimit/ specifikimet teknike. Në zbatim të ligjit të prokurimit publik, në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.

6. Në rastin e konstatimit të ofertave anomalisht të ulëta, në kuptim të nenit 93, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", operatorët ekonomikë kanë dështuar të dorëzojnë argumente të plota në drejtim të anës ekonomike të ndërtimit të ofertës në zbatim të parashikimeve të ligjit.

7. Operatorët ekonomikë në disa raste, pas shqyrtimit të ankesës nga ana e autoritetit/entit kontraktor dhe në fazën procedurale të shqyrtimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, riparaqesin ankesë mbi vendimmarrjen e autoritetit.

8. Operatorët ekonomikë nuk janë mjaftueshëm të njohur me ndryshimet e ligjit të prokurimit publik për afatet e paraqitjes së ankesave në rastin e parashikimeve të nenit 114, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

9. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, për të cilat referuar nenit 116, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nuk janë në kompetencën lëndorë të Komisionit të Prokurimit Publik të shqyrtimit të tyre.

10. Gabime materiale të operatorëve ekonomikë, në drejtim të dhënies së informacionit të kërkuar për secilin seksion të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Gjithashtu, janë vërejtur edhe gabime në deklarimin e ofertës ekonomike në procedurat e prokurimit të punëve publike.

## 5 Shkaqet mbi anulimin e procedurave të prokurimit

Nga numri total i ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2022, prej 809 (tetëqind e nëntë) ankesa në total, për 61 prej tyre ose për 50 procedura unike, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur për anulimin e procedurave të prokurimit publik. Ndër arsyet kryesore të konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, që kanë çuar në anulimin e procedurës janë:

1. Hartimi nga ana e autoriteteve kontraktore i kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe të paqarta, evazive, të cilat kanë sjellë paqartësi, konfuzion në procesin e vlerësimit të ofertave dhe/ ose pabarazi në trajtimin e të drejtave dhe detyrimeve të operatorëve ekonomikë.
2. Hartimi nga ana e autoriteteve kontraktore i specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 36, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik" të ndryshuar.
3. Shkelje procedurale të kryera nga autoriteti kontraktor në fazën e rivlerësimit të ofertave;
4. Kryerja e procesit të administrimit, trajtimit dhe verifikimit të mostrave nga ana e autoritetit kontraktor, jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik;
5. Gabime në përllogaritjen e fondit limit, veçanërisht në procedurat e prokurimit publik, ku përllogaritja e fondit limit duhej të kryhej referuar çmimeve të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse në përputhje me nenin 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Raste të përsëritura të shkeljeve janë konstatuar nga Njësitë e Qeverisjes Vendore në përllogaritjen e kostove të kryerjes së shërbimit të pastrim/grumbullim të mbetjeve urbane, në përputhje me Vendimin nr. 319, datë 31.5.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve".

## Masat e marra dhe propozime për përmirësimin e tyre

1. Nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për informimin e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore, mbi momentin procedural të fillimit të afateve të ankimit, si me anë të publikimit në faqen zyrtare të procedurave të ankimit referuar ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", ashtu edhe me publikimin e njoftimit, për marrjen e vendimeve interpretuese në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", sqaruar në detaje edhe në këtë raport.
2. Gjithashtu, në vitin 2022, Komisioni i Prokurimit Publik në bashkëpunim me SIGMA-OECD zhvilloi një konferencë të përbashkët me operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, mbi problematikat e konstatuara në sistemin e prokurimeve dhe përmirësimin e tyre. Gjithashtu në bashkëpunim me SIGMA-OECD dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor u zhvillua një trajnim i përbashkët me gjyqtarë dhe përfaqësues të sistemit gjyqësor.
3. Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka hartuar në mënyrë periodike buletinë mujore të veprimtarisë, në të cilat ka pasqyruar edhe problematikat e konstatuara në vendimmarrje.
4. Një fushatë e posaçme informuese online është zhvilluar për operatorët ekonomikë mbi mënyrën e dorëzimit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Propozohet nxitja e trajnimeve, si për zyrtarët e prokurimit publik edhe për punonjësit e operatorëve ekonomikë. Një kurrikul e posaçme trajnimi dhe një nivel certifikimi specifik për zyrtarët e prokurimit, njësinë/zyrtarin e prokurimit, komisionin e vlerësimit të ofertave/ zyrtarin e vlerësimit të ofertave, si edhe menaxherin e kontratave publike, vlerësojmë, se do të sillte ndikim të rëndësishëm në sistemin e prokurimit.

## Propozime për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik përmes ndryshimeve ligjore

*Për ndryshimet në Ligjin nr.162/2020 "Për prokurimin publik"*

Gjatë vitit 2021, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë paraqitur 419 ankesa referuar ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Gjatë punës të përditshme të Komisionit të Prokurimit Publik, janë konstatuar disa çështje, ndaj propozojmë ndryshimin e këtyre neneve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit për prokurimin publik.

Propozojmë ndryshime të nenit 109 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", duke shtuar të drejtën për të vënë në lëvizje Komisionin e Prokurimit Publik (rregullimin e interesit të ligjshëm-legjitimitimin substancial (ad causam).

Gjithashtu, lidhur me përcaktimet e pikës 2 të nenit 115 të ligjit nr.162/2020, kemi konstatuar, se marrja e një vendimi deklarativ për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor dhe vijimi i shqyrtimit për pjesën tjetër të ankesës, në rastet kur autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën, nuk kanë asnjë ndikim në procedurat e prokurimit, pasi përsëri procedura e prokurimit mbetet e pezulluar deri në një vendim përfundimtar. Gjykojmë, se një akt i tillë administrativ nuk sjell asnjë efekt në procedurat e shqyrtimit administrativ, përkundrazi ngarkon në mënyrë të panevojshme anëtarët dhe stafin e Komisionit të Prokurimit Publik. Për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës dhe vijimin për pjesën tjetër të saj, Komisioni i Prokurimit Publik mund të shprehet edhe në vendimin përfundimtar.

Sa më sipër, propozojmë shfuqizimin e pikës 2, të nenit 115, të ligjit nr. 162/2020.

Referuar pikës 2, të nenit 134, të ligjit, nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet se: "Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet."

Në rastin konkret propozojmë marrjen e masave për nxjerrjen e aktit të ri nënligjor në zbatim të ligjit, Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik".

## Proceset gjyqësore lidhur me vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022

Si organi më i lartë administrativ në fushën e shqyrtimit të ankesave për procedurat e prokurimit publik, vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik është administrativisht përfundimtar. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", palëve të prekura nga vendimmarrja e Komisionit të Prokurimit Publik, iu është dhënë e drejta e ankimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila ushtron juridiksion fillestar.

Numri total i vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2022, (ku përfshihen vendimet deklarative përfundimtare, vendimet e themelit dhe vendimet për tërheqjen nga ankesa), është 715. Referuar numrit total të këtyre vendimeve, për vetëm për 39 prej tyre, subjektet e prekura nga vendimmarrja e Komisionit të Prokurimit Publik kanë ngritur padi në gjykatë, që përbëjnë vetëm 5.5 % të numrit total të vendimeve.

Nga 39 padi të ngritura, 1 padi është ngritur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe 38 padi janë ngritur në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila në zbatim të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", tashmë i shqyrton paditë e ngritura kundër vendimeve të KPP-së me juridiksion fillestar.

Nga 39 padi të ngritura, në 2 raste paditësi është autoritet kontraktor, ndërsa në 37 raste paditësi është operator ekonomik. Në 1 prej rasteve, është ankimuar i njëjti vendim i KPP-së, nga 3 paditës të ndryshëm (pra, 3 paditës për 1 vendim të KPP-së). Në 6 raste, i njëjti paditës ka ankimuar 2 vendime të KPP-së (pra, 6 paditës për 12 vendime të KPP-së). Në 1 rast, i njëjti paditës ka ankimuar 3 vendime të KPP-së (pra 1 paditës për 3 vendime të KPP-së).

Në përfundim të procesit gjyqësor në shkallë të parë dhe në apel, gjykata ka vendosur pranimin e plotë për dy padi dhe të pjesshëm për 3 padi, ka vendosur rrëzimin e 10 kërkesëpadive, ndërsa 24 kërkesëpadi të tjera, janë ende në proces shqyrtimi gjyqësor, në shkallë të parë dhe në apel.

Në analizë të proceseve gjyqësore, referuar vendimeve të gjykuara të përfunduara në shkallën e parë dhe në apel, vërehet se Gjykata Administrative, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me Komisionin e Prokurimit Publik në 25.6 % të çështjeve të përfunduara dhe ka shfuqizuar vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik vetëm në 12.8 % të çështjeve të përfunduara.

Duke mbajtur në konsideratë, se deri në datën e dorëzimit të këtij raporti, janë në proces gjyqësor edhe 24 çështje, vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit, që kanë lënë në fuqi vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik, janë dukshëm më të larta në numër, në krahasim me vendimet e shfuqizuara.

Nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, kemi një vendim mbi ankesën e paraqitur nga një operator ekonomik përpara kësaj gjykate, për të cilin gjykata ka vendosur praninë të padisë. Komisioni i Prokurimit Publik ka ankimuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë në Gjykatën Administrative të Apelit.

Pasqyra e të dhënave të çështjeve gjyqësore, nxjerr në pah faktin, se Komisioni i Prokurimit Publik është një organ, i cili ka krijuar qëndrueshmëri në vendimmarrje dhe gjithashtu tregon për një konsolidim të qëndrimeve, qoftë të Komisionit të Prokurimit Publik, qoftë të gjykatave për raste të ngjashme. Ky konkluzion, arrihet jo vetëm për shkak të përqindjes së lartë të konfirmimit nga gjykata të kësaj vendimmarrjeje në krahasim me vendimet e shfuqizuara, por edhe duke vlerësuar numrin e ulët të kërkesëpadive, në krahasim me vendimet e marra nga Komisioni i Prokurimit Publik.



# V DIGJITALIZIMI I SHËRBIMEVE

## Digjitalizimi i shërbimeve dhe aksesimi nga grupet e interesit

Digjitalizimi i procesit të dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesës si pjesë e axhendës dhe objektivit strategjik të digjitalizimit të shërbimeve të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, në vijim të objektivave strategjike të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 04.11.2020, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020 - 2023 dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e saj" Masa 5.4: Ngritja e sistemit të ankesave për KKP-në (e-ankesa), ka vijuar në vitin 2022 me fazën e parë të përditësimit (up date) të "Sistemit të dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesave, e dizajnuar për të përfshirë/integruar në proces digjitalizimi edhe procese të tjera të brendshme administrative, për sa vijon:

- integrimin e kontrollit buxhetor dhe financiar të institucionit, përfshirë gjenerimi i faturës për arkëtim në rekordet financiare të kontabilitetit;
- menaxhimin gjyqësor, ndjekja në mënyrë të digjitalizuar e vendimmarrjeve të KPP-së të ankimuar në gjykatë, përfshirë vendimmarrjet e sistemit gjyqësor;
- regjistrimin audio të seancave të hapura (seancave dëgjimore);
- automatizimin e procesit të votimit;
- digjitalizimin e proceseve dhe datave të burimeve njerëzore.

Gjithashtu, në lidhje me këtë fazë, është mundësuar financimi nga buxheti i vitit 2022 i shtetit shqiptar dhe me shkresën nr. prot. 270, datë 14.02.2022, i është deleguar sërish Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si institucioni kompetent në fushën e teknologjisë, të hartojë termat e referencës dhe të zhvillojë procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e operatorit të specializuar lidhur me projektin "Fazë plotësuese, për integrimin e proceseve të brendshme administrative me sistemin e dorëzimit dhe shqyrtimin e ankesave (ERP system)", referuar pikës 5, të nenit 67, "Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar. Kjo procedurë është konkluduar me lidhjen e kontratës me nr. prot. 25, datë 01.09.2022, e zbatuar plotësisht gjatë vitit 2022.

## Impakti i digjitalizimit

Digjitalizimi i shërbimeve, ka siguruar rezultate mjaft pozitive në drejtim të transparencës dhe aksesueshmërisë dhe rrjedhimisht të besueshmërisë së operatorëve ndaj institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik. Digjitalizimi i shërbimeve ka ndryshuar rrënjësisht sjelljen e grupeve të interesit dhe të të gjithë aktorëve të sistemit të rishikimit administrativ.

## Ndryshimi i sjelljes së operatorëve ekonomikë

Operatorët ekonomikë e kanë më të lehtë dhe më të aksesueshme të paraqesin ankesë pranë autoriteteve/enteve kontraktore dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke shkurtuar kohë dhe para. Me anë të Sistemit të Ankesave Elektronike, në vetëm pak minuta operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj mund të paraqesin ankesë njëkohësisht pranë të dyja institucioneve. Gjatë vitit 2022, megjithëse, si periudhë tranzitore, ende nuk është i detyrueshëm dorëzimi i ankesave vetëm në rrugë elektronike, sërish mbi 39% e operatorëve ekonomikë zgjedhën lirisht të dorëzojnë ankesa në rrugë elektronike.

Digjitalizimi dhe rritja e besimit në institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, ka sjellë një rritje të ndjeshme dhe impakt në numrin e operatorëve ekonomikë që përdorin sistemin e rishikimit administrativ. Në ndryshim nga viti 2021, në të cilin kanë paraqitur ankesa 289 operatorë ekonomikë, në vitin 2022 kanë paraqitur ankesa 300 operatorë ekonomikë.

Gjithashtu, konstatohet, se operatorë ekonomikë të rinj në sistemin e ankimit administrativ janë 26, dy prej të cilëve janë Biznese të Mesme të Vogla.

Gjatë vitit 2022, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, realizoi një pyetësor në rrugë digjitale me operatorët ekonomikë. Pyetjeve të Komisionit të Prokurimit Publik iu përgjigjën **169** operatorë ekonomikë.

### Nga analizimi i të dhënave rezulton se:

93%

e 55 kompanive të anketuara pajtohen me faktin që transparencja inkurajon bizneset të marrin pjesë në prokurimin publik

82%

shprehen se sistemi elektronik i ankesave rrit paanësinë kur shqyrton ankesat dhe merr vendime rreth tyre

76%

shprehen, se sistemi elektronik i ankesave është më i efektshëm për bizneset në krahasim me sistemin analog

97%

e 92% të anketuarve shprehen, se informacioni i dhënë e bën procesin e ankesave më transparent dhe informues, dhe se informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i dobishëm për analizën e të dhënave dhe/ose qëllime të tjera analitike

92%

e tyre shprehen, se informacioni i dhënë në faqen e internetit i ndihmoi ata të kuptojnë më mirë procesin e paraqitjes së një ankese

**Grafikët 4:** Ndryshimi i sjelljes së operatorëve ekonomikë

### Shpejtësia e ndërveprimit dhe ulja e kostove

Përmes Sistemit të Ankesave Elektronike, operatorët ekonomikë vendas dhe të huaj mund të dorëzojnë ankesa në çdo kohë, në çdo orë për 7 ditë të javës. Sistemi ka ulur në mënyrë të ndjeshme kostot për operatorët ekonomikë. Nga ana e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik është kryer një analizë e efekteve të Sistemit të Ankesave Elektronike në drejtim të uljes së kostove.

Duke konsideruar numrin e ankesave të depozituara në rrugë elektronike, si dhe qytetin ku ka selinë operatori ekonomik që ka paraqitur ankesë, selinë e Komisionit të Prokurimit Publik dhe selinë e autoriteteve/enteve kontraktore nga analiza rezulton se janë reduktuar rreth:



**52,390km**

rrugë operatorëve ekonomikë për të paraqitur ankesa

**6810.7**

**litra**

karburant kursim



Kursim prej

**1,362,140.00 lekë**

vetëm si kosto e shërbimeve të transportit, karburant etj., ndërkohë që kostoja totale e llogaritshme e kursimit është mbi 50,000 USD

### Nënshkrimi elektronik i akteve

Sistemi i Ankesave Elektronike u jep mundësinë operatorëve ekonomikë të nënshkruajnë me nënshkrim elektronik ankesat. Sistemi i Ankesave Elektronike shfaq qasje miqësore me mjedisin, pasi janë shmangur printime vetëm nga operatorët ekonomikë për **14,662** faqe, të cilat janë administruar në rrugë elektronike.

## Ndryshimi i sjelljes së Komisionit të Prokurimit Publik

Digjitalizimi i shërbimeve ka ndryshuar gjithashtu edhe sjelljen e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik. Digjitalizimi i shërbimeve ka rritur shpejtësinë e vendimmarrjes, ku vetëm 10.1% e ankesave janë trajtuar jashtë afatit të parashikuar ligjor dhe ka shkurtuar kohën e shqyrtimit të ankesave nga 17 në 12 ditë. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave Elektronike, si edhe nënshkruan me firmë dhe vulë elektronike aktet të cilat u njoftohen palëve.

Gjatë vitit 2022, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik realizoi një pyetësor edhe me stafin e tij. 73% nga 11 të anketuar nga stafi i KPP-së shprehen se kalimi në të dhëna transparente për të gjitha subjektet e interesuara i ka bërë punën dhe misionin e KPP-së më efektive dhe 100% pajtohen, që me sistemin e ri të ankesave, ata mund të trajtojnë më shumë ankesa brenda afatit ligjor; si dhe 90% pajtohen, që sistemi i ri ka përmirësuar dhe rritur komunikimin me operatorët ekonomikë.



73% anketuar nga stafi i KPP-së shprehen se kalimi në të dhëna transparente për të gjitha subjektet e interesuara i ka bërë punën dhe misionin e KPP-së më efektive



100% pajtohen që me sistemin e ri të ankesave, ata mund të trajtojnë më shumë ankesa brenda afatit ligjor



90% pajtohen, që sistemi i ri ka përmirësuar dhe rritur komunikimin me operatorët ekonomikë

## Ndryshimi i sjelljes së autoriteteve kontraktore

Sistemi i ankesave elektronike u jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të njihen me ankesat në kohë reale të dorëzuara nga ana e operatorëve ekonomikë. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka mundësi të komunikojë me operatorin ekonomik për plotësimin e të metave të ankesës përmes SAE, të informojë Komisionin e Prokurimit Publik dhe operatorët ekonomikë mbi vendimmarrjen për shqyrtimin e ankesave, si edhe të informohet mbi vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik. Një seksion i posaçëm në profilin e autoritetit ruan edhe historikun e ankesave dhe të trajtimit të tyre. Gjatë vitit 2022 është vënë re, se autoritetet kontraktore po shmangin përsëritjen e të njëjtave gabime/problematikave.

### Digjitalizimi ka ndikuar në:

Rritjen e transparencës si mjet në luftën kundër korrupsionit

Rritjen e besimit të operatorëve ekonomikë ndaj organit të shqyrtimit të ankesave

Bashkëpunim/ndërveprim më të shpejtë dhe transparent ndërmjet aktorëve të përfshirë në proces

Ulje të kostove për palët e përfshira në proces kryesisht operatorët ekonomikë dhe jo vetëm

Efikasitet në ofrimin e shërbimit të dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesës

Akses dhe ndërveprim me operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore



## Të dhëna mbi numrin e klikimeve në faqen zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik

**Uebfaqja e Komisionit të Prokurimit Publik është klikuar 554,341 herë, ku seksionet më të klikuara rezultojnë:**

- Ankesa → **108293**
- Ankesa në shqyrtim → **10789**
- Historiku i vendimeve → **107087**
- Biblioteka online → **682**
- Njoftime → **9199**
- Vende të lira pune → **2829**
- Ndhmë dhe support Manuale → **1109**
- Ndhmë dhe support Pyetje/Përgjigje → **693**
- Ndhmë dhe support Video tutorial → **543**

**Klikueshmëria e seksioneve të lartpërmendura është kryer nga disa lloje/ tipe të pajisjeve elektronike konkretisht:**

- Desktop → **441553**
- Tablet → **16113**
- Smartphone → **41792**
- Të tjera → **54883**



## Aksesimi nga personat me aftësi të kufizuar

Uebfaqja e Komisionit të Prokurimit Publik është shoqëruar me një motor të posaçëm kërkimi për personat me aftësi të kufizuar në shikim, verbëri ngjyrash, rezolucion i ulët dhe verbëri e plotë. Ky shërbim është ndër të parët që ofrohet nga një faqe zyrtare e institucioneve publike në Shqipëri.

Gjatë vitit 2022, motori i posaçëm i kërkimit për personat me aftësi të kufizuar është përdorur në 464 raste përkatësisht për modalitetet:

- ☾ Kontrast i lartë → **89**
- ⚙️ Nxirr në pah → **92**
- 🔍 Ndrichim i ulët → **88**
- ⌨ Zmadho shkrimin → **83**
- 🗣️ Zëri → **112**

## Asistenca teknike për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore

Drejtoria e Monitorimit, Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës gjatë vitit 2022, ka ofruar shërbimin e asistencës teknike të autoriteteve kontraktore dhe operatoreve ekonomikë.

## Përdorues të sistemit të ankesave elektronike

Konkretisht janë dërguar **340 e-maile zyrtare** për mënyrën e përdorimit të sistemit të ankesave elektronike dhe njoftimin individual të autoriteteve kontraktore për dorëzimin e ankesave online, **mbi 149 mesazhe** në chatin e dedikuar në kohë reale dhe **mbi 2720 minuta komunikim** përmes linjës telefonike.

# BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL DHE AKTIVITETET

## Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Antikorrupsionit

Në tetor të vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kombëtar i Antikorrupsionit (ANAC) nënshkruan në Romë, Itali, marrëveshjen e bashkëpunimit, për të forcuar marrëdhëniet ndërinstitucionale dhe për të nisur bashkëpunimin dypalësh. Marrëveshja e bashkëpunimit, e cila ka një kohëzgjatje trivjeçare, ka në përbërje të saj shkëmbimin e njohurive, dokumentacionit dhe informacionit nga ana e të dyja institucioneve, duke pasur në fokus përmirësimin e efikasitetit në fushën e prokurimit publik dhe për të forcuar shtetin e të së drejtës. Institucionet do të bashkëpunojnë duke ndarë eksperiencën nga legjislacioni respektiv i antikorrupsionit dhe transparencës. Do të organizohen gjithashtu edhe kurse të formimit profesional, konferenca, udhëtime pune mbi çështje që i përkasin prokurimit publik dhe takime të nivelit të lartë, për të diskutuar strategji dhe fusha bashkëpunimi dypalëshe.

## Krijimi i rrjetit të organeve shqyrtuese të prokurimit publik

Me synim shkëmbimin e eksperiencave dhe mbështetjen reciproke në përbalimin e sfidave për çështje të prokurimit, bashkëpunimit, shkëmbimin e mendimeve dhe njohurive për çështje të veçanta ligjore dhe me rëndësi, Shqipëria, Kosova, Kroacia, Bosnia dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Rumania, Sllovenia, Mali i Zi nënshkruan, në datën 28 Tetor 2022, në Tiranë, Marrëveshjen e Themelimit të Rrjetit të Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Evropës Juglindore, me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit, shkëmbimin e përvojave, të eksperiencave, mendimeve dhe njohurive për çështje të veçanta ligjore dhe me rëndësi në punën dhe zbatimin me cilësi dhe efektivitet të kompetencave statutores.

Në këtë event të organizuar në Tiranë, në Pallatin e Brigadave, nga Komisioni i Prokurimit Publik të Shqipërisë, në cilësinë e iniciatorit për themelimin e këtij rrjeti, morën pjesë krerë të lartë në fushën e prokurimit publik të këtyre shteteve, si edhe përfaqësues të institucioneve Kushtetuese, si dhe të organizmave ndërkombëtarë në Shqipëri.

Krijimi i këtij rrjeti për Shqipërinë, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Bosnjën dhe Hercegovinën, Slloveninë, Rumaninë, Kroacinë dhe Turqinë, të cilët ndajnë jo vetëm marrëdhënie fqinjësie të mirë, shkëmbim të rëndësishëm tregtar, ndërveprim të operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, vlera kulturore dhe historike, ngjashmëri në legjislacion, përben një vlerë të shtuar dhe sfidë në bashkëpunimin reciprok në përgjithësi dhe në veçanti në zbatimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit.

Në kushtet kur të gjitha vendet e këtij rrjeti kanë përafëruar legjislacionin e prokurimit publik me ato të aquie communite, kanë ndryshuar rregullat dhe mënyrat e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, duke i bërë ato më transparente, më gjithëpërfshirëse, duke rritur njëkohësisht aksesin e publikut dhe operatorëve ekonomikë, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave dhe qasjeve ndaj sfidave në këtë fushë do të mundësojë një impakt të rëndësishëm në zinxhirin e prokurimit të vendeve të rrjetit, duke rritur efikasitetin dhe eficientësinë, transparencën, si dhe duke garantuar integritetin dhe besimin e publikut në procedurat e prokurimit.





## Shqipëria, në rrugën e reformës së integrimit në BE



### Z. Hubert Perr, Kreu i Bashkëpunimit të Bashkimit Evropian në Shqipëri

Kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Hubert Perr, shprehu përgëzimet e tij për krijimin e këtij rrjeti të rëndësishëm, si dhe falenderoi Shqipërinë si shtet themelues dhe drejtues të të parit rrjet të organeve shqyruese të prokurimit të Europës Juglindore për organizimin e këtij event.

*"Jam i lumtur dhe e vlerësoj shumë, që përfaqësues të qeverisë ashtu dhe të parlamentit janë këtu midis nesh, pasi bën që të gjithë shtetet të reflektojnë dhe të shohin, se sa i rëndësishëm është bashkëpunimi midis institucioneve që luajnë role të ndryshme, përfshirë këtu dhe prokurimet. Duke u nisur nga eksperiencia ime personale si Kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe nga eksperiencat e mia në shtete dhe ambasada të tjera, ne kemi pasur mjaft procedura prokurimi, ndaj dua të shpreh vlerësimin tim për të gjitha sfidat që ju keni ndërmarrë ndër to dhe digjitalizimi i këtyre procedurave." – u shpreh z. Perr në fjalën e tij.*



### Znj. Ermonela Felaj, Nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Nënkryetaria e Kuvendit, Znj. Ermonela Felaj, e konsideroi themelimin e rrjetit të Organeve Shqyruese të Prokurimit të Europës Juglindore dhe firmosjen e Memorandumeve me institucionet homologe të vendeve të tilla si Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania, Sllovenia, si një ngjarje të rëndësishme në punën e Komisionit të Prokurimit Publik.

Znj. Felaj gjithashtu shprehu vlerësimin e saj në lidhje me reformën e digjitalizimit të ndërmarrë nga Komisioni i Prokurimit Publik, duke theksuar se vënia në funksion e sistemit e-ankesa tashmë ia ka dhënë përmasën e transparencës këtij institucioni.

*"Raport – Progresi i Komisionit Evropian të vitit 2022, i dorëzuar në Parlament përmes ambasadores së Bashkimit Evropian i ka kushtuar një vlerësim të veçantë Komisionit të Prokurimit Publik, pasi Shqipëria gjykohet se është e përgatitur në proceset e prokurimit Publik." – u shpreh znj. Felaj në fjalën e saj.*

## Standardizimi i shërbimeve në OSHP-ve



### Znj. Milva Ekonomi, Ministre e Shtetit për Standardet dhe Shërbimet

Ministrja e Shtetit për Standardet dhe Shërbimet, znj. Milva Ekonomi, fjalën e saj, e nisi fillimisht, duke shprehur gëzimin që kishte përjetuar bashkë me përfaqësuesit e tjerë nga Shqipëria, gjatë takimit të organizuar nga RESPA dhe SIGMA në Maqedoninë e Veriut, në ditën ndërkombëtare të demokracisë, ku u mbajt "Ministeriali i Ballkanit Perëndimor mbi Reformat në Administratën Publike" dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ishte institucioni i vetëm nga Republika e Shqipërisë, që u vlerësua me çmimin

*"Njohje speciale për besimin në administratën publike për sistemin e E-Ankesave".*

*"Kjo tregon, që sistemet që ne po ndërtojmë, vijnë në shërbim të të gjithë individëve të interesuar dhe shpreh mirënjohjen për mbështetjen që Open Contracting Partnership i ka dhënë Komisionit të Prokurimit në krijimin e këtij standardi, por gjithashtu vlerësohen dhe përpjekjet që po bëhen për t'i ndërtuar këto sisteme. Për të arritur këtë çmim është dashur shumë punë nga Komisioni i Prokurimit Publik, pasi jo vetëm është ndërtuar ky sistem, por janë kryer trajnime të ndryshme që subjektet e interesuara të marrin informacionin e duhur mbi mënyrën e funksionimit të tij". – u shpreh znj. Ekonomi.*



### Presidenti i ANAC, z. Giuseppe Busia

Presidenti i ANAC, z. Giuseppe Busia, përgëzoi të gjithë anëtarët e rrjetit për këtë iniciativë që kanë ndërmarrë dhe në cilësinë e presidentit të Agjencisë Kombëtare të Antikorrupsionit në Itali, ofroi mbështetjen e tij në këtë mision, për të qenë së bashku në luftën kundër korrupsionit.

Z. Busia fjalën e tij u shpreh, se Prokurimi Publik përbën një nga fushat më të rrezikuara për sa i përket korrupsionit dhe për të fituar betejën kundrejt korrupsionit duhet të jenë të bashkuar dhe transparentë.

*"Vënia në funksion e sistemit elektronik të shqyrtimit të ankesave, është në interes të të gjitha palëve të interesuara, si operatorëve ekonomikë ashtu dhe autoriteteve kontraktore, por edhe për shoqërinë civile në përgjithësi dhe kam besimin e plotë, se shkëmbimi i eksperiencave dhe informacionit mbi funksionimin e sistemeve të brendshme, identifikimi i sfidave të përbashkëta dhe nevojave gjithashtu, gjetja e zgjidhjeve dhe përmirësimi që do të sjellin të dhënat transparente në qeverisje, janë elemente vendimtare në luftën tonë kundër korrupsionit." – u shpreh z. Busia.*



## Marrëveshje bashkëpunimi KPP-KLGJ

Në datën 06.10.2022, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi midis dy institucioneve respektive. Kjo Marrëveshje, ka si qasje bashkëpunimin në disa drejtime kryesore si: realizimin e uorkshop-eve, konferencave, trajnimeve të përbashkëta; realizimin e analizave dhe studimeve periodike; veprimtari të tjera bashkëpunimi të cilat janë në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve, si dhe adresimin e problematikave.

## Shtesë memorandum bashkëpunimi

Në Memorandumin e Bashkëpunimit, firmosur në 05.10.2020 ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) dhe Open Contracting Partnership (OCP), gjatë vitit 2022, palët kanë dakordësuar që fushat e bashkëpunimit do të përfshijnë organizimin e Konferencës Ndërkombëtare të Prokurimit 2023 në Tiranë, Shqipëri, e cila do të mbledhë liderë rajonalë dhe botërorë në fushën e prokurimeve. Me këtë shtesë marrëveshjeje, Open Contracting Partnership do të jetë në rolin e pjesëmarrësit aktiv në këtë event dhe do të përdorë rrjetin e tij dhe kontaktet për të ngritur, komunikuar dhe mbështetur këtë Konferencë Ndërkombëtare.

## Aktivite

### Shkurt 2022

Komiteti i Stabilizim-Asocimit, Bashkimi Evropian – Shqipëri - Në datë 15 shkurt 2022, është zhvilluar takimi i dymbëdhjetë i Komitetit të Stabilizim-Asocimit, Bashkimi Evropian - Shqipëri.

### Maj 2022

KPP-ja, pjesëmarrje dhe raportim për vitin 2021, si edhe 4 mujorin e parë të vitit 2022 në takimin e 13-të Nënkomitetit të Stabilizim Asocimit, Kapitulli V, "Tregu i brendshëm dhe konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit" BE-Shqipëri në Bruksel." Përfaqësuesit e Komisionit European vlerësuan rezultatet e arrira nga Komisioni i Prokurimit Publik, si dhe punën e bërë në lidhje me procesin e digjitalizimit të shërbimeve E-Ankesa, faqen e re të uebit, si dhe standardet e arrira lidhur me transparencën në veprimtarinë e Komisionit sipas parimeve open data.

### Maj 2022

KPP-ja e ftuar në debatin publik për ndryshimin e ligjit të prokurimit në Republikën e Malit të Zi. Me ftesë të Komisionit Shtetëror për Mbrojtjen e të Drejtave në Procedurat e Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Malit të Zi, datë 17 maj 2022, Komisioni i Prokurimit Publik mori pjesë në debatin publik mbi propozimet për ndryshimin e ligjit të Prokurimit Publik në Malin e Zi.

### Maj 2022

Fushat e transparencës, teknologjisë dhe inovacionit në fushën e prokurimit publik - Konferencë në Amsterdam organizuar nga Open Contracting Partnership në bashkëpunim me Qeverinë Holandeze dhe Open State Foundation. Në Amsterdam, është mbajtur një ndër konferencat më të rëndësishme, për sa i përket fushës së Prokurimeve Publike, si një mjet i fuqishëm për të arritur ndikimin social dhe tranzicionin mjedisor. Ky eveniment i rëndësishëm, u organizua nga Open Contracting Partnership në bashkëpunim me Qeverinë Holandeze dhe Open State Foundation. Përfaqësues të Komisionit të Prokurimit Publik morën pjesë në këtë aktivitet, si edhe ndanë me pjesëmarrësit rezultatet e reformës së digjitalizimit.

### Qershor 2022

Takimi i Komitetit Drejtues të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik. Në këtë takim, u prezantuan:

- Aktivitetet e parashikuara të SKPP 2020-2023;
- Raporti i Monitorimit për vitin 2021;
- Shtesat dhe ndryshimet në Rregulloren "Për Komitetin Drejtues të Strategjisë Kombëtare Për Prokurimin Publik 2020 – 2023";

Pas diskutimeve të zhvilluara, Komiteti Drejtues vendosi: Miratimin e "Raportit të Monitorimit 2021" dhe miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren "Për Komitetin Drejtues të Strategjisë Kombëtare Për Prokurimin Publik 2020 – 2023"

## Qershor 2022

Në konferencën e parë Kombëtare të Antikorrupsionit të organizuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në datën 14 qershor 2022, mori pjesë edhe Komisioni i Prokurimit Publik. Një prezantim i posaçëm iu dedikua edhe impaktit të Sistemit të Ankesave Elektronike, digjitalizimit të shërbimeve si mjet i luftës kundër korrupsionit.

## Qershor 2022

Menaxhimi Mjedisor në Prokurimet Publike - Milieukontakt Shqipëri - Agjencia Sllovaqe e Mjedisit. Në datë 23 qershor 2022, Komisioni i Prokurimit Publik, në mjediset e hotel "Tirana Internacional", ishte pjesë e takimit të organizuar nga Milieukontakt Shqipëri, në bashkëpunim me partnerin e saj Agjencinë Sllovaqe të Mjedisit me temë "Përfshirja e kriterëve të menaxhimit mjedisor në Prokurimet Publike".

## Shtator 2022

Kapitullin 5 - Prokurimi Publik – Bruksel, përfaqësues të Komisionit të Prokurimit Publik morën pjesë në seancën shpjeguese për Kapitullin 5 - Prokurimi Publik, zhvilluar në Bruksel, në të cilin ishin të pranishëm ekspertë të Bashkimit Europian, përfaqësues nga shteti shqiptar dhe shteti i Maqedonisë së Veriut.

## Shtator 2022

Forumi i 16-të i Prokurimit, Integritetit, Menaxhimit dhe Hapjes (PRIMO). Komisioni i Prokurimit Publik mori pjesë në konferencën e PRIMO mikpritur nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe organizuar nga Banka Botërore dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë. KPP-ja në ditën e dytë të forumit u përfaqësua në panelin "Shembuj unikë të mbështetjes së rimëkëmbjes elastike përmes aspektit të sjelljes përfshirë ankesat".

Gjatë zhvillimit të kësaj konference, kanë marrë pjesë përfaqësues të rreth 19-të shteteve dhe bashkëpunëtorë të huaj, duke trajtuar tema të rëndësishme të prokurimit publik, të organizuara në disa panele, duke ndarë shembuj dhe eksperiencë unike.

## Tetor 2022

Uorkshop "Inovacioni në Administratën Publike", datë 28 tetor, në Ditën e Veprimit të Inovacionit, 17-të fituesit dhe përfaqësuesit e njohjeve speciale të RESPA-s, u mbledhën në Barcelonë në uorkshopin "Inovacioni në Administratën Publike". Gjatë uorkshopit pjesëmarrësit kanë punuar në grupe dhe praktikuan se si të përcaktojnë dhe ndërtojnë një plan veprimi të inovacionit për sektorin publik, duke u përqendruar në designthinking, njohuri dhe zgjidhje, prototipe dhe zgjidhje.

**Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), është institucioni i vetëm nga Republika e Shqipërisë, që u vlerësua me çmimin "Njohje speciale për besimin në administratën publike për sistemin e E-Ankesave".**

## Nëntor 2022

"Risqet e Integritetit në Prokurimet Publike" – uorkshop Datë 16 nëntor 2022 në Hotel Rogner u organizua uorkshopi me temë: "Risqet e Integritetit në Prokurimet Publike".

Qëllimi i këtij uorkshopi ishte të ndihmojë në formimin e një kuptimi të përbashkët të rreziqeve problematike të procedurave të prokurimit publik, me mundësinë për të shkëmbyer pikëpamjet midis pjesëmarrësve dhe folësve të ftuar. Pjesëmarrës në të ishin përfaqësues nga Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar, Këshilltarë Ligjor të Atashuar në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, Ndihmës ligjor Gjykata Administrative e Apelit, Pjesëmarrës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Gjykata e Lartë, Byroja Kombëtare e Hetimit, Komisioni i Prokurimit Publik.

## Nëntor 2022

"Takimi dypalësh i shqyrtimit për Kapitullin 5 "Prokurimi Publik" në Bruksel - KPP-ja paraqiti në Komisionin Evropian në vijim të takimit dypalësh për Kapitullin 5 "Prokurimet Publike", një pasqyrë shumë të detajuar të institucionit. KPP-ja bëri një paraqitje të plotë të mënyrës së funksionimit të KPP-së, shpjegoi qartësisht mënyrën se si procedohet për paraqitjen e ankesës, parashikimet ligjore dhe se si janë implementuar/përthithur/aplikuar direktivat evropiane për secilin rast.



## Dhjetor 2022

“Takimi për miratimin e raportit të gjashtëmujorit të parë për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023 për vitin 2022”. Në dhjetor u zhvillua takimi online me Komitetin Drejtues të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik.

## Dhjetor 2022

KPP-ja mori pjesë në Tryezën e Rrumbullakët me Biznesin organizuar nga Autoriteti i Konkurrencës, me temë “Korniza legjislative për një rol më aktiv të Autoritetit të Konkurrencës në procedurat e prokurimit publik”

**27 Maj 2022 – organizuar dhe zhvilluar nga Komisioni i Prokurimit Publik, konferenca e dytë me temë “Sfidat e Sistemit të Prokurimit Publik në Republikën e Shqipërisë”, konferencë e cila për vitin 2022, u organizua në bashkëpunim me SIGMA - OECD.**

Institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, më datë 27 Maj 2022, organizoi konferencën e dytë, me temë “Sfidat e Sistemit të Prokurimit Publik në Republikën e Shqipërisë”, konferencë e cila këtë vit u mbështet dhe u organizua në bashkëpunim me SIGMA-OECD.

Në këtë konferencë u ngritën problematika të ndryshme në lidhje me procedurat e prokurimit publik, të konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik gjatë vitit 2021. Në konferencë morën pjesë fizikisht dhe online rreth 300 operatorë ekonomikë dhe autoritete kontraktore.

Znj. Ekonomi, Ministria e Shtetit për Standardet e Shërbimeve, në fjalën e saj, e cilësoi konferencën si plotësimin e një dimensionit tjetër në standardet e shërbimeve publike. **“Dimensioni i analizave të riskut, është një hap i cili duhet ndërmarrë në epokën digjitale veç sfidës së burimeve njerëzore”** - theksoi ministria.

Znj. Ekonomi fjalën e saj e mbylli duke thënë, se sfidat e të së ardhmes duhen vendosur në sfondin digjital i cili po ndryshon në çdo moment.

Z. Perr, përfaqësues nga Delegacioni i BE në Shqipëri, theksoi rëndësinë e sektorit privat në fushën e prokurimeve dhe rëndësinë që ka kuptimi i të gjitha rregullave të fushës, në mënyrë që të bëhet efektive procedura e prokurimeve.

Z. Perr vlerësoi implementimin e direktivave të BE-së në ligjin e ri të prokurimeve, fakt që tregon, se Shqipëria e ka marrë seriozisht dhe e ka çuar në tjetër nivel fushën e prokurimeve.

Konferenca vazhdoi me fjalën e z. Karolis Granickas, i cili tregoi, se kur Open Contracting filloi bashkëpunimin me KPP-në, zbërthyen procesin e aktivitetit të institucionit, duke kuptuar se të dhënat apo teknologjia mund të ndihmojnë në drejtimin e Komisionit, në një mënyrë më efektive dhe të qetë. Ky proces tregon, se nuk fillon me teknologjinë apo të dhënat, por me ndryshimin që ne duam të shohim.

Momentalisht Open Contracting Partnership asiston Komisionin e Prokurimit Publik dhe ajo që pritet dhe që vihet re edhe tani është:

- më shumë efikasitet institucional,
- më shumë kënaqësi nga bizneset,
- më pak korrupsion,
- feedback dhe ankesa të suksesshme,
- më shumë konkurrencë dhe diversifikim i furnitorëve,
- më shumë efektivitet dhe efikasitet në rezultate,
- më shumë besim.

Në konferencë morën pjesë, përfaqësues të autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, komunitetit akademik, mediave, si me prezencë në sallë, ashtu edhe online nëpërmjet platformës zoom.





## Rezultatet e konferencës

Nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, u veçuan tri çështje me rëndësi për prokurimin publik si më poshtë:

### 1. E para, lidhet me ngritjen e një trupe zyrtarësh të prokurimit publik të certifikuar

- Sfida e sistemit të prokurimit publik në tërësi, gjithashtu edhe e Komisionit të Prokurimit Publik, është ajo e forcimit të kapaciteteve dhe elementeve njerëzore, të zyrtarëve të prokurimit.
- Një trupë zyrtarësh prokurimi të certifikuar pranë autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, organeve të shqyrtimit të prokurimit, do të sillte një impakt të rëndësishëm në sistemin e prokurimit në Shqipëri.
- Hartimi i një kurrikule të posaçme trajnimi dhe një niveli certifikimi specifik për zyrtarët e prokurimit do të sillte një impakt të rëndësishëm në sistemin e prokurimit.
- Profesioni i zyrtarit të prokurimit të rregullohet edhe me ligj.

### 2. Së dyti, krijimi dhe konsolidimi i standardeve kombëtare në prokurimin publik

- Duke qenë se në vitin 2021 janë konstatuar një numër i lartë i ankesave në lidhje me dokumentet e procedurës së prokurimit, të cilat lidhen me mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike për procedura specifike, propozojmë nxitjen e hartimit të Standardeve Kombëtare (SSH) për grup mallrash me përdorim të përgjithshëm, të cilat do të ndikonin në mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike nga ana e autoriteteve kontraktore.

### 3. Së treti, me rëndësi shfaqet edhe forcimi i bashkëpunimit mes institucioneve të përfshira në procedurat e prokurimit publik dhe Autoritetit të Konkurrencës

- Nxitja e konkurrencës në procedurat e prokurimit, është më shumë se një parashikim ligjor, është qëllimi dhe fryma që duhet të shoqërojë një procedurë prokurimi, ndaj u propozuan më shumë sesione trajnimi për të gjitha subjektet nga Autoriteti i Konkurrencës, si dhe hartimi i një manuali të ri të sinjaleve të marrëveshjeve të ndaluara në prokurimet publike.

Nga ana e përfaqësuesve të operatorëve ekonomikë u parashtrua nevoja e krijimit të standardeve të unifikuara në procedurat e prokurimit publik, si edhe për trajnime të vazhdueshme të operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore.

**Më datë 16 nëntor 2022, u organizua Uorkshopi me temë: “Risqet e Integritetit në Prokurimet Publike”.** Pjesëmarrës ishin gjyqtarë nga Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pjesëmarrës nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Byroja Kombëtare e Hetimit, SIGMA – OECD, si dhe Komisioni i Prokurimit Publik. Qëllimi i këtij uorkshopi ishte të ndihmojë në formimin e një kuptimi të përbashkët të rreziqeve problematike të procedurave të prokurimit publik, me mundësinë për të shkëmbyer pikëpamjet midis pjesëmarrësve dhe folësve të ftuar, ku u diskutua për korrupsionin në prokurimin publik në Shqipëri dhe si mund ta parandalojmë atë.

Nga ana e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u sqaruan kompetenca e gjykatave të posaçme për gjykimin e veprës penale “shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, e parashikuar nga neni 258 i kodit penal.



## Urat e komunikimit me grupet e interesit

### Raportimi në kuvend

Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë, Seancë Plenare dhe Komisionin e Ligjeve, si përmbushje e detyrimit ligjor për raportim edhe njëkohësisht urë komunikimi me këtë institucion kushtetues, ku parashtrihen problematikat dhe kërkesat për mbështetje dhe suport për adresimin e problematikave dhe nevojave institucionale të organit shqyrtues të ankesave lidhur me procedurat e prokurimit publik.

### Konferenca vjetore me autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë

Gjatë vitit 2022, KPP-ja organizoi në bashkëpunim me SIGMA-OECD, konferencën vjetore të prokurimit me autoritetet kontraktore me pjesëmarrje fizike dhe online. Në konferencë u evidentuan problematikat e palëve të përfshira në procesin e shqyrtimit të ankesës, qasjet opsionale për adresimin e problematikave, gjetjet dhe rekomandimet për zgjidhje ligjore dhe reforma të nevojshme në lidhje me sfidat e prokurimit publik.

### Buletine mujore dhe vendime interpretuese

Edhe gjatë vitit 2022 KPP-ja publikoi raporte mujore mbi veprimtarinë e saj. Raporti u është dërguar në rrugë elektronike të gjithë autoriteteve/ enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë. Raporti përmban informacion mbi veprimtarinë mujore të Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me ankesat, shpërndarjen e tyre sipas qarqeve, procesin vendimmarrës, vendime interpretative dhe informacione mbi aktivitetet institucionale.

### Uorkshop me sistemin gjyqësor

Gjatë vitit 2022, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur me Këshillin e Lartë Gjyqësor, KPP-ja organizoi një uorkshop në bashkëpunim me SIGMA-OECD. Në këtë uorkshop morën pjesë përfaqësues të sistemit gjyqësor, nga gjykata administrative e shkallës së parë, apelit Gjykata e Lartë, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Lartë dhe përfaqësues të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

### Fushata sensibilizuese për promovimin e sistemit e-ankesa

Si mjet për promovim, informim dhe sensibilizim mbi përdorimin nga Operatorët ekonomikë të E-Ankesa, Sistemit Digjital të Dorëzimit dhe Shqyrtimit të Ankesës, sistem që mundëson shpejtësi në procesin e depozitimit, transparencë mbi procesin vendimmarrës, ulje të kostove, realizuar nëpërmjet një fushate publikimi në tri media kombëtare digjitale për një periudhë 1 muaj, tetor - nëntor 2022 në harkun 24 orë.

### Web, linkedin dhe twitter

Operatorët ekonomikë, autoritetet/entet kontraktore dhe grupet e interesit janë njohur për veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik edhe përmes publikimit të informacionit në faqen zyrtare të uebit si edhe në rrjetet sociale. Të gjitha aktivitetet janë shfaqur në live stream në llogarinë zyrtare të youtube të Komisionit të Prokurimit Publik si edhe në faqen zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik.



## MBI ZBATIMIN E REZOLUTES SË KUVENDIT

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2021”, pjesë e së cilës janë disa rekomandime për t’u përmbushur nga Komisioni i Prokurimit Publik për vitin 2022. Lidhur me përmbushjen e rekomandimeve të parashtruara në këtë rezolutë, Komisioni i Prokurimit Publik i ka raportuar Kuvendit të Shqipërisë me shkresat me nr.prot.2902, datë 30.12.2022. Në vijim gjeni një raportim të plotë mbi zbatimin e rekomandimeve të kësaj rezolute.

Lidhur me rekomandimin:

“Të investohet me kapacitet të plotë për uljen e numrit të ankesave të shqyrtuara jashtë afateve ligjore, duke ndjekur trendin përmirësues të vitit 2021”, pavarësisht rritjes së numrit të ankesave krahasuar me vitin 2021 dhe situatës së paprecedentë të shkaktuar nga sulmi kibernetik me të cilën u përball Komisioni i Prokurimit Publik, numri i ankesave të trajtuara jashtë afatit është ulur në 10.1 % (sipas të dhënave të përditësuara deri në datën 30.12.2022), duke vijuar trendin rënës të arritur gjatë vitit 2021.

**Ky rekomandim është përmbushur plotësisht**

dhe vijon të punohet për të reduktuar me tej numrin e ankesave të trajtuara jashtë afatit.

Lidhur me rekomandimin:

“Të punojë për plotësimin e vendeve vakante duke rekrutuar profesionistë të kualifikuar të fushës si një faktor i cili ndikon drejtëpërdrejtë në rritjen e efikasitetit dhe cilësinë e vendimmarrjes së KPP-së dhe në të njëjtën kohë të vijojë punën për trajnimin e punonjësve me qëllim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në vazhdimësi”, Komisioni i Prokurimit Publik ka ndjekur procedurat e rekrutimit për plotësimin e vendeve vakante duke rekrutuar 4 (katër) nëpunës civilë 3 (tre) inspektorë të profilit jurist dhe 1 (një) specialist finance. Sa i përket trajnimeve dhe aktiviteteve në funksion të rritjes së kapaciteteve, Komisioni krahas nxitjes së nëpunësve dhe krijimit të mundësisë për pjesëmarrje në trajnime individuale, zhvillimit të konferencave dhe uorkshopeve mbi çështje të prokurimit publik edhe për vitin 2022 në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës mundësoi trajnimin dy-javor me temë “Mbi çështje/kazuse të prokurimit të trajtuara nga Gjykata Europiane e Drejtësisë”.

**Ky rekomandim është përmbushur plotësisht**

sa i përket trajnimit dhe rritjes së kapaciteteve, sa i përket rekrutimeve, krahas rekrutimeve të kryera vijon procesi për rekrutime për disa vende të mbetura vakante.

Lidhur me rekomandimin:

“Të angazhohet në vazhdimësi për informimin e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktorë përmes organizimit të tryezave/fusha ave informuese, si dhe të hartojë kurikulat e trajnimit për zyrtarët e prokurimit, me qëllim uljen e numrit të ankesave të mospranuara për shkaqe të mosplotësimin të kriterëve formale, si dhe të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së punës nga ana e autoriteteve kontraktore”, informojmë se: me synim trajtimin dhe adresimin e problematikave në fushën e prokurimit publik, Komisioni ka kthyer, tashme në traditë organizimin e konferencës vjetore “Mbi sfidat e prokurimit publik”, duke zhvilluar në datën 27 Maj 2022 konferencën e dytë me temë “Sfidat e Sistemit të Prokurimit Publik në Republikën e Shqipërisë”, ku morën pjesë përfaqësues të një numri të konsiderueshëm të autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, si dhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare. Gjithashtu, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës (sipas marrëveshjes me nr.prot 3138/4 datë 12.12.2022 dhe me nr.prot.2429/2 datë 12.12.2022 Komisioni ka hartuar një manual për procesin e trajtimit të ankesave, i cili do t’u shërbejë dhe do tu vijë në ndihmë zyrtarëve të prokurimit, si dhe ka nxjerrë në mbështetje të nenit 24, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të zbatueshme për sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme.

**Ky rekomandim është përmbushur plotësisht**

Lidhur me rekomandimin:

“Të risë përpjekjet për ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë për përdorimin e sistemit të ri të dorëzimit të ankesave online nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania si dhe të miratojë manualin e përdorimit të sistemit të ankesave elektronike”. Në lidhje me këtë rekomandim janë ndërmarrë disa veprime si: asistencë e vazhdueshme ndaj operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ankesave online nga stafi i Komisionit; fushatë publicitare në media disajvare në muajt tetor, nëntor 2022, me qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve për paraqitjen online të ankesave si dhe me vendimin nr.328, datë 06.04.2022 “Për miratimin e manualit të operatorëve ekonomikë për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe dorëzimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike”, Komisioni i Prokurimit Publik ka miratuar manualin për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe dorëzimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike. Ky manual u vjen në ndihmë operatorëve për procesin e aplikimit për ankesë dhe argument.

**Ky rekomandim është përmbushur plotësisht**



Lidhur me rekomandimin:

*“Të bashkëpunojë ngushtë me Agjencinë e Prokurimit Publik për të bërë të mundur krijimin e standardeve të njëjta në trajtimin e çështjeve të ngjashme dhe njëkohësisht marrjen në konsideratë nga APP të problematikave të ankesave duke krijuar një model pune.”* Komisioni në mënyrë të vazhdueshme dërgon çështje për hetim të mëtejshëm administrativ në Agjencinë e Prokurimit Publik me qëllim krijimin e standardeve të njëjta në çështje të ngjashme. Komisioni ka dërguar përgjatë vitit 2022, 10 (dhjetë) çështje për hetim administrativ.

**Ky rekomandim është përmbushur plotësisht** ◀

Sa i përket rekomandimit:

*“Kpp-ja në vijim të procesit të digjitalizimit të punojë për implementimin e fazës së dytë për integrimin e proceseve të brendshme administrative në sistemin e dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesave”* ju informojmë, se në lidhje me këtë rekomandim me shkresën nr.prot.270, datë 14.02.2022, i është deleguar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si institucioni kompetent në fushën e teknologjisë, të hartojë termat e referencës dhe të zhvillojë procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e operatorit të specializuar lidhur me projektin “Fazë plotësuese, për integrimin e proceseve të brendshme administrative me sistemin e dorëzimit dhe shqyrtimin e ankesave (ERP system), ku në vijim të procedurës është lidhur kontrata me datë 01.09.2022, e cila është përmbyllur plotësisht.

**Ky rekomandim është përmbushur plotësisht** ◀

Lidhur me rekomandimin:

*“Të vijojë monitorimi i zbatimit të vendimeve të Komisionit të prokurimit publik me qëllim rritjen e ndërgjegjësimin të institucioneve të administratës shtetërore në lidhje me detyrimin për të zbatuar vendimet e KPP-së, si një detyrim që lidhet me një proces të rregullt ligjor për palët në proces dhe që mbron interesin publik”*, informojmë, se procesi i monitorimit ndiqet me rigorozitet dhe ka dhënë rezultat, pasi krahasuar me vitin 2021, ku janë dërguar **60 (gjashtëdhjetë) kërkesa** pas tejkallimit të afatit ligjor të përcaktuar, për zbatimin e vendimeve drejtuar autoriteteve kontraktore, në vitin 2022 janë dërguar **43 (dyzet e tre) kërkesa** për zbatim vendimi. Duket se procesi i monitorimit ka ndikuar te autoritetet kontraktore, duke zbatuar menjëherë vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik.

**Ky rekomandim është përmbushur plotësisht** ◀

Lidhur me rekomandimin:

*“Komisioni të rrisë bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës për krijimin e kurrikulave të përbashkëta të trajnimit, magjistratë dhe zyrtarë prokurimi”*, ju informojmë se nga Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të këtij rekomandimi është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr.prot.2183, datë 06.10.2022 dhe nr.prot.5230, datë 06.10.2022, marrëveshje e cila ka si objekt bashkëpunimin në kuadër të rritjes së kapaciteteve. Në vijim të kësaj marrëveshjeje Komisioni organizoi më datë 16 nëntor 2022, Uorkshopin me temë: “Risqet e Integritetit në Prokurimet Publike”, ku morën pjesë përfaqësues të Këshillit të Lartë Gjyqësor, BKH, gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Administrativ si dhe zyrtarë dhe nëpunës të Komisionit të Prokurimit Publik.

**Ky rekomandim është në proces** ◀

## X AKTE RREGULLATORE

Gjatë vitit 2022, institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim mbështetjen e proceseve administrative të punës me akte - rregullatore, ka punuar për hartimin dhe miratimin e disa akteve administrative. Gjata vitit 2022, janë hartuar dhe miratuar aktet si vijon:

- ▶ Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, miratuar me urdhrin e Kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 03, datë 11.01.2022, "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik";  
Kjo rregullore përcakton rregullat normuese të organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik lidhur me strukturën organizative, kompetencat dhe përgjegjësitë e funksionarëve dhe nëpunësve të Komisionit Prokurimit Publik, marrëdhëniet ndërmjet strukturave, administrimin e dokumentacionit, pajisjeve, orarit zyrtar, rregullave të etikës, administrimit të dokumenteve, administrimit të dosjeve të personelit;
- ▶ Manuali "Për përdorimin e sistemit të ankesave elektronike dhe shqyrtimit të ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike", për autoritetet kontraktore, miratuar me vendimin nr. 329, datë 06.04.2022, të Komisionit të Prokurimit Publik;
- ▶ Manuali "Për përdorimin dhe dorëzimin e ankesave nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike (SAE), për operatorët ekonomikë", miratuar me vendimin nr. 328, datë 06.04.2022";
- ▶ Akti normues për vijueshmërinë e shërbimit për situatën e shkaktuar nga sulmi kibernetik - Urdhri nr. 338, datë 18.07.2022 "Për marrjen e masave për njoftimin e autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë dhe subjekteve të interesuara lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të situatës së krijuar si rezultat i sulmit kibernetik ndaj shërbimeve publike online dhe faqeve të tjera qeveritare";
- ▶ Rregullorja për funksionimin e bibliotekës së Komisionit të Prokurimit Publik miratuar me urdhrin nr. 531, datë 03.11.2022, "Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe Funksionimit të Bibliotekës së Komisionit të Prokurimit Publik.

## BIBLIOTEKA E PARË ME LITERATURË TË HUAJ DEDIKUAR PROKURIMIT PUBLIK

Komisioni i Prokurimit Publik me urdhrin nr. 531, datë 03.11.2022, "Për miratimin e Rregullores së organizimit dhe Funksionimit të Bibliotekës së Komisionit të Prokurimit Publik, në muajin nëntor të vitit 2022, miratoi rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Bibliotekës së institucionit, një risi në fushën e prokurimeve në Republikën e Shqipërisë.

Kjo bibliotekë u ngrit në kuadër të rritjes së kapaciteteve të të gjitha subjekteve të interesuara, si një element shumë i rëndësishëm në mirëfunksionimin e zinxhirit të prokurimeve, falë mbështetjes së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe i dedikohet autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë, studentëve e pedagogëve, për qëllime kërkimore, studimore dhe shkencore, si edhe të gjithë atyre që duan të thellojnë njohuritë e tyre në fushën e prokurimit publik me literaturë të huaj.


Të gjithë operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore, iu bë me dije vënia në funksion e kësaj biblioteke, nëpërmjet një njoftimi të publikuar pranë ambienteve të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe në faqen zyrtare të institucionit.

Gjithashtu, u njoftuan nëpërmjet email-it 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) operatorë ekonomikë dhe në rrugë shkresore rreth 1010 (një mijë e dhjetë) autoritete kontraktore.

Në seksionin Biblioteka, në faqen zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik, çdo person i interesuar ka mundësinë të kryejë rezervimin e librave që dëshiron të lexojë online apo pranë ambienteve të institucionit, si dhe të njihet me rregulloren mbi përdorimin e bibliotekës.


Rezervimi i parë për disa nga titujt e librave që janë pjesë e listës aktuale si më poshtë vijon, e cila do të vazhdojë të pasurohet kohë pas kohe me tituj të rinj, u bë më datë 14 nëntor 2022.





**Essentials of Negotiation**

Roy J Lewicki




**Emotional Intelligence**  
Why It Can Matter More than IQ

Daniel Goleman



**The Procurement Value Proposition**  
The Rise of Supply Management

Gerard Chick & Robert Handfield



**The Procurement and Supply Manager's Desk Reference**  
2nd Edition

Fred Sollisht & John Semanik




**Transatlantic Defence Procurement**

Luke R. A. Butler




**Sustainable Public Procurement under EU Law**

Beate Sjøfjell & Anja Wiesbrock



**The WTO Regime on Government Procurement, Challenge and Reform**

Sue Arrowsmith & Steen Treumer




**Food Grain Procurement and Consumption in China**

Jenneth R. Walker




**The Tech Contracts Handbook**

David W. Tollen



**102 Models of Procurement and Supply Chain Management**

Paul Jackson & Barry Crocker



**Excellence in Public Sector Procurement**

Stuart Emmett & Paul Wright



**Competitive Dialogue in EU Procurement**

Sue Arrowsmith & Steen Treumer




**Procurement by International Organizations**

Elisabetta Morlino



**Social and Environmental Policies in EC Procurement Law**

Sue Arrowsmith & Peter Kunzlik



**The Law of Collaborative Defence Procurement in the EU**

Baudouin Heuinckx



**The Law and Economics of Framework Agreements**

Gian Luigi Albano & Caroline Nicholas




**Damages in EU Public Procurement Law: 6**

Hanna Schebesta




**Handbook of Procurement**

Nicola Dimitri



**Government Cloud Procurement, Contracts, Data Protection, and the Quest for Compliance**

Kevin McGillivray



**Indigenous Peoples and International Trade**

John Borrows & Risa Schwartz



**The Law and Practice of the Ireland**

Christopher McCrudden



**The Comprehensive and Progressive Trans-Pacific Partnership**


Baudouin Heuinckx



**Supply Chain Management**


Bowon Kim






**WTO Analytical Index**

Word Trade Organization  
(Vol 1)



**Grid-Connected Photovoltaic Power Generation**

Peter Gevorkian




**A History of Law and Lawyers in the GATT/WTO**

Gabrielle Marceau



**Health Systems Governance in Europe**

Elias Mossialos,  
Govin Permanand,  
Rita Baeten &  
Tamara K. Hervey



**Corruption and Government**

Susan  
Rose-Ackerman  
& Bonnie J. Palifka



**Public Procurement Regulation in Africa**

Quniot and Sue  
Arrowsmith



**WTO Analytical Index 2**

Gabrielle Marceau


# SFIDA DHE ARRITJET

## Sulmi kibernetik dhe sfida institucionale për vijueshmërinë e shërbimit

Viti 2022, ishte një vit sfidues për ofrimin e shërbime digjitale për Shqipërinë, por edhe për Komisionin e Prokurimit Publik.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ditën e diel, datë 17.07.2022, përmes një njoftimi publik, bëri me dije për sulmin e paparashikuar dhe të paprecedentë kibernetik që goditi Shqipërinë, për shkak të të cilit u detyrua që të mbyllë në mënyrë të menjëhershme dhe përkohësisht aksesin e shërbimeve publike online, faqeve të tjera qeveritare, sistemeve dhe platformave online.

Kjo ngjarje e paprecedentë, e vuri Komisionin e Prokurimit Publik përballë një sfide jashtëzakonisht të vështirë, atë të sigurimit të vijueshmërinë së shërbimit të shqyrtimit të ankesave.



Komisioni i Prokurimit Publik, në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik"; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, date 13.10.2021, "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik",

**me urdhrin nr. 338, datë 18.07.2022, "Për marrjen e masave për njoftimin e autoriteteve kontraktore, operatorëve ekonomikë dhe subjekteve të interesuara lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të situatës së krijuar si rezultat i sulmit kibernetik ndaj shërbimeve publike online dhe faqeve të tjera qeveritare",**

në këtë situatë emergjente dhe të paprecedentë të krijuar si rezultat i mosaksesimit përkohësisht në shërbimet publike online, si edhe në uebsite dhe sistemin elektronik të menaxhimit të ankesave të KPP-së përmes portalit qeveritar E-Albania, siguroi në kohë reale marrjen e masave të menjëhershme

**për garantimin e vijimit të qëndrueshëm të punës, ofrimit të shërbimit publik ndaj operatorëve ekonomikë, autoriteteve kontraktore dhe subjekteve të interesuara, të veprimtarisë normale të Komisionit të Prokurimit Publik, sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe njoftimit të OE-ve, AK-ve dhe çdo subjekti të interesuar.**

Për këtë arsye, në zbatim të urdhrin nr. 338, datë 18.07.2022, prej ditës së hënë, datë 18.07.2022, dhe deri në përfundim të situatës, duke marrë në konsideratë pamundësinë për njoftimin përmes faqes zyrtare të internetit "kpp.al" apo faqeve të tjera zyrtare që Komisioni i Prokurimit Publik menaxhon në rrjetet e tjera online si: linkedin, you tube etj, KPP-ja mundësoi **publikimin e njoftimit mbi mënyrën e procedimit të menaxhimit të ankesave online dhe të veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, deri në rikthimin e shërbimeve publike online**, në disa prej gazetave më të ndjekura, më të aksesueshme nga publiku i gjerë dhe me tirazhin më të madh kombëtar, në mediat elektronike dhe në këndin e Njoftimeve Publike, të vendosur pranë ambienteve të institucionit, si dhe në google drive publik për publikimin e ankesave, të krijuar në adresën e e-mailit kpp.info@gmail.com.

Përgjatë kësaj periudhe, vijoi në mënyrë të qëndrueshme puna e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të plotë të përcaktimeve të ligjit "Për prokurimin publik", u përmbushën detyrimet për publikimet e formularëve të ankesave, njoftimeve në funksion të ankesës, si dhe regjistrin të ankesave. Për ditët që shërbimi i dorëzimit të ankesave në rrugë elektronike u ndërpre dhe gjithashtu faqja zyrtare e institucionit ishte e paaksesueshme, u regjistruan 77 ankesa dhe u morën 89 vendime.

## Vlerësimet ndërkombëtare

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik u vlerësua nga disa organizma ndërkombëtare, për sa i përket veprimtarisë së tij. Konkretisht:

### **Komisioni European në Raportin për Shqipërinë, datë 12.10.2022, për Komisionin e Prokurimit Publik ka cituar:**

**"** Rregullat e BE-së sigurojnë që prokurimi publik i mallrave, shërbimeve dhe punëve në çdo shtet anëtar është transparent dhe i hapur për të gjitha kompanitë e BE-së, mbi bazën e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë. **"**

### **Sistemi efikas i rishikimit**

Kushtetuta dhe Ligji për prokurimin publik përmbajnë dispozita në lidhje me mjetet e rishikimit juridik që janë kryesisht në përputhje me Direktivën. Sistemi i mjeteve juridike është lehtësisht i aksesueshëm për operatorët ekonomikë, pa diskriminim, megjithëse i nënshtrohet një tarife të përcaktuar.

KPP-ja është një organ i pavarur shqyrtues me 36 poste, gjashtë prej të cilave janë vakante, dhe merret me ankesat lidhur me procedurat e prokurimit publik. Vendimet e tij mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit. Procedimi i ankesave brenda afatit ligjor u përmirësua më tej në vitin 2021 në 89.2% (krahasuar me 78% në 2020) me një numër të ngjashëm ankesash të pranuar (768, krahasuar me 741 në 2020).

Në tetor 2021, KPP-ja lançoi një sistem të ri të menaxhimit të ankesave elektronike, E-Ankesa, për paraqitjen dhe menaxhimin elektronik të çështjeve, si dhe nënshkrimin elektronik të dokumenteve dhe akteve. Sistemi i ri ofron statistika në kohë reale, buletine mujore dhe informacion për të gjitha palët e interesuara, duke përfshirë personat me dëmtime në shikim, përmes një motori të veçantë aksesi.

Kapaciteti i KPP-së dhe Gjykatës Administrative për t'u marrë me një numër të madh ankesash duhet të përmirësohet më tej. Si rezultat i një marrëveshjeje bashkëpunimi të lidhur mes KPP-së dhe Universitetit të Tiranës për zhvillimin e kurseve të specializuara në trajnimin për prokurimin publik, stafi i KPP-së përfundoi një kurs trajnimi të certifikuar 13-javor (me tema të ndryshme) nga muaji shtator, deri në muajin dhjetor të vitit 2021.



## Në datë 15.09.2022 Komisioni i Prokurimit Publik fiton çmimin ndërkombëtar: "Besueshmëria në administratën publike"

Në datën 15.09.2022, në ditën ndërkombëtare të demokracisë, në Maqedoninë e Veriut, u mbajt "Ministeriali i Ballkanit Perëndimor mbi Reformat në Administratën Publike".

Në këtë takim u ndanë edhe disa çmime për performancën e institucioneve publike për disa nga vendet e rajonit, përfshirë dhe Shqipërinë. Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) ishte institucioni i vetëm nga Republika e Shqipërisë, që u vlerësua me çmimin

### "Njohje speciale për besimin në administratën publike për sistemin E-Ankesa"



Komisioni i Prokurimit Publik në muajin tetor të vitit 2021, ka prezantuar sistemin e parë elektronik të ankesave në Shqipëri, i cili ka bërë të mundur, që të gjitha ankesat për procedurat e Prokurimit Publik, Prokurimit Publik për Rindërtim, Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat, Ankandeve Publike dhe Garave Konkurruese për Leje Minerare, të dorëzohen në formë elektronike përmes platformës unike qeveritare E-Albania.

Përmes këtij sistemi, në datën 26 nëntor 2021, u krye edhe aplikimi i ankesës së parë elektronike në sistemin e ri.

Sipas RESPA-s, kjo iniciativë demonstroi një dedikim të qartë për të përmirësuar funksionimin e administratës publike, në vazhdimësi dhe në mënyrë më efektive. Janë numëruar disa rezultate të prekshme, si ulja e numrit të ankesave, kostove përkatëse të vlerësuara, rritja e kualitetit, si dhe ankesat në fazën fillestare kanë pësuar rënie. Në këto kushte, procesi është totalisht i digjitalizuar, i lehtë, i aksesueshëm dhe transparent, përgjatë të gjitha fazave të tij. Është një rast i shkëlqyer, që rrit besimin në një fushë të veçantë qeveritare siç është prokurimi publik.

Në këtë kuptim, për Komisionin e Prokurimit Publik, ky çmim është një inkurajim për të ecur më tej në rrugën e reformave.

## Komisioni i Prokurimit Publik me Sistemin E-Ankesa, u vlerësua ndër 15-të projektet më të mira në nivel botëror në Samitin Govtech, të zhvilluar në Hagë

### Samiti i Govtech është ngjarja kryesore në botë për inovacionin e sektorit publik



Sistemi E-Ankesa, u përzgjodh ndër 15-të projektet më të mira në nivel botëror nga juria e samitit të GOVTECH, që u mbajt në Hagë, më 01 nëntor 2022, duke e vendosur kështu Shqipërinë në hartën e iniciativës globale, me një mision të qartë, "Përsosmërinë në mbështetjen e inovacionit GovTech". Komisioni i Prokurimit Publik të Republikës së Shqipërisë, ishte pjesë e tryezës së rrumbullakët të prokurimit të NVM-ve, të organizuar nga Public dhe MasterCard, në të cilën morën pjesë ekspertë globalë, të cilët ndanë dhe diskutuan idetë dhe perspektivat e tyre.

Gjatë prezantimit të sistemit elektronik E-Ankesa, kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik u shpreh qartë mbi vështirësitë e lëna pas me sistemin e vjetër të ankimimit, si dhe për risitë që ka sjellë ky sistem i ri, i cili në vetvete është gjithashtu një risi në fushën e prokurimit publik.

Në këtë Samit morën pjesë 2500 pjesëmarrës nga e gjithë bota, ku pati diskutime dhe shkëmbime idesh dhe eksperiencash me politikëbërës globalë, themelues, investitorë dhe drejtues digjitalë, nga më shumë se 40-të vende.

Qeveritë po angazhohen për transformimin digjital, teknologjia po depërton në sektorin publik, dhe ne po përballemi me kriza të cilat kërkojnë zgjidhje inovative. Ne e dimë potencialin e madh që ka teknologjia për t'i adresuar këto sfida, ato që kemi të nevojshme tani janë diskutimet e hapura, se si mund të zbatohet teknologjinë në mënyrë të barabartë, në mënyrë efektive dhe etike, për ta bërë atë të funksionojë për të gjithë.




## Open Contracting Partnership Vlerësim mbi reformën digjitale të KPP-së

Open Contracting Partnership, një organizatë jofitimprurëse me seli në SHBA, një ndër institucionet partnere ndërkombëtare të Komisionit të Prokurimit Publik, ka publikuar në faqen e saj zyrtare, një artikull dedikuar reformës digjitale të KPP-së, Sistemit të parë Elektronik të Ankesave në Shqipëri, e cila solli një sërë risish në fushën e prokurimeve publike në Shqipëri.

Përmes këtij sistemi, të gjitha ankesat për procedurat e Prokurimit Publik, Prokurimit Publik për Rindërtim, Koncesioneve dhe Partneritetit Publik Privat, Ankan-  
deve Publike dhe Garave Konkurruese për Leje Minerare, dorëzohen në formë elektronikë përmes platformës unike qeveritare E-Albania.

Në këtë artikull janë trajtuar në mënyrë të detajuar të gjitha sfidat me të cilat është përballur prokurimi publik në Shqipëri, kur i gjithë procesi i dorëzimit të ankesave kryhej fizikisht, si dhe risitë që solli ky sistem me vënien e tij në funksion. Kjo reformë është njohur, mbështetur edhe vlerësuar jo vetëm në Shqipëri nga ku ka gjenezën e saj, por edhe nga partnerët e saj ndërkombëtarë.

 <https://www.open-contracting.org/2022/11/22/how-albanias-e-complaints-system-reduces-red-tape-for-government-suppliers/> (Artikulli origjinal i publikuar nga Open Contracting Partnership dhe në vijim materiali i përkthyer në gjuhën shqipe)

## Si sistemi elektronik E-Ankesa i Shqipërisë zvogëlon burokracitë për operatorët ekonomikë

### Sfida

Procesi që ndiqnin operatorët ekonomikë në Shqipëri për të bërë ankesa për prokurimet publike ishte i ngadaltë, i kush-tueshëm dhe jotransparent.

### Qasja e hapur në prokurimet publike

Qeveria, me rekomandimin e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), prezantoi legjislaionin e ri dhe një sistem elektronik që lejon operatorët ekonomikë të paraqesin ankesa online dhe KPP-në për të menaxhuar procesin në mënyrë digjitale dhe transparente. KPP-ja publikon ankesa në kohë reale për procedurat e prokurimit në faqen e saj të internetit, së bashku me bazën e të dhënave, të cilat janë transparente për subjektet e interesuara për vijueshmërinë e tyre. Gjithashtu, tashmë KPP-ja, publikon kopjet PDF të vendimeve që datojnë që nga viti 2010.

Trajnimet brenda dhe jashtë vendit, po ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontaktore për të përdorur sistemin.

### Rezultate

Më pak vendime të KPP-së janë apeluar në gjykatë, duke u përgjysmuar nga 10% në vitin 2020, në 4-5%, që nga korriku i vitit 2022.

Operatorët ekonomikë që përdorin sistemin E-Ankesa kursejnë rreth 300-1000\$.

Më pak vendime për KPP-në janë jashtë afatit, pra kemi një përgjysmim nga viti 2020 deri në 2022, nga 22.1% në 10.1%.

Sistemi elektronik u përdor për 35% të ankesave gjatë periudhës kur u vendos në zbatim, përfshirë 12 operatorë të cilët paraqitën ankesa për herë të parë.

Arkivi i ri i ankesave në internet dhe transparenca e veprimtarisë së KPP-së kanë forcuar besimin midis palëve të interesuara: 74.6% e operatorëve ekonomikë mendojnë, se sistemi është më efikas, ndërsa 82.3%, se rrit paanësinë në vendime për ankesat.

Ankesat nga bizneset që ofertojnë për tenderët janë një mënyrë e vlefshme për të zbuluar korrupsionin dhe çështje të tjera në sistemin e prokurimit publik, si dhe për promovimin e konkurrencës së drejtë. Nëse nuk menaxhohen mirë dhe në mënyrë transparente, ato gjithashtu mund të vonojnë në mënyrë të panevojshme vendimet dhe zbatimin e kontratave.

Në Shqipëri deri vonë, operatorët që dëshironin të paraqisnin ankesa për procedurat e prokurimit, kishin nevojë për shumë durim dhe xhepa të mbushur plot. Para vitit 2021, i gjithë procesi kryhej fizikisht dhe në letër. Imagjinoni një pronar biznesi në një qytet në veri, i cili dëshironte të paraqiste një ankesë kundër një autoriteti kontraktor në jug.

Së pari, ata do të duhet të udhëtonin drejt autoritetit kontraktor dhe të dorëzonin një kopje fizike të ankesës, një dosje zakonisht voluminoze prej qindra faqesh. Më pas ata duhet të udhëtonin në kryeqytet, Tiranë, për të paguar një tarifë financiare në bankë dhe të dorëzonin faturën së bashku me ankesën e tyre në zyrat e Komisionit të Prokurimit Publik, ku për shkak të mbingarkesës iu duhej të prisnin me orë të tëra. Për më tepër, në një në tri raste, autoritetet nuk mund ta shqyrtonin ankesën përpara afatit zyrtar. Këto burokracira iu kushtonin pronarëve të bizneseve që bënin ankesa, një kosto rreth 300-1000 \$ në vit, sipas një studimi të kryer nga Komisioni i Prokurimit Publik, në një vend ku paga mesatare mujore është rreth 450 dollarë (Llogaritja: Operatorët Ekonomikë zakonisht paraqisnin 5 deri në 10 ankesa çdo vit dhe secila kushtonte 50 dollarë).

Gjithashtu, ishte një punë e lodhshme edhe për stafin e KPP-së, i cili duhet të kontrollonte dokumente voluminoze me dorë, duke rritur rrezikun për të bërë gabime. Për këto dosje nevojiteshin tri ambiente të mëdha në godinën ku gjenden zyrat e KPP-së, por sistemi i ri i ankesave elektronike i zvogëloi këto vështirësi.



Më pak vendime të KPP-së janë apeluar në gjykatë, duke u përgjysmuar nga 10% në vitin 2020, në 4-5%, që nga korriku i vitit 2022




Operatorët ekonomikë që përdorin sistemin E-Ankesa kursejnë rreth 300-1000\$




Më pak vendime për KPP-në janë jashtë afatit, pra kemi një përgjysmim nga viti 2020 deri në 2022, nga 22.1% në 10.1%



Sistemi elektronik u përdor për 35% të ankesave gjatë periudhës kur u vendos në zbatim, përfshirë 12 operatorë të cilët paraqitën ankesa për herë të parë



Grafiku 5: Vendime të KPP-së të apeluar në gjykatë



Grafiku 6: Vendime për KPP-në jashtë afatit

### Si filloi dhe si po vijon...

Deri në vitin 2021, operatorët ekonomikë në Shqipëri duhet të paraqisnin ankesa të printuara në letër, të cilat mund të ishin rreth 800 faqe. Tani ankesat mund të dërgohen në mënyrë elektronike dhe të shihen në një regjistër publik.

Që nga fillimi i vitit 2021, operatorët ekonomikë mund të paraqesin ankesa në internet duke hyrë në E-Albania, platforma qeveritare për shërbimet publike. Kjo ka zvogëluar kostot me 0.5% të vlerës së procedurës, e cila është krijuar për të penguar abuzimin me sistemin dhe të kthehet tarifa financiare nëse ankesa pranohet.

Përdorimi i sistemit E-Ankesa, iu ka kursyer operatorëve ekonomikë rreth 50,000 dollarë në kostot e transportit, më shumë se 2,200 litra karburant, si dhe 11,000 copë letër.

Procesi i shqyrtimit në KPP është gjithashtu digjital dhe nëpunësit e përdorin sistemin e menaxhimit të çështjeve për të dokumentuar vendimet në kohë reale.

